

**BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM**

**LIBRI PËR FSHEHTËSITË E HAXHIT**

*Ihjaü Ulumid-din*  
Ringjallja e diturive fetare  
Imam Gazali

**Titulli i origjinalit:**  
KITABU ESRARI'L-HAXHXH  
LIBRI 7

**Përgatiti dhe përktheu:**  
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

**Lektor:**  
Shenaj Zeneli

***Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!***

PARATHËNIE

*Hamd (Falënderimi) i takon vetëm Allahut, i Cili e bëri fjalën e tevhidit vend strehim dhe kalá për robët e Tij, Bejt-i Atik - Qaben, e bëri vend të kërkimit të tyre, dhe të sigurt për ta. Duke e quajtur Qaben Bejtullah (Shtëpi e Allahut), Allahu Teala i nderoi vizitorët e saj, i përforcoi dhe ju dhuroi virtytshmëri. Vizitën Qabes dhe tavafin (rrotullimin rreth saj) e bëri mburojë për robin dhe pengesë mes tij dhe vuajtjes së xhehnemit.*

Salavat e selam Muhammedit, s.a.v.s., pejgamberit të rahmetit, prijësit të ummetit, dhe pasardhësve të tij, ehli bejtit dhe as'habëve të tij, të parët në rrugën e të Vërtetës.

Dije se: haxhi është një nga shtyllat e Islamit, është ibadet që duhet të bëhet një herë në jetë, ibadeti i fundit që është urdhëruar.

Për këtë, Allahu Teala thotë:

**“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe.”** 5-Maide: 3

Kjo sure i zbriti Resulallahut s.a.v.s., gjatë haxhit lamtumirës (*haxh-xhetul veda*), ditën e xhuma në Arafat.

Ndërsa Resulallahu, s.a.v.s., për haxhin ka thënë:

**“Kush vdes e nuk e ka kryer haxhin, le të vdesë, nëse do, si jahudi, ose, nëse do, si i krishterë.”<sup>1</sup>**

Sa ibadet madhështor është ky që, nëse nuk e kryen, humbet përkryrja e fesë. Prandaj ai që me qëllim e lë anash atë është sikur jahuditë dhe të krishterët në rrugën e tyre të gabuar. Një ibadet kaq i rëndësishëm meriton vëmendjen e plotë, prandaj ne, me ndihmën e Allahut Teala, në tre kapituj do t'i shpjegojmë në detaje ruknet, sunnetet, edebin, faziletin dhe të fshehtat e tij.

---

<sup>1</sup> Llogaritet si hadith i Ebu Hurejres, e në formë të ngjashme e shënon edhe Tirmidhi, nga Alia, r.a.. Tirmidhi thotë që është hadith *garib*, e për zinxhirin e transmetuesve të tij ka disa mendime.

## Kapitulli i parë

### FAZILETI I HAXHIT, QABES, MEKËS DHE MEDINES

#### FAZILETI I HAXHIT

Allahu Teala thotë:

**“dhe ftoi njerëzit në haxhillëk, do të vijnë ata ty – në këmbë dhe (duke shaluar) në çfarëdo deve; duke ardhur prej të gjitha viseve të largëta”** 22-Haxh: 27

Katade ka thënë: *“Kur Allahu Teala i urdhëroi Ibrahimin a.s., që t’i ftojë njerëzit në Qabe, ai thirri:*

*- O njerëz! Me urdhrin e Allahut Teala u ndërtua një Shtëpi e Shenjtë, prandaj vizitoheni!”*

Allahu Teala thotë:

**“(Vijnë) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre.”**  
22-Haxh:28, e dikush ka thënë se këtu bëhet fjalë për dobitë nga tregtia në ditët e haxhit dhe për shpërblimin në ahiret.

Kur njëri prej të parëve e dëgjoi këtë ajet, tha: *“Pasha Rabbin e Qabes, Allahu Teala do t’i falë vizitorët e saj.”*

Duke komentuar ajetin Kur'anor:

**“...unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.”** (7-Araf: 16), dikush ka thënë se bëhet fjalë për rrugën për në Meke, pra shejtani do t’ju vendosë pengesa njerëzve në rrugë për atje.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Kurrë nuk është parë shejtani më i dobët, më i mposhtur, më i përbuzur e më i urryer si në ditën e Arafatit”<sup>2</sup>,**

si edhe,

**“Kush e kryen haxhin dhe nuk flet fjalë të pahijshme e të shëmtuara, do të kthehet i pastër nga gjynahet sikur atë ditë që e ka lindur nëna e tij.”<sup>3</sup>**

Kjo vetëm për shkak se haxhia e sheh lëshimin e mëshirës së Allahut dhe e sheh faljen e Tij për gjynahet e mëdha, sepse është thënë se ***ka gjynahe të tilla që mund t’i shkatërrojë vetëm qëndrimi në Arafat.***<sup>4</sup>

Xhafer ibn Muhammed thotë se këto janë fjalë të Resulallahut, s.a.v.s..

---

<sup>2</sup> Malik nga Ibrahim ibn Ebu Able, e ky nga Talha ibn Abdullah ibn Kurejz, si hadith mursel.

<sup>3</sup> Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre.

<sup>4</sup>Nuk është gjetur burimi.

Njëri nga evliatë ka treguar se Iblisi, Allahu e mallkoftë, iu shfaq në Arafat në formë të njeriut; i dobët, i zverdhur, me sy të përlotur e shpinë të kërrusur. Ky e pyeti përse po qanë, e Iblisi u përgjigj:

- *Haxhilerët erdhën vetëm për rizanë e Allahut, jo për tregti. Frikësohem se do të kthehen të gëzuar, se Allahu Teala do t'i shpërblejë, e kjo më pikëllon.* Ky pyeti:

- *Përse të është dobësuar trupi?,* e Iblisi u përgjigj:

- *Nga hingëllima e kuajve të tyre në rrugë të Allahut; po të ishin në rrugën time, do të isha i lumtur.* Ky prapë pyeti:

- *Çfarë ta ka ndryshuar ngjyrën e fytyrës?,* e Iblisi tha:

- *Ndihma mes tyre në ibadet dhe në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala; sikur t'i ndihmonin njëri-tjetrit në gjynahe, do të isha i lumtur.*

- *Çfarë ta shtrembëroi kurrizin?,* pyeti ky, e Iblisi tregoi:

- *Fjalët e tyre: "Allahu im, të lusim për përfundim të mirë e të hajrit të jetës në këtë dynja." E unë them: "I mjeri unë! Kur do të mbështeten këta në veprat e veta?! Kam frikë se ata e kanë kuptuar të vërtetën."*

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**"Ai që del nga shtëpia me qëllim ta kryejë haxhin ose umren e rrugës vdes, do ta ketë shpërblimin e haxhit ose umres deri në ditën e Gjykimit, e ai që vdes në Meke ose Medine, nuk i kërkohet llogari, por i thuhet: 'Hyn në Xhennet'."**<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Bejheki pjesën e parë, Darekutni pjesën e dytë.

**“Haxhi *mebrur*<sup>6</sup> është më i mirë se dynjallëku dhe krejt çfarë ka në të, e shpërblimi për një haxh të tillë mund të jetë vetëm Xhenneti.”<sup>7</sup>**

**“Ata që e kryejnë haxhin dhe umren dërgohen atje prej Allahut, dhe janë mysafirë të Tij; nëse kërkojnë diçka prej Tij, do ta marrin; nëse kërkojnë falje - Allahu do t’i falë; nëse i dërgojnë dua, dua ja do t’ju pranohet; nëse luten për tjetrin, angazhimi i tyre do të pranohet.”<sup>8</sup>**

Në një hadith musned nga Ehli-bejti, thuhet:

**“Gjynahqari më i madh është ai që qëndron në Arafat e mendon se Allahu Teala nuk e ka falur.”<sup>9</sup>**

Ibn Abbas, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Për çdo ditë në Qabe zbresin njëqind e njëzet rahmete; gjashtëdhjetë për ata që bëjnë tavaf, katërdhjetë për ata që falen dhe njëzet për ata që e shikojnë Qaben (*Shtëpinë e Allahut*).”<sup>10</sup>**

---

<sup>6</sup> *Haxhi Mebrur*; thuhet se është haxhi i pastër nga gjynahet; haxhi i përkryer dhe i pranuar nga Allahu Teala.

<sup>7</sup> Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre në formë tjetër, e gjendet edhe te Ibn Adijj.

<sup>8</sup> Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

<sup>9</sup> Hatibi në veprën *‘el-Muttefek vel-mufterek.’*

<sup>10</sup> Ibn Hibban në *‘Dhu’afa’.*



**“Bëni shpesh tavaf rreth Qabes, sepse ky është veprimi më i vlefshëm që do ta gjeni në librin tuaj të veprave në ditën e Gjykimit, e kjo është edhe puna më e bekuar.”<sup>11</sup>**

Prandaj është mirë të fillohet vizita me tavaf, edhe atëherë kur vizitori nuk është duke kryer haxhin ose umren. Në transmetim thuhet:

**“Ai që bën tavaf shtatë herë rreth Qabes, këmbëzbathur dhe me kokë të zbuluar, do të ketë shpërblim sikur të ketë liruar një skllav, e nëse bën tavaf shtatë herë në shi, do t’i falen gjynahet e kaluara.”<sup>12</sup>**

Është thënë se, kur Allahu Teala ia falë një gjynah robit të Tij që vepron në rrugë të Tij deri sa ai është në Arafat, Allahu Teala ia falë atë gjynah të gjithë njerëzve që gjenden në atë kohë në Arafat.

Disa nga gjeneratat e para, (*selef-i salihin*) kanë thënë:

*“Kur dita Arefe të jetë të xhumanë, të gjithë që janë në Arafat do të falen. Ajo është dita më e mirë në këtë botë.”*

---

<sup>11</sup> Ibn Hibban dhe Hakimi nga Ibn Omer. Hakimi thotë se është i besueshëm dhe se i plotëson kushtet e Buhariut dhe Muslimit.

<sup>12</sup> Nuk është gjetur në këtë formë, e Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe shënojnë transmetim të ngjashëm nga Ibn Omeri, për të cilin Tirmidhi thotë se është hadith *hasen*.

Në këtë ditë Resulallahu, s.a.v.s., e bëri haxhin lamtumirës, e duke qëndruar në Arafat iu shpall ajeti:

**“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe.”** 5-Maide: 3

Çifutët kanë thënë: *“Po të na shpallej neve ky ajet, atë ditë do ta shpallnim festë.”*

Omeri, r.a., ka thënë: *“Deklaroj dhe pohoj që ky ajet i është shpallur Resulallahut, s.a.v.s., në ditën e dy festave: dita e Arafatit dhe dita e xhumasë, deri sa ishte në Arafat.”*

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Allahu im! Fali haxhilerët dhe ata për të cilët haxhilerët kërkojnë falje!”**<sup>13</sup>

Ali ibn Muveffek e bëri disa herë haxhin për Resulallahun, s.a.v.s.. Ai ka treguar: *“E pashë Resulallahun, s.a.v.s., në ëndërr, e më tha:*

*- O Ibn Muveffek! Ti bëre haxh për mua? Unë i thashë:*

*- Po, O Resulallah; e Resulallahu, s.a.v.s., më tha:*

*- A e bëre edhe telbijen për mua? Unë i thashë:*

*-Po, o Resulallah; e Resulallahu, s.a.v.s., më tha:*

*- Edhe unë do të shpërblej ty në ditën e gjykimit, kur njerëzit të kalojnë nëpër vështirësitë e dhënies së llogarisë, do të marr për dore dhe do të fus në Xhennet.*

---

<sup>13</sup> Hakimi nga Ebu Hurejre

Muxhahidi dhe dijetarë tjerë kanë thënë: *“Kur haxhilerët të arrijnë në Meke, i presin melekët, iu japin selam atyre që janë mbi deve dhe i zgjasin dorën atyre që janë mbi gomarë, ndërsa i përqafojnë ata që kanë ardhur në këmbë.”*

Hasan Basriu ka thënë: *“Kush vdes menjëherë pas Ramazanit, menjëherë pas betejës, ose menjëherë pas kryerjes së haxhit, ka vdekur si shehid.”*

Omeri, r.a., ka thënë: *“Në muajt Dhul-hixhxe, Muharrem, Sefer dhe deri në njëzet ditët e muajit Rebiul-evvela, siç falet haxhia, falen edhe ata për të cilët ai ka kërkuar falje.”*

Selef-i salihin kishin adet të mirë; haxhilerët që niseshin për në haxh, i uronin, i prisin haxhilerët duke ua puthur sytë para se të bëjnë gjynah dhe kërkonin prej tyre të bëjnë dua për ta.

Transmetohet se Ali ibn Muveffek ka thënë:

*“Një vit isha në haxh, e natën e Arefes më zuri gjumi në xhaminë Hajf në Mina. Pashë në ëndërr dy melekë me rroba të gjelbra, zbritën nga qielli, e njëri i thirri tjetrit:*

*- O rob i Allahut! Meleku tjetër ia ktheu:*

*- Urdhëro o rob i Allahut!; e ky i pari pyeti:*

*- A e di sa haxhilerë këtë vit e kanë vizituar Qaben?*

- Nuk e di!, u përgjigj i dyti, e i pari i tha:
  - Qaben e vizituan gjashtëqind mijë haxhilerë.
  - E, a e di sa prej tyre ju është pranuar haxhi?
- Ky u përgjigj që nuk e di, e ai i pari i tha:
- Haxhi ju pranua vetëm gjashtë personave.

*Melekët u zhdukën në rrezet e dritës. U zgjova në frikë. Më kaploi brengë e madhe. Mendoja, nëse haxhi ju është pranuar gjashtë personave, ku jam unë!?!... Në kthim nga Arafati u ndala në Mesh'ari-Haram dhe mendoja numrin e madh të haxhilerëve, e numrin e vogël të atyre që haxhi ju është pranuar. Me këto mendime, më zuri gjumi. Në ëndërr përsëri i pashë ata dy melekë. Njëri i thirri tjetrit dhe përsëri filloi biseda mes tyre, sikur një natë më parë. Njëri tha:*

*- A e di çfarë ka caktuar Rabbi jonë për këtë mbrëmje?*

*Ai tjetri u përgjigj që nuk e di, e ky i pari i tha:*

*- Secilit prej këtyre gjashtë personave, Allahu Teala ia dhuroi edhe faljen për njëqind mijë persona tjerë.*

*U zgjova aq i gëzuar sa nuk mund ta përshkruaj!”*

*Nga ibn Muveffek gjithashtu transmetohet se ka thënë:  
“Një vit isha në haxh, e kur e përfundova haxhin fillova të mendoj për ata të cilëve haxhi nuk ju pranohet. Thashë me vete:*

*- Allahu im! Unë haxhin tim dhe shpërblimin për të ia dhuroj atyre të cilëve Ti nuk ua ke pranuar haxhin; e në ëndërr, Allahu Teala më tha:*

***- O Ali! A po mundohesh të jesh më i xhymertë se Unë, kur Unë e krijova xhymertllëkun dhe të xhymertit. Unë jam më i xhymerti mes të xhymertëve dhe më fisniku mes fisnikëve! Mua më takon xhymertllëku dhe fisnikëria e të gjitha botëve. I dhurova falje secilit që nuk ia kam pranuar haxhin falë atyre të cilëve Ua pranova.”***

#### FAZILETI I QABES DHE I MEKES SË NDERUAR

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Allahu Teala ka premtuar se Qaben çdo vit do ta vizitojnë gjashtëqind mijë njerëz. Nëse ai numër nuk plotësohet, Allahu Teala do ta plotësojë me melekë. E në ditën e ringjalljes, Qabeja do të jetë si nuse në dasëm. Secili që ka bërë tavaf rreth Qabes, do të kapet për mbulojat e saj e do të rrotullohet rreth saj deri sa Qabeja të hyjë në xhennet, e me të do të hyjnë edhe të gjithë ata.”<sup>14</sup>**

Në një lajm, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Një umre në Ramazan është sikur një haxh me mua.”<sup>15</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

---

<sup>14</sup> Nuk është gjetur burimi.

<sup>15</sup> Buhari dhe Muslimi nga Ibn Abbasi. E shënon edhe Hakimi me pjesë shtesë, dhe pa dyshime.

**“Unë jam i pari që do të ngritem prej varrit, e më pas shkoj te varresat Beki, dhe ata do të ngjallen me mua. Më pas shkoj te Mekasit dhe do të ringjallem në mes të Mekes dhe Medines.”<sup>16</sup>**

Në një lajm thuhet:

**“Kur Ademi a.s., përfundoi haxhin, melekët i thanë:  
- O Adem! Haxhi të është pranuar! Ne e kemi vizituar Qabenë dymijë vite para teje.”<sup>17</sup>**

Gjithashtu, transmetohet se është thënë: *“Vërtetë që Allahu Teala për çdo natë i shikon banorët e Tokës; të parët që i shikon janë banorët e Haremit, e prej tyre së pari i shikon ata që janë në Mesxhidul-haram. Atë që e sheh të bëjë tavaf rreth Qabes, e falë; atë që e sheh në namaz, e falë; atë që e sheh në këmbë, të kthyer kah Qabeja, e falë.”*

Thuhet se çdo aksham një abdal<sup>18</sup> dhe çdo mëngjes një evtad<sup>19</sup> e bëjnë tavaf Qaben. E kur kjo të përfundojë, Qabeja do të ngritet nga Toka. Njerëzit do të zgjohen në mëngjes dhe nga Qabeja nuk do të shohin asnjë gjurmë, e

---

<sup>16</sup> Tirmidhi, që e konsideron hasen, dhe Ibn Hibban nga Ibn Omeri.

<sup>17</sup> Shënon Muffedal el-Xhundi, e nga ai edhe Ibn el-Xhezvi në veprën *el-’l’lel*, nga Ibn Abbas. Ibn Xhezvi thotë se nuk është hadith i besueshëm. E shënon edhe Ezreki në veprën *Tarih Meke*, si *mevkuf*, nga Ibn Abbas.

<sup>18</sup> Abdal: evlia; thonë që janë shtatë, katërdhjetë ose shtatëdhjetë.

<sup>19</sup> Evtad: evlia; thonë që janë katër.

kjo do të ndodh kur për shtatë vite rresht askush nga jashtë nuk do të bëjë tavaf, nuk do ta kryejë haxhillëkun. Më pas Kur'ani Kerim do të zhduket nga fletët; njerëzit do të zgjohen në mëngjes, e do të gjejnë vetëm fletë të bardha, pa asnjë shkronjë. Më pas Kur'ani do të zhduket nga zemrat e njerëzve, ashtu që askujt nuk do t'i kujtohet asnjë fjalë nga Kur'ani. Atëherë njerëzit do t'i kthehen poezisë, këngës dhe tregimeve nga kohët e xhahilletit. Pastaj do të paraqitet Dexhalli, e Isa a.s., do të zbresë nga qielli e do ta vrasë. Atëherë fundi i botës do të jetë aq afër sikur gruaja shtatzënë, pak para lindjes, kur pret të dalë fëmija. Me një transmetim thuhet:

**“Bëni shpesh tavaf rreth Qabes para se ajo të ngritet lartë, sepse ajo është rrënuar dy herë, e herën e tretë do të ngritet lartë.”<sup>20</sup>**

Alia r.a., ka treguar se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Allahu Teala thotë: *Kur do të dua ta shkatërroj këtë botë, së pari do ta shkatërroj Qaben, e më pas do ta shkatërroj këtë botë.*”<sup>21</sup>**

---

<sup>20</sup> Bezzari, Ibn Hibban dhe Hakimi nga Ibn Omeri.

<sup>21</sup> Nuk është gjetur burimi.

## QËNDRIMI I PËLQYESHËM DHE I PAPËLQYESHËM NË MEKE

Disa dijetarë të kujdesshëm dhe që e kanë frikë Allahun i kanë përmendur tri sebepe për të cilat qëndrimi në Meke është i papëlqyeshëm (*mekruh*).

*Sebepi i parë.* Qëndrimi në Meke është i papëlqyeshëm nëse është qëndrim i gjatë dhe mund të sjell ndjenjën e mërzitjes, e kjo të sjellë deri te zvogëlimi i dëshirës për të respektuar Qaben. Prandaj Omeri, r.a., kur përfundonte haxhi, e kishte zakon t'ju thoshte haxhilerëve: *“O banorë të Jemenit, kthehuni në Jemen! Ju të Shamit, kthehuni në Sham! Ju të Irakut, kthehuni në Irak!”*

Omeri, r.a., gjithashtu ka menduar t'i ndalojë njerëzit nga tavafi i shpeshtë, dhe pat thënë: *“Frikësohesha mos ju bëhet një veprim i zakonshëm.”*

*Sebepi i dytë.* Me largimin prej Qabes e forcon mallin dhe dëshirën që të kthehet përsëri, sepse Allahu Teala e bëri Qaben strehim dhe vend të sigurt për njerëzit, pra që të shkojnë dhe përsëri t'i kthehen Qabes, por të mos ia bëjnë qefin vetes e të qëndrojnë aty. Dikush ka thënë: *“Më mirë e ke të jesh në shtëpi e zemra të t'jetë e lidhur për Qaben, sesa të jesh në Qabe e të mërzitesh dhe të merr malli për shtëpi.”*



Njëri nga gjenerata e parë (*selef*) ka thënë: *“Sa shumë ka njerëz në Horasan, që janë më afër Qabes se disa që bëjnë tavaf rreth saj.”*

Është thënë se Allahu Teala ka robë të tillë që rreth këtyre personave të bekuar njerëzit bëjnë tavaf që t'i afrohen Allahut Teala.

*Sebepi i tretë.* Qëndrimi më i gjatë në Meke hapë mundësinë e bërjes gjynah në të, e kjo është e rrezikshme dhe mund të shkaktojë më lehtë zemërimin e Allahut Teala, për shkak se është vend i bekuar. Transmetohet se Vehib ibn Verd el-Mekki ka thënë: *“Një natë po falja namaz te makami Ibrahim dhe dëgjoja një zë që vinte nga Qabeja duke thënë:*

*- I ankohe Allahu Teala, e më pas edhe ty o Xhebrail, për atë çfarë bëjnë ata që bëjnë tavaf rreth meje; mendojnë për diçka tjetër, flasin gjëra të kota e argëtohen. Nëse nuk heqin dorë nga kjo, do të mërzitem e të dridhem aq tmerrësisht, sa që secili gur i murosur në mua do të kthehet prej ku është marrë.”*

Ibn Mesud, r.a., ka thënë: *“Vetëm në Meke personi do të pyetet për qëllimin para veprimit”,* e më pas lexoi ajetin:

**“...e kush synon të bëjë në të (Qabe) ndonjë shmangie me të keqe, Na do t'i japim të shijojë dënimin e dhembshëm.”** 22-Haxh: 25

Pra, përmendet edhe vet mundësia e largimit nga rruga e drejtë. Prandaj thuhet se në Meke shtohen shpërblimi i mirësisë por edhe dënimi i së keqes. Iban Abbas, r.a., ka thënë: *“Mos-respekt ndaj Mekes konsiderohet braktisja e Haremit, që është e njëjtë me mosbesimin në Harem.”*

Kanë thënë që njëjtë është edhe nëse flitet gënjeshtër në Meke.

Ibn Abbas, r.a., gjithashtu ka thënë: *“Për mua, më të padëmshme janë shtatëdhjetë gjynahe në Rekije se sa të bëj një gjynah në Meke”*, e Rekije është një vend në mes të Mekes dhe Taifes. Nga frika se mund të shprehin mos-respekt, disa nga banorët e Mekes dilnin jashtë kufijve të Haremit për të kryer nevojat fiziologjike. Të tjerët qëndronin një muaj të plotë në Meke, e kur largoheshin nuk lënin kurrfarë mbeturina në tokë. Për të penguar qëndrimin më të gjatë në Meke, disa prej dijetarëve e shihnin të papëlqyer dhënien e shtëpive me qira për të huajt.

Megjithatë, mos mendo se mospëlqimi i qëndrimit të gjatë në Meke bie ndesh me faktin se ai është vendi më i mirë, sepse arsyeja e mospëlqimit të qëndrimit qëndron në dobësinë e njerëzve dhe respektin e pamjaftueshëm të tyre për atë vend.

Kjo nënkupton se më mirë është të largohesh nga Meka se sa të qëndrosh aty e të mos e respektosh atë vend. E, natyrisht që më e mira është të qëndrohet në Meke duke i respektuar e zbatuar të gjitha të drejtat e saj. Kur Resulallahu, s.a.v.s., u kthye në Meke, u drejtua kah Kibla, e tha:

**“O Meke, vëretë që ti je vendi më i mirë në tokën e Allahut Teala, dhe vendi më i dashur për mua në tokën e Allahut, dhe po të mos isha i detyruar të largohem nga ti, kurrë nuk do të largohesha!”<sup>22</sup>**

Përveç kësaj, vetëm shikimi në Qabe është ibadet, dhe siç e thamë, ibadetet në Meke shpërblehen shumëfish më tepër.

---

<sup>22</sup> Shënon Tirmidhi dhe e vërteton besueshmërinë e hadithit, ndërsa e shënojnë edhe Nesai në përmbledhjen *el-Kubra*, Ibn Maxhe dhe Ibn Hibban nga Abdullah ibn Adijj ibn el-Hamr.

## VLERAT E MEDINES KARSHI QYTETEVE TJERA

Pas Mekes, vendi më i mirë në Tokë është Medine, qyteti i Resulallahut s.a.v.s.. Edhe këtu ibadetet shpërblehen shumëfish më tepër. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Namazi i falur në xhaminë time është më i vlefshëm se njëmijë namaze të falura në ndonjë xhami tjetër, përpos në *Mesxhidul-haram*.”<sup>23</sup>**

Gjithashtu, secila vepër e mirë që bëhet në Medine shpërblehet njëmijë herë më shumë se sa kur bëhet në vende të tjera.

Sipas vlerës, pas Medines, në vendin e tretë është *Bejti Makdis – Mesxhidi Aksa* në Kudus. Namazi i falur atje vlen sa pesëqind namaze të falura në ndonjë xhami tjetër, dhe e njëjta vlen edhe për ibadetet tjera. Ibn Abbas, r.a., ka treguar se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Namazi i falur në xhaminë e Medines vlen sa dhjetë mijë namaze; namazi i falur në *Mesxhidul-Aksa* vlen sa një mijë namaze; namazi i falur në *Mesxhidul-haram* (Qabe) vlen sa njëqind mijë namaze.”<sup>24</sup>**

---

<sup>23</sup> Muttefekun Alejhi nga Ebu Hurejre, si edhe nga Ibn Omeri.

<sup>24</sup> Hadith i pazakonshëm dhe nuk është gjetur në këtë formë e as i plotë. Ibn Maxhe shënon nga Mejmun, me zinxhir të mirë, për *Bejtul-Makdis*, “...sepse namazi në të vlen sa njëmijë namaze në ndonjë vend tjetër”, dhe nga Enesi: “**Namazi i falur në *Mesxhidul-Aksa* vlen sa**

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Atij që qëndron i durueshëm nga telashet dhe vështirësitë e Medines, unë do t’i jem shefatxhi në ditën e Gjykimit.”<sup>25</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Atij që i afrohet vdekja kur është në Medine, le të vdesë aty, sepse ai që vdes në Medine, unë do t’i jem shefatxhi në ditën e Gjykimit.”<sup>26</sup>**

Të gjitha vendet tjera, përpos këtyre të trijave, kanë vlerë të njëjtë, përpos hapësirave kufitare, e kjo për shkak se qëndrimi në kufi në shërbim të mbrojtjes është ibadet i madh. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Udhëtimi bëhet vetëm për tri mesxhide: për mesxhidin tim (në Medine), për Mesxhidul-Haram (në Mekë) dhe për Mesxhid-i Aksa (në Jerusalem).”<sup>27</sup>**

Këtë hadith disa dijetarë e kanë marrë si provë për ndalesë të udhëtimit për të vizituar tyrbet dhe varret e dijetarëve e të njerëzve të mirë.

---

***pesëdhjetë mijë namaze, namazi i falur në xhaminë time vlen sa pesëdhjetë mijë namaze.”*** Zinxhiri nuk ka mangësi, ndërsa Zeheb thotë se është hadith munker.

<sup>25</sup> Musliimi nga Ebu Hurejre.

<sup>26</sup> Tirmidhi dhe Ibn Maxhe nga Ibn Omeri.

<sup>27</sup> Muttefekun alejhi nga Ebu Hurejre dhe Ebu Seid.

Pas hulumtimit të kësaj çështje, sipas meje, ndoshta vizita tyrbeve e varreve edhe është urdhëruar, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Ju kam ndaluar vizitat varreve, por tash, vizitoni ato e mos folni keq për ta.”<sup>28</sup>**

Hadithi më herët flet për xhamiat, ndërsa tyrbet nuk janë xhamia, sepse, përpos tri xhamiave të përmendura, të gjitha xhamiat tjera kanë vlerë të njëjtë. Në secilin vend ka xhami, dhe nuk ka kuptim të udhëtohet për në xhami në tjetër vend. Megjithatë, tyrbet nuk kanë vlerë të njëjtë me xhamiat. Përkundrazi, bereqeti i vizitës tyrbes varet nga grada të cilën e kanë të Allahu Teala ata që trupi ju pushon në ato tyrbe. Natyrisht, nëse në një vend nuk ka xhami, atëherë personi mund të shkojë në vend tjetër vetëm pse atje është xhamia, e nëse do, edhe të shpërngulet atje. Do ta doja ta di, ata që marrin qëndrim për ndalim të vizitave tyrbeve, a e konsiderojnë të ndaluar edhe vizitën varreve të peygamberëve, a.s., për shembull vizitën varrit të Ibrahimit, Musasë, Jahjasë dhe peygamberëve tjerë, a.s.? Ndalimi i vizitave të varret e tyre është plotësisht e pakuptimtë, e nëse lejohet, atëherë lejimi ka të bëjë edhe me vizita vendeve ku janë të varrosur evliatë, ulematë dhe robët e mirë të Allahut, e nuk përjashtohet mundësia që ky të jetë edhe një prej qëllimeve të udhëtimit, siç mund të jetë qëllim i udhëtimit vizita dijetarit të gjallë.

---

<sup>28</sup> Muslimi nga Burejde ibn el-Hasib.

Kjo ka të bëjë me udhëtimin, e sa për qëndrim, për muridin më e drejta është të qëndrojë në vendin e vet, nëse aty ka kushte për jetë të mirë, pos kur dëshiron të udhëtojë për dituri. Por, nëse gjendja në vendin e vet nuk është e mirë, le të kërkojë vende që janë më pak të njohura dhe të cilat janë më të përshtatshme për fenë e tij dhe për zemrën e tij, e ku më lehtë mund të bëjë ibadet; vendet e tilla janë më të mirat për të. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Të gjitha vendet janë krijuar nga Allahu Teala e të gjithë njerëzit janë robë të Allahut. Prandaj, kur të hasësh në bereqet e qetësi në ndonjë vend, vendosu aty dhe falëndero Allahun Teala.”<sup>29</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

**“Kush gjen bereqet dhe qetësi në diçka, le t’i mbahet asaj, le të mos largohet nga ai vend, deri sa nuk prishet fitimi për jetesë aty.”<sup>30</sup>**

Ebu Nuajm tregon: *“E pashë Sufjan Sevrinë se si e hodhi torbën mbi shpinë, e këpucët i kapi në dorë. Unë e pyeta:*

*- O Ebu Abdullah! Kah je nisur?!, e ai m’u përgjigj:*

*- Atje ku këtë torbën time do ta mbush me dërhëmë.”*

---

<sup>29</sup> Ahmedî dhe Taberani nga Zubejri.

<sup>30</sup> Ibn Maxhe nga Enesi.

Në një transmetim tjetër thuhet se Sufjani ka thënë:

- *Dëgjova për një vend ku jetohet më lehtë, do të vendosem atje;* e Ebu Nuajm i ka thënë:

- *Kështu do të veprosh, Ebu Abdullah?!,* e ai i ka thënë:

- *Po. Kur dëgjon se në një vend ka bollëk e lehtësim, shko atje; kjo është më e mirë për fenë tënde, dhe jeton në qetësi.*

Sufjani gjithashtu kishte thënë:

*“Kjo është kohë e të keqes, ku nuk janë të mbrojtur e të sigurt as ata të panjohurit, e lere më të njohurit, që ju është dëgjuar zëri. Kjo është kohë e ndryshimeve; njeriu është i detyruar ta ndërrojë vendqëndrimin që ta ruajë fenë e vet.”*

Prej Sufjanit gjithashtu transmetohet se ka thënë:

- *Vallahi nuk di cili vend është më i sigurt e më i qetë.*

Kur i thanë se Horasani është i sigurt, ai u përgjigj:

- *Mirëpo është një vend me drejtime të ndryshme dhe mendime të prishta.* Kur i thanë për Sham, u përgjigj:

- *Atje bëjnë me gisht kah ti!,* pasi ky ishte i njohur. Kur i thanë për Irak, u përgjigj:

- *Ai është vend i të dhunshmëve e tiranëve;* e kur i thanë për Meke, u përgjigj:

- *Meka e zbrazë xhepin dhe e lodhë trupin.*



Një person i njohur i tregoi se kishte marrë vendim që të vendosej të banojë në Meke, dhe i kërkoi ndonjë këshillë, e Sufjan Sevri i tha: *“Do t’i jap tri këshilla: mos u fal në safin e parë, mos u shoqëro me pasardhësit e Kurejshëve dhe mos jep sadaka haptas; safin e parë e konsideronte të papëlqyer sepse në safin e parë do të bëhej i njohur, dhe kur mungon kërkohet; e kishte frikë që ibadeti do ti përzihet me dyfytërsinë.*

#### KUR BËHET HAXHI I OBLIGUESHËM, KUSHTET PËR VLEFSHMËRINË E RUKNEVE TË TIJ, VAXHIBET E TIJ DHE NDALESAT GJATË HAXHIT

Që haxhi të jetë i drejtë, duhen dy kushte: koha dhe islami. Haxhi i fëmijës është i drejtë. Nëse fëmia është në gjendje të kuptojë – ai e bën nijet vet dhe vet e veshë ihramin, e nëse nuk është në gjendje të kuptojë, nijet për të e bën kujdestari i tij dhe me të i kryen edhe obligimet e haxhit - tavafin, sa’j-in e të tjera.<sup>31</sup>

Sa për kushtin e dytë - kohën, kjo është koha e muajve Sheval, Dhulka’de dhe dhjetë ditët e muajit Dhul-hixhxe. Kush e bën nijet haxhin jashtë kësaj kohe, ajo do t’i ishte vetëm umre. Koha e umres është gjatë gjithë vitit.

---

<sup>31</sup>Si pas medh’hebit hanefi, kjo nuk është *xhaiz*.

Nuk është e drejtë që dikush që është i zënë me xhemret në Mina të veshë ihramin për umre. Sepse nuk mund të angazhohet me zbatimin e obligimeve të umres.

E që haxhi të jetë i obligueshëm, kërkohen pesë kushte: Islami, mosha madhore, mendja e shëndoshë, liria dhe mundësia për ta kryer haxhin, si fizike ashtu edhe materiale. Atij që haxhi i bëhet farz edhe umren e ka farz.<sup>32</sup>

Ai që vjen në Meke për vizitë ose tregti, e nuk është tregtar, e ka obligim ta veshë ihramin, sipas një mendimi, e do të lirohet nga ihrami pasi të ketë kryer umren ose haxhin.

Thamë që janë dy lloje të mundësisë që të kryhet haxhi: *mundësia fizike*, e kjo është shëndeti i vet personit dhe që rrugëtimi të jetë i sigurtë, dhe *mundësia materiale*, pra personi duhet të ketë pasuri të mjaftueshme për të shkuar në haxh dhe për t'u kthyer nga haxhi, si edhe të sigurojë shpenzimet e familjes gjatë kohës që ky do të jetë në haxh.

Nëse nuk ka mundësi fizike për shkak të sëmundjes, por ka mundësi materiale, atëherë lejohet kryerja e haxhit për të nga dikush tjetër. Personi i tillë njihet si *bedel*.

---

<sup>32</sup> Sipas Imam Hanefisë, umre është sunnet.

Pasi që bedeli ta ketë kryer haxhin për vete, mund të shkojë në haxh edhe për tjetrin, dhe mjafton të sigurohen shpenzimet dhe transporti. Nëse fëmija ose nipi ia ofron këtë shërbim babasë, kjo do të thotë që babaja ka mundësi, pra fuqinë, për të siguruar kushtet, dhe haxhi i llogaritet.<sup>33</sup>

Ai që ka mundësi, kryerjen e haxhit e ka farz, por ky farz nuk është i menjëhershëm, dhe mund ta shtyjë për vitet që vijnë, por kjo është e rrezikshme. E nëse arrinë ta kryejë haxhin, qoftë edhe para fundit të jetës, shpëton nga përgjegjësia. Megjithatë, nëse vdes para se të ketë kryer haxhin, do të dalë para Allahut Teala si gjynahqar që nuk e ka kryer obligimin e haxhit, sidomos nëse së paku nuk e ka lënë amanet që nga pasuria e tij të paguhet dikush që do ta kryejë haxhin për të (*bedeli*), njetë siç paguhen borxhet të tjera. Nëse në një kohë personi është në gjendje të niset për haxh me të tjerët e nuk niset, por vdes para se të tjerët ta kryejnë haxhin, në atë rast nuk e bartë me vete borxhin e haxhit. Megjithatë, nëse vdes pasi të tjerët ta kenë kryer haxhin dhe ky nuk e ka kryer, përkundër mundësisë që e ka pasur, atëherë nuk do ta ketë të lehtë kur të takohet me Allahun Teala.

---

<sup>33</sup> Sipas imam Ebu Hanifes dhe Imam Ahmed ibn Hanbelit, sevapi i veprimt mund të jepet, por fuqia e tjetrit nuk mund të llogaritet si fuqia e vet. Pra, nëse babai paguan, kjo nuk do të llogaritet si fuqi e babasë, sepse fëmija duke i shërbyer fizikisht, e nderon babanë. E me dhënien e parave, babai i është mirënjohës.

Omeri, r.a., ka thënë: *“Kam menduar të urdhëroj që në të gjitha vendet të paguhet xhize nga ata që kanë mundësi e nuk e kanë kryer haxhin.”*

Tregohet se Nga Seid ibn Xhubejr, Ibrahim Nehai, Muxhahidi dhe Tavusi kanë thënë: *“Po të dinim për dikë që ka qenë në mundësi ta kryejë haxhin e nuk e ka bërë, kur të vdesë, nuk do t’ja falnim xhenazen.”*

Disa nuk ia falnin xhenazen komshive të vet të cilët kanë mundur ta kryejnë haxhin e nuk e kanë bërë. Ibn Abbasi ka thënë: *“Kush vdes, e nuk e ka kryer obligimin e zeqatit dhe haxhit, do të kërkojë prej Allahut Teala ta kthejë në dynja”,* e më pas i lexoi ajetet Kur’anore:

**“O Rabbi im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!”** 23-Muminun: 99, 100; dhe ka thënë se këtu me shprehjen *‘ta kompensoj’* qëllim është haxhi.

Sa për farzet e haxhit, janë pesë: ihrami (nijeti dhe telbije), tavafi, sa’j (mes Safas dhe Merves), qëndrimi në Arafat dhe qethja (apo rruajtja) e flokëve.<sup>34</sup> Këto janë farze edhe të umres, përpos qëndrimit në Arafat.

---

<sup>34</sup> Sipas medh’hebit hanefi, farze të haxhit janë tre: ihrami, qëndrimi në Arafat dhe tavafi zijaret.

Janë gjashtë vaxhibe të haxhit që, nëse një prej tyre nuk kryhet, dënim është therrja e një deleje kurban:

1. Nijeti dhe veshja e ihramit në vend të caktuar (*mikat*); prandaj ai që e kalon atë vend dhe nuk e bën nijet dhe nuk vesh ihramin aty, duhet të therrë një dele kurban.

2. Gjuajtja e guralecëve; nëse haxhiu nuk i gjuan guralecët, këtë të gjithë e konsiderojnë shkelje për të cilën therret një dele kurban.

3. Qëndrimi në Arafat deri në lindjen e Diellit;

4. Buajtja në Muzdelife;

5. Buajtja në Mine; dhe

6. Tavafi lamtumirës; nëse haxhiu e kryen i papastër.

Sipas një mendimi tjetër, të therret kurban nëse braktiset një prej këtyre vaxhibeve është vetëm e lavdërueshme (*mustehab*).

## ***Llojet e haxhit***

Haxhi ndahet në tri lloje:

1. ***Haxhi Ifrac***, që është më i preferuari. Kur ndodhet në mikat duhet ta bëjë nijet vetëm për haxh dhe pasi që të kryhet haxhi, do të lirohet nga ihrami, përsëri do ta bëjë nijet dhe do ta veshë ihramin e ta kryejë edhe umren.

Vendi më i mirë që ta bëjë nijet umren dhe përsëri ta veshë ihramin është el-Xha'rane, më pas et-Ten'im dhe el-Hudejbije. Ai që në këtë mënyrë e kryen haxhin nuk është i obliguar të therrë kurban, përpos nëse vet dëshiron, si *nafile*.

2. ***Haxhi Kiran***, është kur haxhiu në mikat e bën nijet për t'i kryer bashkë haxhin dhe umren (në të njëjtin ihram) dhe i mjafton të kryejë obligimet e haxhit, e umreja hyn në haxh njëjtë si abdesi që hyn në gusul (larja e tërë trupit), pra ai që merr gusul do të thotë që ka marrë edhe abdes. Nëse e kryen tavafin dhe *sa'j*-in para qëndrimit në Arafat, *sa'j*-i i llogaritet edhe për haxh edhe për umre, por jo edhe tavafi, sepse kusht i tavafit të obligueshëm në haxh është që të kryhet pas qëndrimit në Arafat. Ai që e bën nijet për haxhin kiran e ka obligim (*vaxhib*) të therrë kurban, përpos atij që është banor i Mekes, sepse tërë Meke është mikat i tij.

3. **Haxhi Temettu**, është kur haxhiu në mikat e bën nijet dhe vesh ihramin për ta kryer umren. Pasi që i kryen obligimet e umres, e heq ihramin dhe pret deri në ditën e tetë të muajit Dhul-hixhxe, kur do t'a veshë sërish ihramin dhe e bën nijet për ta kryer haxhin.

E *haxhi temettu* i ka pesë kushte:

1. Të jetë 18 orë në largësi prej Mekes;
2. Fillimisht ta kryejë umren, e më pas haxhin;
3. Ta kryejë umren në muajt e haxhit;
4. Pasi ta kryej umren të qëndrojë në Meke,
5. Haxhi dhe umre të jenë për një person, (e jo njëra për veten e tjetra për tjetrin).

Nëse personi i plotëson këto kushte, atëherë ai mund ta bëjë haxhin *temettu* dhe e ka obligim të therrë kurban, e nëse nuk ka mundësi, duhet t'i agjërojë tri ditë në Mekë dhe shtatë ditë kur të kthehet në shtëpi. Nëse, megjithatë, nuk agjëron tri ditë në Meke dhe kthehet në shtëpi, atëherë agjëron dhjetë ditë rresht, ose edhe ndaras.

Kurbanët janë të njejtë, si për haxhin *kiran* ashtu edhe për haxhin *temettu*. Lloji më i mirë i haxhit është haxhi *ifrad*, pastaj *temettu*, dhe në fund *kiran*.<sup>35</sup>

---

<sup>35</sup> Sipas medh'hebit Hanefi është e kundërta; lloji më i mirë i haxhit është *haxhi kiran*, pastaj *temettu* dhe në fund *haxhi ifrad*.

## Gjashtë veprimet e ndaluara në haxh dhe umre

1. Veshja e rrobave të qepura si shallvare, xhybe, kapelë, këpucë, e të ngjashme. Nëse veshë rroba të qepura, duhet të therrë një dele kurban.

Mashkulli duhet të veshë ihram i cili përbëhet prej dy pjesëve: pjesa e sipërme që quhet *rida* dhe pjesa e poshtme - *izar*. Pra, janë dy peshtamallë, i sipërm dhe i poshtëm, dhe papuçe ose sandale që nuk e mbulojnë zogun e këmbës. Nëse nuk ka peshtamall të poshtëm (izar), mund të veshë brekë të gjata. Mund të bartë edhe rrip, si edhe t'i bëjë vetes hije me ombrellë, por që nuk duhet t'ia prekë kokën. Gruaja i përmbahet veshjes së saj dhe vetëm fytyrën nuk e mbulon.

2. Përdorimi i parfumeve; para se të veshë ihramin mund ta përdorë, e pasi që e veshë ihramin deri sa ta heqë atë, nuk lejohet të parfumohet. Nëse parfumohet, duhet të therrë një dele kurban.

3. Prerja e thonjve dhe rruajtja apo qethja e flokëve dhe mustaqeve. Nëse e bën ndonjë nga këto, i duhet të therrë kurban. Nuk pengon të përdorë surme, të hyjë në banjo, të lëshojë gjakun dhe të krehet.



4. Marrëdhëniet seksuale. Nëse kjo ndodhë para qëndrimit në Arafat, haxhi prishet. Nëse ndodhë pas qëndrimit në Arafat dhe para tavafit zijaret, nuk e prishë haxhin, por e ka obligim të therrë një deve kurban.

5. *Ajo që nxitë marrëdhënien seksuale.* Të tilla janë përqaqimi, puthjet e ledhatimet. Si shpagesë, therrë një dele kurban.

6. Gjuetia e shpendëve dhe e kafshëve tokësore. Nëse gjuan kafshë që ju hahet mishi, e ka obligim të therrë kurban, derisa peshkimi në det lejohet.

## Kapitulli i dytë

### **RENDITJA E DETYRAVE QË DUHET TË BËHEN NGA FILLIMI I UDHËTIMIT NË HAXH, DERI NË KTHIM**

#### DETYRA E PARË

*Udhëtimi nga shtëpia deri te vendi i veshjes së ihramit*

Kjo i ka tetë pjesë:

1) E para ka të bëjë me pasurinë. Mbi të gjitha, ai duhet të pendohet për të gjitha gjynahet e bëra, e më pas duhet të kërkojë hallallëk nga personat që u ka hyrë në hak, të kthejë borxhet, të sigurojë kushtet materiale që u janë të domosdoshme për të jetuar atyre që i ka obligim, deri në kthimin e tij, t'i kthejë amanetet, me vete të marrë para që i ka fituar hallall, aq sa do t'i mjaftojnë. Para se të nisët për rrugë, duhet të japë sadaka dhe të blejë ose të merr me qira mjet të fortë udhëtimi, që do ta përballojë rrugën. Por kur merr me qira, duhet ta njoftojë pronarin me gjithçka që ka ndërmend ta ngarkojë në mjet, qoftë kjo pak apo shumë, që as pronari i mjetit të mos ketë asgjë kundër asaj ngarkese.

2) E dyta ka të bëjë me bashkudhëtarin. Ai që udhëton për në haxh duhet të zgjedhë bashkudhëtarë të mirë të cilët do t'i ndihmojnë kur ky të dobësohet, e përkujtojnë kur ky të harrojë, e mësojnë kur nuk di ndonjë gjë, e urdhërojnë në të mirë dhe e ndalojnë nga e keqja, e përkrahin dhe ndihmojnë në ibadet, e nxisin në durim kur ky të ketë vështirësi. Duhet të përshëndetet me miq, me të afërm dhe komshitë para se të niset dhe do t'i lus të bëjnë dua për të, sepse Allahu Teala i begaton duatë e tyre. Është sunnet që haxhia të përcjellet me këtë dua:

**“Allahut Teala amanet i qoftë feja jote, porosia jote dhe përfundimi i mirë i veprave tua.”<sup>36</sup>**

Kush vendoste të marrë rrugë, Resulallahu, s.a.v.s., i thoshte:

**“Allahu Teala të pastë nën mëshirën dhe mbrojtjen e Tij, ta shtoftë devotshmërinë, t'i faltë gjynahet e të udhëzoftë në rrugë të hajrit, kahdo që të jesh!”<sup>37</sup>**

3) Dalja nga shtëpia. Para se të niset për në haxh, duhet t'i falë dy reqate namaz; pas *Fatihësë*, në reqatin e parë lexon suren *Kafirun*, e në të dytin *Ihlas*. Pastaj ngrit duart dhe me nijet të singërtë lexon këtë dua:

**“Allahumme entes-sabihu fis-sefer vel-halifetu fil-ehli, vel-mali vel-veledi vel-as’hab; ihfazna ve ijjahum min kulli afetin ve ahetin. Ahhalumme inna nes-eluke fi mesirina**

---

<sup>36</sup> Ebu Davud dhe Tirmidhi

<sup>37</sup> Taberani nga Enesi.

***hazel-birre vet-takva ve mine-l-ameli ma terda. Allahumme inna nes-eluke en tatvije lenel-erda ve tuhevvine alejnes-sefere ve en terzukana fi seferina selametel-bedeni ved-dini vel-mali ve tubelligana haxhxhe bejtike ve zijarete kabri nebijjike, salallahu alejhi ve selem. Allahumme inna ne'udhu bike min va'sais-sefer ve-ke-abetil-munkalebi ve su'il-menzari fil-ehli, vel-mali vel-veledi vel-as'hab. Allahummexhalna ve ijjahum fi xhivarike ve la teslubna ve ijjahum ni'meteke ve la tugajjir ma bina ve bihim min 'afijetike."*** (Allahu im, Ti je udhëheqësi im në këtë udhëtimin, Ti je mbrojtës dhe kujdestar i familjes, pronës, fëmijëve dhe shokëve të mi. Na ruaj neve dhe ata nga çfarëdo sëmundje a fatkeqësie. Allahu im, Ty të lusim për të mira në rrugën tonë, na mundëso të jemi të devotshëm dhe të veprojmë vetëm atë me të cilën Ti je i kënaqur! Allahu im, Ty të lusim që largësinë e rrugës të na e bësh të durueshme, të na e lehtësosh udhëtimin, që në këtë udhëtim të na dhurosh shëndet, të na e ruash fenë, të na mundësosh vizitën shtëpisë Tënde dhe varrit të Resulallahut, s.a.v.s.! Allahu im, nga Ti kërkojmë mbrojtje nga lodhja dhe fatkeqësia në rrugë, si edhe nga ndodhitë e padëshiruara në familje, pronë, fëmijë e shokë! Allahu im, na mundëso neve dhe atyre afërsinë Tënde, mos na privo neve dhe ata nga mirësia Jote dhe mbaje mëshirën Tënde që Ti na e dhurove neve dhe atyre!)

4) Te dyert e shtëpisë lexon këtë dua:

***“Bismilahi tevekkeltu alallah ve la havle ve la kuvvete ila bilah. Rabbi e’udhu bike en edile ev udale, ev ezile ev uzele, ev azlime ev uzleme, ev exhhele ev juxhhele alejje. Allahumme inni lem ahruxh eshiren ve la betiren ve la rija’en ve la sum’aten vel harexhtut-tika’e sehatike veb-tiga’e merdatike ve kada’e fardike vet-tiba’a sunneti nebijjike ve shevkam ila lika’ike.”*** (Me emrin e Allahut, tek Ai mbështetem! Nuk ka forcë a fuqi pos me Allahun! Rabbi im, tek Ti mbrojtje kërkoj nga humbja e rrugës e të mos jem unë shkaktar që dikush ta humb rrugën; të mos poshtëroj e të mos poshtërohem, të mos ngec në rrugë e të mos jem shkaktar që dikush të ngec, të mos bëj padrejtësi e të mos më bëhet padrejtësi, të mos veproj nga mosdija e të mos veprojnë ndaj meje me mosdije. Allahu im! Unë nuk morra rrugë nga zemërimi, as nga mendjemadhësia, as nga dyfytërsia, as nuk po marr rrugë të kërkoj reputacion, por morra rrugë që të mbrohem nga zemërimi Yt dhe të fitoj rizanë Tënde, që ta kryej obligimin që ma ke ngarkuar, të pasoj sunnetin e Resulallahut, s.a.v.s., dhe u nisa nga malli për takim me Ty.)

E kur të nis rrugëtimin, e lexon këtë dua:

***“Allahumme biken-teshertu ve alejke tevekkeltu ve bika’tesamtu ve ilejke tevexhxehtu. Ahhahumme ente sikati ve ente rexha’i fe-k-fini ma ehemmeni ve ma la ehtemmu bihi ve ma ente a’lemu bihi minni, ‘adhhe xharuke ve xhele sena’uke ve la ilahe gajruke. Allahumme***

**zevvidnit-takva veg-fir li zenbi ve vexhxihni lil-hajri ejnema tevexhxhehtu.**" (Allahu im, me emrin Tënd u nisa, tek Ti mbështetem, rrugës Tënde i mbahem dhe tek Ti jam nisur! Allahu im, Ti je shpresa ime, prandaj më mbroj nga ajo që më mundon, dhe nga ajo që nuk më mundon, dhe nga ajo që Ti e di më mirë se unë, i lartësuar qofsh Ti dhe hamd i lartësuar qoftë për Ty, nuk ka zot pos Teje! Allahu im, ma shto takvallëkun, m'i fal gjynahet e bëra dhe më udhëzo në të mirë, kahdo që të nisem!)

Këtë dua e lexon në secilën shtëpi që hyn.

5) Kur ulet në mjetin e udhëtimit, lexon këtë dua:

**"Bismilahi ve bilahi vallahu ekber, tevekkeltu alellahi ve la havle ve la kuvvete ila bilahil-alijjil-adhim ma sha'allahu kane ve ma lem jeshe'lem jekun. Subhanelledhi sehhare lena hadha ve ma kunna lehu mukrinine ve inna ila rabbina lemunkalibun. Allahumme inni vexhxhehtu vexhhije ilejke ve fevvadtu emri kulehu ve tevekkeltu fi xhemi'i umuri alejke ente hasbi ve ni'mel-vekil."**(Me emrin e Allahut, me Allahun, Allahu është më i madhi! Tek Allahu mbështetem! Nuk ka forcë as fuqi përpos me Allahun, të Lartësuarin e të Fuqishmin! Atë që Allahu e dëshiron, ajo ndodh, e atë që Ai nuk e dëshiron, nuk ndodh. I Lartësuar qoftë Ai i cili na e nënshtroi këtë mjet neve. Pa ndihmën e Tij, nuk do ta kishim këtë mjet për vete dhe ne vërtetë do t'i kthehemi Rabbit tonë. Allahu im! Unë fytyrën time e kam kthyer kah Ti, dhe çështjen time ta

*kam dorëzuar Ty, dhe në gjithçka në Ty u mbështeta. Ti më mjafton dhe Ti je mbrojtësi më i miri.)*

Kur rehatohet në mjet të udhëtimit, lexon shtatë herë:

***“Subhanallahi vel-hamdu lilahi ve la ilahe illallahu vallahu ekber.”*** (*Lavdia dhe hamdi i takojnë Allahut. Nuk ka zot tjetër pos Allahut. Allahu është më i madhi!*)

E më pas lexon:

***“El-hamdu lilahil-ledhi hedana li hadha ve ma kunna li nehtedije lev la en hedanallah. Allahumme entel-hamilu aledh-dhahri ve entel-muste’anu alel-umur.”*** (*Hamd Allahut, i Cili na udhëzoi në këtë, e ne nuk do ta gjenim rrugën e drejtë po të mos na udhëzonte Ai në të. Allahu im, në pushtetin Tënd është udhëtimi dhe Ti je ndihmës në gjithçka!)*

6) Ndalesa me mjetin e udhëtimit. Ishte zakoni i Resulallahut, s.a.v.s., që të mos ndalet deri sa Dielli të ngrohë mirë, e më së shumti udhëtonte natën. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Udhëtoni në pjesë të natës, sepse udhëtimi natën është më i durueshëm e më i lehtë se udhëtimi ditën.”***<sup>38</sup>

Duhet të flejë më pak, që të arrijë më shpejtë. Sa herë që t’i afrohet ndonjë vendbanimi, le ta lexojë këtë dua:

***“Allahumme rabbes-semavatis-seb’i ve ma adhlelne ve rabbel-erdines-seb’i ve ma aklelne ve rabbesh-shejtani***

---

<sup>38</sup> Ebu Davud nga Enesi, pa fjalët: “...se udhëtimi ditën.” Këto fjalë i ka shënuar Malikiu në *el-Muvetta* nga Halid ibn Ma’dan si hadith mursel.

**ve ma adlelne ve rabber-rijahi ve ma zerejne, ve rabbel-bihari ve ma xherejne es-eluke hajre hazel-menzili ve hajre ehlili ve e'udhu bike min sherrihi ve sherri ma fihi, istif 'anni sherre shirarihim."** (Allahu im, Rabb i shtatë qiejve dhe asaj që ato e mbajnë, Rabbi shtatë kateve të tokës dhe asaj që ajo e mbanë, Rabb i shejtanit dhe i mashtrimit të tij, Rabb i erës dhe i asaj që era e shpërndanë, Rabb i detëve dhe i asaj çfarë në to noton – prej Teje kërkoj të mirën e këtij vendbanimi dhe të mirën e banorëve të tij! Tek Ti kërkoj mbrojtje nga e keqja e këtij vendbanimi dhe e keqja që gjendet në të! Largoje prej meje të keqen!)

E kur hyn në në vendbanim, i falë dy reqate nafile, e më pas lexon:

**"E'udhu bi kelimatillahit-tammatilleti la juxhavizuhunne berrun ve la faxhirun min sherri ma haleka."**(Mbrohem me fjalët e plota të Allahut të cilat nuk mund t'i shpërfillë ai që bën mirë e as ai që bën keq, nga e keqja e asaj që Ai e ka krijuar!)

Kur ta zë nata, le të lexojë:

**"Ja erdu rabbi ve rabbukil-lahu e'udhu bilahi min sherriki ve sherri ma fiki ve sherri ma debbe 'alejki, e'udhu bilahi min sherri kuli esedin ve esvede ve hajjetin ve 'akrebin ve min sherri sakinil-beledi ve validin ve ma velede. Ve lehu ma sekene fil-lejli ven-nehari ve huves-semi'ul-alim."** (Oj Tokë, Rabb i imi e i joti është Allahu. Tek Allahu mbrojtje kërkoj nga e keqja jote, e keqja e asaj që ti



*e mbanë, e keqja e asaj që lëvizë mbi ty. Tek Allahu mbrojtje kërkohet nga luani, nga gjarpri e nga kafshët grabitqare, nga gjithçka që ti e mbanë. “E Tij është çdo gjë që rri dhe lëvizë natë e ditë. Ai i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë.” [6-Enam:13].)*

7) Siguria dhe mbrojtja. Gjatë ditës, udhëtari duhet të marrë masa për kujdes dhe të mos ndahet nga grupi, sepse mund të vritet a të humbasë. Sidomos duhet të jetë i kujdesshëm natën, kur shtrihet për gjumë; nëse flen në fillim të natës, duhet të flejë ulur këmbëkryq, nëse flen para sabahut duhet t’i mbledhë gjunjat dhe t’i vendosë bërrylat në gjunj e ta mbështesë kokën mes pëllëmbëve. Kështu vepronte Resulallahu, s.a.v.s., kur flinte gjatë udhëtimit, që të mos e zë gjumi e të lind dielli e t’i ikë farzi i sabahut. Më së miri do të ishte që gjatë natës të ndërrohen dy rojtarë, ashtu që derisa njëri të fle, tjetri bën roje. Kështu vepronte Resulallahu, s.a.v.s..

Nëse gjatë natës e sulmon armiku ose ndonjë bishë e egër, le ta lexojë *ajetul-kursinë*, ajetin Kur’anor ***shhidallahu...***, suret *Ihlas*, *Felek* dhe *Nas*. Më pas lexon:

***“Bismilahi ma sha’allahu la kuvvete ila bilah. Hasbijallahu tevekkeltu ‘alallahi, ma sha’allahu la je’ti bil-hajri ilallah. Ma sha’allahu la jasrifus-su’e ilallahu, hasbijallahu ve kefa, semi’allahu li men de’a, lejse vera’allahi munteha ve la dunallahi melxhe’a, keteballahu le aglibenne ene ve rusuli inallahe kavijjun***

*'aziz,tehassantu bilahil-adhim ves-tegastu bil-hajjiledhi la jemutu. Allahummah-rusna bi'ajnikelleti la tenamu venifna bi ruknikelledhi la juram. Allahummer-hamna bi kudretike 'alejna fe la nuhleku ve ente sikatuna ve rexa'una.Allahumme 'a'tif'alejna kulube 'ibadike v eima'ike bi re'fetin ve rahmetin, inneke ente erhamur-rahimin.*"(Me emrin e Allahut, dhe ashtu si Allahu dëshiron! Nuk ka forcë pos me Allahun! Allahu Teala më mjafton, dhe tek Ai mbështetem! Si do Allahu, vetëm Allahu e sjell të mirën! Si do Allahu, dhe vetëm Ai e largon të keqen! Më mjafton Allahu Teala, dhe kjo është e mjaftueshme! Allahu Teala e dëgjon atë që i drejton dua. Allahu është qëllimi i vetëm dhe Ai është strehimi i vetëm. **Allahu e ka shkruar: "Unë dhe të dërguarit e Mi patjetër do të ngadhënjëm!" Allahu është i fortë, ngadhënjyes**" [58-Muxhadele: 21]. Me ndihmën e Allahut u mbrojta dhe ndihmë kërkova nga i Gjalli, i Cili nuk vdes. Allahu im! Na mbrojë me syrin Tënd, që nuk fle dhe na ruaj me mbrojtjen Tënde, që nuk ka si ajo. Allahu im! Bëhu me rahmet ndaj nesh me fuqinë Tënde me të cilën na udhëheq, e të mos jemi të shkatërruar përderisa Ti je siguria dhe shpresa jonë. Allahu im! Në zemra të robëve Tu mbjell mëshirë dhe butësi ndaj nesh, sepse Ti je Mëshiruesi më i Mëshirshëm.)

8) Sa herë që gjatë udhëtimit të ngjitet në ndonjë vend të lartë, le të thotë tri herë: *Allahu Ekber!*, e më pas të lexojë: **"Allahumme lekesh-sherefu 'ala kuli sheref, ve**

***lekel-hamdu ‘ala kuli hal.”*** (Allahu im! Ty të takojnë të gjitha lavdërimet për të gjitha bereqetet! Ty të takon hamdi, në secilën gjendje).

Kur zbret në vende të ulta, le të lexojë *Subhanallah*, e kur frikësohet nga vetmia, le të lexojë:

***“Subhanallahil-melikil-kuddus, rabbil-mela’iketi ver-ruh. Xhelleletis-semavatu bil-‘izzeti vel-xhebarut”*** (I Lavdëruar është Allahu, Sundimtari, i Shenjti, Rabb i melekëve e i shpirtit; e madhështinë dhe pushtetin e Tij e madhërojnë edhe qiejt.)

## DETYRA E DYTË

### *Edebet e veshjes së ihramit në mikat deri te hyrja në Meke*

Kjo i ka pesë pjesë:

1) Kur arrin në vendin e mikatit, para se të veshë ihramin pastrohet plotësisht, për çka kemi folur në librin për pastërtinë (si t'i prejë thonjtë, pastrimi i qimeve nën sqetull dhe në vendet e turpshme,) lahet mirë dhe e bën nijet pastrimin për veshjen e ihramit.

2) Heq rrobat e qepura dhe e veshë (mbështjellat me) ihramin. Ihrami është mirë të jetë i bardhë. Nëse do, mund ta parfumosë trupin, e nuk pengon nëse është aromë e cila di të mbetet edhe pas veshjes së ihramit. Resulallahut, s.a.v.s., pasi që e veshi ihramin, në qafën e tij u pa gjurmë e miskut që e kishte përdorë para veshjes së ihramit.

3) Pasi që e veshë ihramin, të ketë durim deri sa të arrijë mjeti i udhëtimit. Në atë kohë bën nijetin për të kryer haxhin *kiran, ifrad, temettu*, ose për të kryer umren. Mjafton ta thotë nijetin që të bëhet *muhrim* (person nën ihram), por ishte zakoni i Resulallahut, s.a.v.s., që bashkë me nijet të thotë edhe telbije:

***“Lebbejke, Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, innel-hamde ven-ni’mete leke vel-mulk la sherike leke.”*** (Të përgjigjem O Allah, të përgjigjem, Ti je i

*pashoq, të përgjigjem, vërtetë falënderimi dhe begatitë e sundimi të takojnë Ty, Ti je i pashoq.)*

Nëse do, le të thotë edhe:

***“Lebbejke ve sa’dejke vel-hajru kulluhu bijedejke ver-regaba’u ilejke lebbejke bi haxhxhetin hakkan ve te’abbuden ve rikkan. Allahume sali ‘ala Muhammedin ve ‘ala ali Muhammed.”*** (Të përgjigjem dhe të kërkoj ndihmë o Allah, të gjitha të mirat janë me Ty, të gjitha dëshirat Ty të janë drejtuar. Të përgjigjem Ty ashtu që vërtetë i kryej obligimet e haxhit, duke të shprehur dhe treguar nënshtrim vetëm Ty. Allahu im, dërgoi salavat Muhammedit dhe familjes së Muhammedit!)

4) Kur të veshë ihramin e të bëhet *muhrim*, dhe e thotë telbijen, do të ishte mirë të thotë:

***“Allahume inni uridul-haxhxhe fe jessirhu li ve tekabbelhu minni. Allahumme inni nevejtu eda’e feridatike fil-haxhxhi fexh’alni mineledhine-stexhabu leke ve amenu bi va’dike vettebe’u emreke vexh’alni min vefdikeledhine radite ‘anhum vertedajte ve kabilte minhum. Allahumme fe jessir li eda’e ma nevejtu minel-haxhxh. Allahumme kad ahreme leke lahmi ve sha’ri ve demi ve ‘asabi ve muhhi ve ‘izami ve harremtu ‘ala nefsin-nisa’e vet-tibe ve lebsel-mehiti-btiga’e vexhhike veddarel-ahirete.”***

*(Allahu im! E kam bërë nijet të kryej obligimin e haxhit, prandaj ma lehtëso dhe pranoje këtë haxh prej meje. Allahu im! E kam bërë nijet t'i kryej obligimet e haxhit, prandaj më bëj të jem prej atyre që Ty të përgjigjen, që besojnë në premtimin Tënd dhe pasojnë urdhrin Tënd! Bëj që të jem prej atyre me të cilët Ti je i kënaqur dhe të cilëve ju ke pranuar ibadetet. Allahu im! Ma lehtëso kryerjen e obligimeve të haxhit të cilat e kam bërë nijet t'i kryej! Ihram për Ty bëhet mishi im, flokët e mia, gjaku im, damarët e mi, mendja ime dhe eshtrat e mi, e në emrin Tënd, duke e dëshiruar ahiretin, vetes ia kam ndaluar gratë, parfumin dhe veshjen e rrobave të qepura.)*

Pasi të veshë ihramin dhe ta bëjë nijet, fillojnë të vlejné ndalesat që i përmendëm më herët, prandaj haxhia le të ketë kujdes.

5) Është mirë që vazhdimisht të thotë telbijen, kur takohet me udhëtarët tjerë, kur të mbledhen njerëzit, kur të ngjitet në ndonjë vend të lartë, kur zbret në vende të ulta, kur të jetë ulur në mjetin e udhëtimit dhe kur të zbret nga ai, dhe atë me zë, por të mos e mundojë fytin e as të mbushet frymë, sepse, me një hadith është thënë:

***“Nuk po e fton as të shurdhëtin as të humburin.”***<sup>39</sup>

---

<sup>39</sup> Muttefekun alejhi, nga Ebu Musa.

Nuk pengon ta ngrisë zërin në tri xhamia: në *Mesxhidul-haram*, në xhaminë *el-Hajf* dhe në xhaminë në vendin ku e veshë ihramin, sepse ato janë vende të ibadeteve të haxhit. Në xhamitë tjera lejohet të lexohet telbije, por me zë të ulët. Kur Resulallahut, s.a.v.s., i pëlqente diçka, thoshte:

**“Të përgjigjem Ty! Nuk ka dyshim që jeta e vërtetë është jeta e ahiretit!”<sup>40</sup>**

#### DETYRA E TRETË

*Edebet para hyrjes në Meke e deri te kryerja e tavafit*

Kjo i ka gjashtë pjesë:

1) Për hyrje në Meke, duhet të lahet në vendin *Zu Tuva*. Përndryshe, gjatë kryerjes së haxhit duhet të lahet nëntë herë: me rastin e veshjes së ihramit në mikat, me rastin e hyrjes në Meke, larja për tavafin kudum (tavafin e arritjes), larja për qëndrim në Arafat, larja për qëndrim në Muzdelife, tri larje për të gjuajtur guralecët, larja për tavafin lamtumirës. Imam Shafiu nuk e ka konsideruar të nevojshme larjen për tavafin kudum dhe për atë lamtumirës, e sipas këtij mendimi, bëhen shtatë larje.

---

<sup>40</sup> Esh-Shafi në *Musned* nga Muxhahidi, si mursel. Hakimi, që e vërteton besueshmërinë e tij nga Ibn Abbas.

2) Kur hyn në hapësirat e haremit të Mekes, lexon:

***“Allahumme haza haremuke ve emnuke fe harrim lahmi ve demi ve sha’ri ve besheri ‘alen-nari ve aminni min ‘azabike jevme teb’asu ‘ibadike vexh-‘alni min evlija’ike ve ehli ta’atike.”*** (Allahu im! Ky është haremi Yt, hapësira Jote e mbrojtur, prandaj mbroje nga zjarri mishin tim, gjakun tim, flokët e mi dhe lëkurën time, dhe më mbrojë nga dënimi Yt në ditën kur të ngjallësh robët e Tu dhe bëj që unë të jem nga robët e Tu të sinqertë dhe nga ata që vetëm Ty të janë besnik!).

3) Në Meke duhet të hyjë nga ana e *Ebtahut* (luginja e Mekes), e cila zgjerohet nga shpatet e Kedasë, sepse Resulallahu, s.a.v.s., e bënte kthesën në këtë luginë.<sup>41</sup> E me rastin e daljes duhet marrë rruga e luginës së Kudit, e kjo është një shpat më i ulët, deri sa e para, Keda, është më e pjerrtë.

4) Kur të hyjë në Meke e të vijë deri te maja Redem, prej nga shihet Qabeja, le të lexojë:

***“La ilahe illallahu vallahu ekber. Allahumme enters-selamu ve minkes-selamu ve daruke darus-selami tebarekte ja dhel-xhelali vel-ikram. Allahumme inne haza bejtuke ‘azzamtehu ve kerremtehu ve sherreftehu allahumme fe zidhu ta’zimen ve zidhu teshrifen ve tekrimen ve zidhu mehabeten ve zid men haxhxhehu***

---

<sup>41</sup> Muttefekun alejhi nga Ibn Omeri.



**birren ve kerameten. Allahumme-f-tah li ebvabe rahmetike ve edhilni xhenneteke ve e'idhni minesh-shejtanir-raxhim."** (Nuk ka zot pos Allahut, Allahu është më i madhi! Allahu im, Ti je burim i shpëtimit dhe prej teje vjen shpëtimi, shtëpia Jote është shtëpi e paqes, i Lartësuar je Ti, Rabb i madhështisë e fisnikërisë. Allahu im! Kjo është shtëpia Jote, të cilën e ke lartësuar dhe e ke nderuar dhe i ke dhënë vend të posaçëm! Allahu im, shtoja madhështinë e nderin, dhe atyre që e vizitojnë shtoj të mirat e nderin! Allau im, m'i hap dyert e rahmetit Tënd dhe më dërgo në xhennet dhe më mbrojë nga shejtani i mallkuar!)

5) Kur të hyjë në Mesxhidul-haram, le të hyjë nga dera Beni Shejbe dhe le të lexojë këtë dua:

**"Bismilahi ve bilahi ve minallahi ve ilallahi ve fi sebilil-lahi ve'ala mileti resulillahi, salallahu'alejhi ve selem."**(Me emrin e Allahut, me Allahun, nga Allahu dhe te Allahu, në rrugën e Resulallahut, s.a.v.s., dhe pasuesve të tij.)

Kur t'i afrohet Qabes, le të lexojë:

**"El-hamdu lilahi ve selamun 'ala 'ibadihiledhinas-tafa. Allahumme sal-li 'ala Muhammedin 'abdike ve resulike ve 'ala Ibrahime halilike ve 'ala xhemi'i enbija'ike ve rusulike."** (Hamd Allahut dhe selam robëve të Tij të zgjedhur. Allahu im, bekoje Muhammedin, robin dhe të dërguarin Tënd, dhe Ibrahimin, mikun Tënd, dhe të gjithë të dërguarit e Tu dhe pejgamberët Tu), e më pas i ngritë duart dhe lexon këtë dua:

***“Allahumme inni es’eluke fi mekami hadha ve fi evveli menasiki en takbele tevbeti ve en tetexhaveze ‘an hati’eti ve en teda’a ‘anni vizri. El-hamdu lilahiledhi belegani bejtuhul-haramel-ledhi xhe’alehu mesabeten linnasi ve emnen ve xhe’alehu mubareken ve huden lil-alemine. Allahumme inni ‘abduke vel-beledu beleduke vel-haremu haremuke vel-l-bejtu bejtuke xhi’tu atlubu rahmeteke ve es’eluke mes’eletel-mudtarril-ha’ifi min ‘ukubetiker-raxhi li rahmetiket-talibi merdateke.”***(Allahu im, në këtë vend e në këtë obligim të parë nga Ti kërkoj të ma pranosh pendimin, të m’i falësh gabimet e të ma largosh barrën. Hamd Allahut, që më mundësoi vizitë në shtëpinë e Tij të shenjtë, që e ka begatuar, e ka bërë strehimore e vend të sigurtë për njerëzit, udhëzim për botët. Allahu im, unë vërtetë jam rob i Yti. Ky është qyteti Yt. Këtu është haremi Yt. Kjo është shtëpia Jote. Erdha këtu të kërkoj rahmet, si nevojtar, me frikë nga dënimi Yt, me shpresë për rahmetin Tënd, me kërkesë për rizanë Tënde.)

6) Pas kësaj duhet të niset drejt gurit të zi (*haxherul esvedi*), ta prekë me dorën e djathtë, ta puthë e të lexojë këtë dua: ***“Allahumme emaneti edejtuha ve misaki vefejtuhu, ishhed li bil-muvafat.”*** (Allahu im, e përmbusha amanetin dhe e plotësova marrëveshjen, e Ti dëshmo besnikërinë time!)

Nëse nuk është në gjendje ta puthë gurin e zi për shkak të grumbullit të madh të njerëzve, do të qëndrojë karshi tij, e ngritë dorën e djathë, e përshëndet me dorë dhe e puthë dorën e vet, dhe lexon duanë e njëjtë. Pas kësaj nuk do të bëjë asgjë tjetër deri sa ta bëjë tavafi-kudum, përpos nëse takon xhemat që janë duke falë namazin farz; në atë rast do t'ju bashkëngjitet e do të falë namazin, e pas namazit do ta bëjë tavafin.

#### DETYRA E KATËRT

##### *Edebet e tavafit (rrotullimit rreth Qabes)*

Kur haxhia të vendosë ta bëjë tavafi-kudum ose ndonjë tavaf tjetër, duhet të këtë kujdes për gjashtë gjëra:

1) Duhet të jetë i kujdesshëm për abdesin, pastërtinë e trupit dhe rrobave dhe për t'i mbuluar pjesët intime, sikur për shartet e namazit, sepse tavafi konsiderohet namaz, përveç që Allahu Teala në tavaf e ka lejuar të flitet. Para se të fillojë me tavafin, duhet të mbështillet me ihramin e epërm ashtu që do ta vendosë pjesën e tij të mesme nën sjetullën e djathtë dhe njërenë anë ta gjuajë përmbi krahun e majtë, e tjetrin rreth gjoksit. Pra, krahu i djathtë të jetë i pambuluar ndërsa i majti i mbuluar. Kur të fillojë ta bëjë tavafin, haxhiu e ndal telbijen dhe bën dua, të cilat do t'i tregojmë më vonë.

2) Kur ta veshë ihramin e epërm ashtu siç treguam, anën e majtë do ta kthejë kah Qabeja, do të qëndrojë drejtuar kah guri i zi dhe pak do të lakohet mbrapa, ashtu që guri të jetë para tij, që i gjithë trupi i tij, në fillim të tavafit, të mund të kalojë para gurit. Le të provojë të qëndrojë pranë Qabes, rreth tre hapa larg, sepse kjo është më e mira, dhe nuk bën tavaf mbi *Shazervan*, për shkak që Shazervani është pjesë e Qabes, e tavaf duhet të bëhet nga ana e jashtme e saj. Te guri i zi ato pjesë mund të bashkohen me tokën në atë mënyrë që mund të mos i vërejë ai që bën tavaf, e tavafi nuk do t'i jetë i drejtë nëse shkelë mbi këto pjesë, sepse kjo do të ishte sikur ta bëjë tavafin brenda Qabes. *Shazervan* është pjesa e zgjeruar e anës së poshtme të murit të Qabes, që ka mbetur pasi që muri është ngushtuar. Nga ky vend do ta fillojë tavafin.

3) Para se ta kalojë gurin e zi, le ta lexojë këtë dua:

***“Bismillahi vallahu ekber! Allahumme imanen bike ve tasdikan bikitabike ve vefa’en bi’ahdike vet-tiba’an li sunneti nebijjike Muhammedin salallahu ‘alejhi ve selem.”*** (Me emrin e Allahut! Allahu është më i madhi! Allahu im, me besim në Ty e në librin Tënd, duke zbatuar marrëveshjen Tënde, dhe duke pasuar sunnetin e të Dërguarit Tënd, Muhammedit, s.a.v.s.)

Pasi që ta kalojë gurin e zi, kur afrohet te dera e Qabes, le të lexojë këtë dua:

***“Allahumme hazel-bejtu bejtuke ve haztel-haremu haremuke ve hazel-emnu emnuke; ve haza (këtu shikimin do ta drejtojë kah Mekami-Ibrahim) mekamul-a’idhi bike minen-nar. Allahumme inne bejteke ‘azimun ve vexhheke kerimun ve ente erhamur-rahimin fe e’idhni minen-nari minesh-shejtanir-raxhimi ve harrim lahmi ve demi ‘alen-nari ve aminni min ehvali jevmil-kijameti vekfini mu’neted-dunya vel-ahireti.”*** (Allahu im! Kjë është shtëpia Jote; ky harem, është haremi Yt; kjo siguri është siguria Jote; (drejton shikimin kah Mekami-Ibrahim) e ky është vendi i atyre që tek Ti kërkojnë mbrojtje nga Zjarri. Allahu im! Vërtetë që shtëpia Jote është e lartësuar, e fisnikëria Jote është e pashembullt dhe Ti je i gjithmëshirëshmi, prandaj më mbrojtë mua nga zjarri dhe shejtani i mallkuar, dhe ma ruaj mishin tim dhe gjakun tim nga zjarri, dhe më ruaj nga tmerri i ditës së kijametit dhe bëje të mjaftueshëm furnizimin tim, në këtë botë dhe në botën tjetër.)

Më pas, le të thotë ***‘subhanallah’*** dhe ***‘elhamdulillah’*** deri sa të arrijë te *qoshja irakiane*, qoshe e Qabes që është në drejtim të Irakut, e aty do ta thotë këtë dua:

***“Allahumme inni e’udhu bike minesh-shirki vesh-shekki vel-kafri ven-nifaki vesh-shikaki ve su’il-ahlaki ve su’il-menzari fil-ehli vel-mali vel-veledi.”*** (Allahu im, më ruaj nga shirku, dyshimi, mosbesimi, dyfyturësia, mashtrimi, morali i keq, telashet dhe e keqja në familje, pronë e fëmijë.)

Kur të arrijë te *mizabi* (ulluku që lëshohet nga kulmi i Qabes), le të thotë:

***“Allahumme ezillena tahte arshike jevme la zille ila zil-luk, Allahummes-kini bi ke’si Muhammedin, salallahu ‘alejhi ve selem, shrbeten la azme’u ba’deha ebeden.”***  
(Allahu im! Na vendos në flladin e Arshit Tënd në ditën kur flad tjetër, përpos flladit Tënd, nuk do të ketë! Allahu im! Më jep të pij nga gota e Muhammedit, s.a.v.s., ashtu që kurrë më të mos kem etje!)

Kur vjen te *qoshja e Shamit*, pra *qoshja e Qabes* që është në drejtim të Shamit, thotë:

***“Allahumme-xhalhu haxhxen mebruren ve sa’jen ‘alejhi meshkuren ve zenben magfuren ve tixhareten len tebure ja ‘azizu ja gafuru. Rabbig-fir ve-r-ham ve texhavez ‘amma ta’lemu inneke entel-e’azzul-ekremu.”***(Allahu im! Le të jetë i pranuar *haxhi im*, angazhimin tim në këtë rrugë bëje të lavdërueshëm, gjynahet e mia bëji të falura dhe më shpërble me shpërblim që nuk do të zhduket, o i Fuqishmi, o Ti që falë! Rabbi im! Fal, bëj rahmet dhe shpërfilli ato (prej gjynaheve tona) që vetëm Ti i di, sepse Ti je më i Lartësuari e më Fisniku.)

Kur të vjen te *qoshja e Jemenit*, *qoshja e Qabes* në drejtim të Jemenit, le ta thotë këtë dua:

***“Allahumme inni e’udhu bike minel-kufri ve e’udhu bike minel-fakri ve min ‘adhabil-kibri ve min fitnetil-mahja vel-memati ve e’udhu bike minel-hizji fid-dunya vel-ahireti”*** (Allahu im! Ty të lus të më mbrosh nga

*mosbesimi, edhe nga varfëria, edhe nga tmerret e varrit, edhe nga sprovat e jetës e të vdekjes, edhe nga gjendja e mjerë në këtë botë e në botën tjetër!)*

Në mes qoshes së Jemenit dhe gurit të zi thotë:

***“Allahumme rabbena atina fid-dunya haseneten ve fil-ahireti haseneten ve kina bi rahmetike fitnetel-kabri ve ‘azaben-nar.”*** (Allahu im! Na jep të mira në këtë botë dhe në ahiret dhe na mbro me mëshirën Tënde, nga sprovat e varrit dhe nga dënimi i xhehenemit.)

Kur të vjen te guri i zi, le ta lexojë këtë dua:

***“Allahummag-fir li bi rahmetike e’udhu birabbi hazel-haxheri mined-dejni vel-fakri ve dikis-sadri ve ‘azabil-kabri”*** (Allahu im! Pashë rahmetin Tënd, më fal! Rabb i këtij Guri, më mbroj nga borxhi, varfëria, vështirësitë e brendshme dhe tmerret e varrit!)

Ky është një rrotullim rreth Qabes. Haxhia duhet t’i bëjë edhe gjashtë, dhe në secilin rrotullim do t’i lexojë duatë siç i treguam.

4) Tri rrotullimet e para ecë me hapa të shpejtë e të vegjël, pra, të mos vrapojë e as të mos ecë, por mes këtyre dyjave, dhe e zbulon krahorin e djathë, e në katër rrotullimet tjerat ecë si zakonisht. Qëllim i kësaj është të trembet syri i mushrikëve dhe të shfaqet trimëri.

Ky ka qenë qëllimi në fillim, pasi që myslimanët ishin cak i sulmeve të mushrikëve, dhe prej kësaj mbeti edhe sunnet.<sup>42</sup> Më e mira është të ecë me hapa të shpejtë, dhe të jetë më afër Qabes. Megjithatë, nëse është kallaballëk, atëherë më mirë është të largohet pak nga Qabeja në tri rrotullimet e para, e më pas t'i afrohet Qabes, dhe bashkë me kallaballëkun t'i përfundojë katër rrotullimet tjera. Do të ishte mirë që, sipas mundësisë, në secilin rrotullim ta prekë gurin e zi, e nëse kjo nuk është e mundur për shkak të kallaballëkut, atëherë do ta ngrisë dorën në drejtim të gurit të zi dhe do ta puthë dorën e vet. Gjithashtu, është mirë që ta prekë *qoshen e Jemenit* me dorë<sup>43</sup>, ta puthë atë<sup>44</sup> dhe ta mbështesë faqen në të.<sup>45</sup> Të puthet guri i zi është më shumë e dëshirueshme, por edhe të preket qoshja e Jemenit është veprim i pëlqyeshëm.

5) Kur ta kompletojë rrotullimin rreth Qabes për shtatë herë, vjen te *Multezim*, e kjo është pjesa në mes të gurit të zi dhe derës së Qabes, vend ku dua ja pranohet.

---

<sup>42</sup> Muttefekun alejhi, nga Ibn Abbas. Për ihramin, Ebu Davud, Ibn Maxhe dhe Hakimi, nga Omeri.

<sup>43</sup> Muttefekun alejhi, shënon Buhari dhe Muslimi, nga Ibn Omeri. Muslimi, edhe nga Xhabiri.

<sup>44</sup> Muttefekun alejhi, shënon Buhari nga Omeri, dhe nga Ibn Abbasi në *et-Tarih*.

<sup>45</sup> Darkutni dhe Hakimi, nga Ibn Abbas. Hakimi thotë se ka zinxhir të besueshëm.



Le t'i afrohet Qabes, ta kapë mbulesën e saj, gjoksi le t'ia prekë Qaben, ndërsa nofullat, parakrahët dhe shuplakat le t'i mbështesë në të, dhe le ta bëjë këtë dua:

***“Allahumme ja rabbel-bejtil-‘atik ‘a’tik rekabeti minen-nari ve e’idhni mineshejtanir-raxhim ve e’idhni min kuli su’in ve kanni’ni bima rezakteni ve barik li fima atejteni. Allahumme inne hazel-bejte bejtuke vel-‘abde ‘abduke ve haza mekamul-‘a-izi bike min-nari. Allahummexh’alni ekreme vefdike ‘alejke”*** (Allahu im, Rabb i këtij tempulli të hershëm, më shpëto nga zjarri i xhehenemit, më mbroj nga shejtani i mallkuar dhe nga çdo e keqe, më bëj të kënaqur me atë që më ke dhuruar dhe më jep bereqetin Tënd në atë që ma ke dhuruar! Allahu im! Kjo shtëpi është shtëpia Jote; ky rob është rob i Joti; ky është vendi i atyre që kërkojnë mbrojtjen Tënde nga zjarri. Allahu im, më bëj prej atyre më të ndershmeve që të kanë ardhur Ty!)

Më pas, në këtë vend le të thotë shumë ‘elhamdulillah’ dhe t’i dërgojë salavat Resulallahut, s.a.v.s., dhe të gjithë pejgamberëve tjerë, dhe le t’i drejtojë dua Allahut Teala për nevojat e veta, dhe le të kërkojë faljen e gjynaheve. Bile, disa nga të parët tanë të mirë në këtë vend kërkonin nga shërbëtorët e tyre që të largohen, që ata në vetmi t’i rrëfeshen Allahut për gjynahet e tyre.

6) Kur përfundon me këtë, i falë dy reqate pas Mekami-Ibrahim. Në reqatin e parë, pas *Fatihësë*, lexon suren *Kafirun*, e në të dytin suren *Ihlas*. Këtij i thonë *namazi i tavafit*. Zuhri ka thënë: “*Është sunnet i Resulallahut, s.a..v.s., të falen dy reqate pas çdo shtatë rrotullimeve rreth Qabes*<sup>46</sup>, e do të vlenite edhe nëse bën më shumë tavafe e vetëm një herë i falë dy reqate.”<sup>47</sup>

Pas dy reqateve namaz, lexon këtë dua:

***“Allahumme jessir lijel-jusra ve xhennibnil-‘usra veg-fir li fi-ahireti vel-ula va’simni bi eltafike hatta la ‘asike ve e’inni ‘ala ta’atike bi tevfikike ve xhennibni me’asike vexh-Ççalni mimmen juhubbuke ve juhibbu mela’iketeke ve rusuleke ve juhibbu ‘ibadekes-salihin. Allahumme habbibni ila mela’iketike ve rusulike ve ila’ibadikes-salihin. Allahumme fe kema hedejteni ilel-islami fe sebbitni-alejhi bi eltafike ve vilajetike vesta’milni li ta’atike ve ta’ati resulike ve exhirni min mudilatil-fiten.”***  
*(Allahu im, ma lehtëso atë që është e lehtë, largo nga unë vështirësitë dhe m’i fal gjynahet e kaluara dhe të ardhshme. Më mbroj me rahmetin Tënd, që të mos bëj gabime ndaj Teje dhe më ndihmo me ndihmën Tënde në rrugën e nënshtrimit Ty dhe më mbroj nga gabimet! Bëj që unë të jem nga ata që të duan Ty, që i duan melekët e Tu,*

---

<sup>46</sup> Buhari si hadith muallek, e në Sahihë gjendet edhe transmetimi nga Ibn Omeri.

<sup>47</sup> Ibn Ebu Hatim, nga Ibn Omeri. Shënon edhe Ukajli në *ed-Du’afa*, Ibn Shahin në *el-Emali* nga Ebu Hurejre.

*pejgamberët e Tu dhe robët e Tu të mirë! Allahu im! Më bëj të dashur te melekët Tu, te pejgamberët Tu, dhe te robët e Tu të mirë! Allahu im, ashtu si më udhëzove në rrugë të islamit, me rahmetin Tënd, më forco në këtë rrugë dhe më bëj prej robëve që të nënshtrohet Ty dhe të Dërguarit Tënd, a.s.. Më ruaj nga intriga që dërgon në hut!*)

Më pas, i kthehet gurit të zi, e prekë me dorë, dhe kështu e përfundon tavafin. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Kush kryen tavafin dhe i falë dy reqate namaz, është si ai që ka liruar një skllav.”<sup>48</sup>**

Qe, kështu bëhet tavafi. Përpos që për tavaf duhet të plotësohen kushtet që vlejné edhe për namaz, është vaxhib të përmbushen shtatë rrotullimet rreth Qabes, e më pas të fillohet tavafi nga guri i zi, që atij që bën tavaf Qabeja t’i jetë nga e majta, që tavafi të bëhet brenda Haremit dhe jashtë Shazervanit, që lëvizja të mos ndërprehet deri sa të përmbushen shtatë rrotullimet – këto janë vaxhibet e tavafit; të tjerat janë sunnet.

---

<sup>48</sup> Tirmidhi, dhe e konsideron hasen, Ibn Maxhe nga Ibn Omeri, Nesai dhe Bejheki në *esh-Shuab*.

## DETYRA E PESTË

### *Saj-i*

Kur ta përfundojë tavafin duhet të dalë në drejtim të Safas, që gjendet karshi pjesës së Qabes nga ana në mes të qoshes së Jemenit dhe gurit të zi. Kur të dalë nga ajo anë arrin te Safa, që është një kodrinë sa lartësia e njeriut. Resulallahu, s.a.v.s., ngjitej në lartësi sa e shihte plotësisht Qabenë<sup>49</sup>. Mjafton të fillohet *sa’ji* nga pjesa e poshtme e kodrinës, e ngjitja edhe më lartë është më e preferuar (*mustehab*). Aty janë edhe disa shkallë që janë bërë më vonë, e është mirë që ato të mos i lë më pas, sepse nuk përmbushet *sa’ji*. Duhet t’i bëjë shtatë ecje prej Safas deri në Merve, duke filluar nga Safa. Kur të ngjitet në majën e Safas, kthehet kah Qabeja e lexon duanë:

***“Allahu ekber, Allahu ekber! El-hamdu lillahi ala ma hedana! El-hamdu lillahi bi mehamidihi kuliha ala xhemi’i ni’amih kuliha. La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu juhi ve jumitu bijedihil-hajru ve huve’ala kuli shej-in kadir. La ilahe illallahu vahdeh, sadeka va’deh, ve nesare’ abdeh ve e’azze xhunde, ve hezmel-ahzabe vahdeh, la ilahe illallahu, muhlisine lehud-dine ve lev kerihel-kafirun, la ilahe illallah, muhlisine lehud-din, elhamdu lilahi rabbil-alemin.Fe subhanallahi hime tumsune ve hine tusbihun, ve lehul-hamdu fis-semavati vel erdi ve ashijen ve hine tuzhirun, juhrixhul-***

---

<sup>49</sup> Muslimi, nga Xhabiri, si edhe nga Ebu Hurejre.

*hajje minel-mejjiti ve juhrixhul-mejjite minel-hajji ve juhjil-erda ba'de mevtiha ve kezalike tuhrexhun. Ve min ajtahi en halekakum min turabin summe iza entum beshurun tenteshirun. Allahume inni es'eluke imanen da'imen ve jekinen saddiken ve 'ilmen nafi'an ve kalben hashi'an ve lisanen zakiren ve es'elukel-'afve vel-'afijete vel-mu'afated-da'imete fid-dunya vel-ahireti. Allahume sali'ala Muhammedin ve 'ala ali Muhammed."* (Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi! Hamd Allahut që na udhëzoi! Hamd Allahut për të gjitha begatitë! Nuk ka zot pos Allahut, Një e të Vetmit, Ai nuk ka ortak, Atij i takon pushteti dhe falënderimi. Ai shkakton ngjalljen dhe vdekjen. Tek Ai është çdo e mirë. Ai mundet gjithçka. Nuk ka zot pos Allahut. Ai e mbajti premtimin, e ndihmoi robin e Vet, e lartësoi ushtrinë e Vet, dhe Ai Vet i mposhti të gjithë kundërshtarët. Nuk ka zot pos Allahut. Atij sinqerisht ia zbatojmë fenë, edhe nëse kjo nuk ju pëlqen jobesimtarëve. Nuk ka zot pos Allahut. Atij sinqerisht ia zbatojmë fenë. Hamd Allahut, Rabbit të botëve. Prandaj, i lartësuar qoftë Allahu, sa herë që t'ju zë nata e sa herë që t'ju qelë sabahu. Atij i qoftë hamdi, në qiej dhe në Tokë – edhe në aksham, edhe në mesditë! Ai, nga jo e gjalla e krijon të gjallën dhe të gjallën e bën jo të gjallë. Ai e ngjallë tokën pas vdekjes së saj – njëjtë ashtu edhe ju do të ngjalleni. Një nga dëshmitë e Tij është që ju krijon nga dheu, dhe përnjëherë, njerëz të shpërndarë në të gjitha anët! Allahu im! Prej Teje kërkoj besim të vazhdueshëm dhe bindje të sinqertë, dhe dituri të

*dobishme, dhe zemër të penduar, dhe gjuhë që të kujton Ty! Të lus të më dhurosh falje dhe shëndet, dhe shërim të vazhdueshëm në këtë botë e në botën tjetër! Allahu im, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij!)*

Pas kësaj kërkon atë që dëshiron prej Allahut duke bërë dua ashtu si di. Më pas fillon sa'jin dhe lexon këtë dua:

***“Rabbig-fir ve-r-ham ve texhavez ‘amma ta’lemu in neke entel-e’azzul-ekremu. Rabbena atina fiddunya haseneten ve fil-ahireti haseneten ve kina ‘azabenar.”***  
(*Rabbi im! Fal, bëj rahmet dhe m’i fal të gjitha gjynahet që vetëm Ti i di, sepse Ti je më i Lartësuari e më Fisniku. Rabbi ynë, na jep të mira në këtë dynja dhe në ahiret, dhe na ruaj nga vuajtja e xhehenemit!)*

Pas kësaj do të niset ngadalë, deri sa të arrijë te vendi i shënuar që gjendet karshi qoshes së Mesxhidul-haram. Kur të arrijë në largësi prej gjashtë krahëve nga vendi i shënuar, lehtas do të vrapojë (*rem!*) deri te fundi i vendit të shënuar dhe prapë do të ngadalësojë ecjen.

Kur arrin në Merve, ngjitet sikur në Safa. Me fytyrë kthehet kah Qabeja dhe lexon duanë e njëjtë që e ka lexuar në Safa. Ky është një sa’j, kur kthehet në Safa do të jetë hera e dytë, dhe kështu e përsëritë ecjen shtatë herë, dhe secilën herë lehtas vrapon deri te vendi i shënuar, e në pjesët tjera ecë qetë, siç e shpjeguem. Çdo herë do të

ngjitet në Safa dhe Merve. Kur të përfundojë, e ka kryer *tavaf-i kudum* dhe sa'jin, që është sunnet. Larja nuk është kusht për sa'jin, por është mirë të jetë i pastër e me abdes, e për tavaf është vaxhib. Pasi ta përfundojë sa'jin, nuk duhet ta përsërisë pas qëndrimit në Arafat. Qëndrimi në Arafat do t'i mjaftojë si një prej veprimeve të obligueshme të haxhit, sepse për sa'j nuk është kusht që të kryhet pas qëndrimit në Arafat. Ashtu është rasti vetëm me tavafin e obliguar, e kusht i secilit sa'j është që të kryhet pas cilit do tavaf.

## DETYRA E GJASHTË

### *Qëndrimi në Arafat dhe veprimet që i paraprijnë*

Nëse haxhiu në ditën arefe arrin në Meke dhe mundet të shkojë në Arafat, nuk e kryen tavafin kudum dhe sa'jin, por pa humbur kohë menjëherë shkon në Arafat. Por, nëse ka ardhë disa ditë më parë, e bën tavafin dhe sa'jin, por nuk del prej ihramit, pret deri në ditën e shtatë të Dhul-hixhhes. Pas mesditës, imami në Qabe mbanë një hudbe dhe urdhëron që ditën e tervijes të përgatiten e të shkojnë në Mina, dhe të nesërmen në Arafat, sepse qëndrimi edhe një kohë të shkurtë në Arafat është farz prej ditës së nëntë (të muajit Dhul-hixhhe) deri në agimin e ditës së parë të Bajramit (ditës së dhjetë të muajit Dhul-hixhhe).

Është mirë që ditën e tetë, duke thënë telbijen të niset për në Mine. Për atë që ka fuqi, është mustehab të ecë tërë këtë rrugë. Kur arrin në Mine, bën dua:

***“Allahume hazihi Mina fem-nun’alejje bi ma menente bihi ‘ala evlija’ike ve ehli ta’atike.”*** (Allahu im! Kjo është Mina, prandaj më dhuro atë që ia ke dhuruar robëve të Tu të sinqertë (evliave) dhe atyre që Ty të nënshtrohen.)

Atë natë le të qëndrojë në Mine, e ky është qëndrim për pushim, që nuk ndërlidhet me ndonjë veprim të haxhit. Të nesërmen në mëngjes e falë namazin e sabahut, e pasi që Dielli të lajmërohet pas vargmaleve Sebir, niset drejt Arafatit, duke lexuar këtë dua:

***“Allahummexh-’alha hajre gadvetin gadvetuha kattu ve akrebihamin ridvanike ve eb’adiha min sehatike Allahumme ilejke gadgetvu ve ijake rexhevtu ve ‘alejke i’temedtu ve vexhheke eredtu fexh’alni mimmen tebaha bihil-jevme men huve hajrun minni ve efdal.”*** (Allahu im! Le të më jetë kjo ecja më e mirë e mëngjesit që unë e kam pasë ndonjëherë, dhe le të jetë më së afërti kënaqësisë Tënde dhe më së largu prej zemërimit Tënd. Allahu im! Drejt Teje po eci në këtë mëngjes dhe tek Ti i kam shpresat, tek Ti mbështetem dhe vetëm Ty të dua, më bëj edhe mua prej atyre me të cilët krenohesh para melaikeve.)

Kur arrin në Arafat, tendën le ta vendos në pjesën e Arafatit që quhet Nemire, afër Xhamisë, sepse Resulallahu,



s.a.v.s., e vendoste tendën aty.<sup>50</sup> *Nemire* është luginë e Arines, e ai nuk është vendqëndrim, as Arafat. Aty lahet. Kur Dielli të largohet nga gjysma e qiellit, imami mbanë një hudbe të shkurtë dhe ulet, e kur imami është në hudben e dytë, myezini thërret ezanin dhe menjëherë më pas bën ikamet. Pastaj, të bashkuara e të shkurtuara do të falen namazet e drekës dhe të ikindisë, me një ezan e dy ikamete. Pas kësaj shkohet në Arafat, sepse në Arafat është vendqëndrimi, e jo në luginën Arine. Mesxhidi-Ibrahim, a.s., me pjesën e përparme ndodhet në këtë luginë, e pjesa tjetër e kësaj xhamie gjendet në kufijtë e Arafatit. Prandaj, atij që është në pjesën e përparme të kësaj xhamie nuk i llogaritet se e ka kryer qëndrimin në Arafat. Pjesa e xhamisë që gjendet brenda kufijve të Arafatit është e shënuar me gurë të mëdhenj me të cilët është e shtruar dyshemeja aty. Më e mira është të qëndrojnë afër atyre gurëve, pranë imamit e i kthyer kah kibla. Atëherë le të lexojë gjithçka që di prej tahmidit, tesbihut, tehlilit, salavateve, dua dhe istigfar. Atë ditë të mos agjërojë, e krejt me qëllim që më lehtë ta përballojë atë ditë dhe ta zbatojë detyrën e vet më mirë. Gjatë qëndrimit në Arafat, më e mira është të bëjë dua dhe istigfar.

Jashtë kufijve të Arafatit nuk bën të dalë para se Dielli të perëndojë, pra kur të perëndojë Dielli, niset në Muzdelife. Do të ishte mirë që, nëse mundet, në ditën e

---

<sup>50</sup> Muslimi, nga Xhabiri.

tetë të muajit Dhul-hixhxe të qëndrojë në Arafat, për shkak të gabimit të mundshëm në vërejtjen e Hënës së re. Një veprim i tillë nënkupton vendosmëri dhe sigurim që të mos gabohet dita e Arafatit.

Atij që nuk del nga Arafati para sabahut të ditës së parë të Bajramit, nuk i llogaritet se e ka kryer haxhin. Ai lirohet nga ihrami dhe kryen umre, e më pas prenë kurban për shkak se e ka humbë haxhin, e vitin tjetër e përsëritë haxhin.

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., në Arafat e ka lexuar këtë dua:

***“La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu juhji ve jumitu ve huve hajjun la jemutu bijedihil-hajru ve huve ‘ala kuli shej-in kadir. Allahumme-xh’al fi kalbi nuren ve fi sem’i nuren ve fi besari nuren fi lisani nuren. Allahummesh-rah li sadri ve jessir li emri.”***  
(Nuk ka zot pos Allahut, Një e të Vetmit. Ai nuk ka ortak. Atij i takon pushteti dhe falënderimi. Ai dhuron ngjalljen dhe vdekjen, e Ai është përherë i Gjalli, që nuk vdes. Tek Ai është çdo e mirë. Ai mundet gjithçka. Allahu im, zemra ime le të ndriçohet me nur; dëgjimi im dhe shikimi im le të ndriçohen me nur; gjuha ime le të ndriçohet me nur. Allahu im, ma zgjero gjoksin dhe ma lehtëso detyrën.)<sup>51</sup>

---

<sup>51</sup> Tirmidhi, nga Amr ibn Shu’ajb dhe nga Alia, r.a., Mustagfiri nga Alia, ra., në *ed-Da’vat*, Taberani në *el-Muxhem es-Sagir*.

*“Allahumme rabbi lekel-hamdu kema nekulu ve hajren mimma nekulu leke salati ve nusuki ve mahjaje ve memati ve ilejke me’abi ve ilejke sevabi. Allahumme inni e’uzu bike min vesvasis-sadri ve shetatil-emri ve ‘azabil-kabri. Allahumme inni e’uzu bike min sherri ma jelixhu fil-lejli ve min sherri ma jelixhu fil-nehari ve min sherri ma tehubbu bihir-rijahu ve min sherri beva’ikid-dehri. Allahumme inni e’uzu bike min tehavvuli ‘afijetike ve fexh’eten nikmetuke ve xhem’i sehatike. Allahummehdini bil-huda vag-fir li fil-ahireti vel-ula ja hajre maksudin ve esna menzulin bihi ve ekreme mes’ulin ma ledejhi, ‘atinil-‘ashijjete efdale ma ‘atajete ehaden min hal-kike ve huxhxhaxhi bejtike ja erhamer-rahimin. Allahumme ja refi’ad-derehhati ve munzilel-berekati ve ja fatirel-erdine ves-semavati daxhxhet ilejkel-asvatu bisunufil-lugati jes’elunekel-hadzhati ve haxheti ilejke ela tensani fi daril-bela’i idha nesijeni ehlud-dunya. Allahumme inneke tesme’u kelami ve tera mekani ve ta’lemu sirri ve’alanijeti ve la jahfa’ alejke shej’un min emrienelba’isul-fekirul-mustegisul-mustexhirul-vexhilul-musheffekul-mu’terifu bi zenbihi es’elukel-mes’eletel-miskini ve ebtehilu ilejke ibtihalel-muznibiz-zelili ve ed’uke du’a’el-ha’ifid-dariridua’e men hada’at leke rekabetuhu ve fadat leke abretuhu ve dhele leke xheseduhu ve regame leke enfuhu. Allahumme la texh’alni bidu’a’ike rabbi shekijjen ve kun bi re’ufen rahimen ja hajrel-mes’uline ve ekremel-mu’tine. Ilahimen medeha leke nefsehu fe innila’imun nefsi. Ilahi*

*men medeha leke nefsehu fe inni la'imun nefsi. Ilahi inni'a'lemu enne zunubi lem tubki li'indeke xhahen ve la lil-i'tizari vexhhen ve lakinneke ekremul-ekremin. Ilahi in lem ekun ehlen en ebluga rahmeteke fe inne rahmeteke ehlun en teblugani ve rahmetuke fe inne rahmeteke ehlun en teblugani ve rahmetuke vesi'at kule shej'in ve ene shej'un. Ilahi inne zunubi ve in kanet izamen ye lakinneha sigarun fi xhenbi 'afvike fagfirha li ja kermin. Ilahi ente ente ve ene ene enel-avvadu ilez-zunubi ve entel'avvadu ilel-magfireti. Ilahi in kunte la terhamu ila ehle ta'atike fe ila men jefze'ul-muznibune. Ilahi texhennebtu 'an ta'atike fe ila 'amden ve tevexhxhehtu ila ma'sijetike kasden fe subhaneke ma'a'zame huxhxheteke 'alejje ve ekreme 'afveke 'anni fe bi vuxhubi huxhxhetike 'alejje ven-kita'i huxhxheti'anke ve fakri ilejke ve ginake 'anni ila gaferte li ja hajre men de'ahu da'in ve efdale men reXHahu raxhin bi hurmetil-islami ve bi zimmeti Muhammedin 'alejhis-selamu etevesselu ilejke fag-fir li xhemi'a zunubi vasrifni min mevkifi haza makdijjel-hava'ixhi ve heb li ma se'eltu ve hakkik rexha'i fima temennejtu. Ilahi de'avtuke bidu'a'ilezi 'alemtenihi fe la tahrirnir-rexha'el-lezi'arreftheni. Ilahi ma ente sani'ul-'ashijjete bi 'abdin mukirrin leke bi zenbihi hashi'in leke bi ziletih mustekinin bi xhurmihi mutedarri'in ilejke min 'amelihi ta'ibin ilejke minik-tirafihi mustagfirin leke min zulmihi mubtehlin ilejke fil-'afvi 'anhu talibin ilejke nexhaha hava'ixhihi raxhin ilejke fi mevkifihi me'a kesreti zunubihi fe ja*

*melxhe'e kuli hajjin ve velijje kuli mu'minin men ahsene fe bi rahmetike jefuzu ve men ahta'e fe bi hati'etih juhleku. Allahumme ilejke harexhna bi fena'ike enahna ve ijake emelna ve ma 'indeke talebna ve li ihsanike te'arradna ve rahmeteke rexhevna ve min 'azabike eshfakna ve ilejke bi eskaliz-zunubi herebna ve libejtikel-harami haxhexhna ja men jemliku hava'ixhes-sa'iline ve la'lemu dama'ires-samitine ja men lejse me'ahu rabbun jud'a ve ja men lejse fevkahu halikn juhsha ve ja men lejse me'ahnu rabbun jud'a ve ja men lejse fevkahu halikun juhsha ve ja men lejse lehu vezirun ju'ta ve la haxhibun jursha ja men la jezdadu 'ala kesretis-su'ali ila xhuden ve keremen ve 'ala kesretil-hava'ixhi illa tefeddulen ve ihsanen. Allahumme inneke xhe'alte li kuli dajfin kuren ve nahnu adjafuke fexh-'al kurana minkel-xhennete. Allahumme inne li kuli vefdin xha'izeten ve li kuli za'irin kerameten ve li kuli sa'ilin 'atijjeten ve li kuli raxhin sevaben ve li kuli multemisin lima 'indeke xheza'en ve li kuli musterhimin 'indeke rahmeten ve li kuli ragibin ilejke zulfa ve li kuli mutevessilin ilejke 'afven ve kad vefedna ila bejtikel-harami ve vekafna bi hazihil-mesha'iril'izam ve shehidna hazihil-meshahidel-kirame rexha'enlima 'indeke fe la tuhajjib rexha'ena. Ilahena taba'ten-ni'ame hatta-tme'ennetil-enfusu bi tetabu'i ni'amike ve azhertel-'ibere hatta netakatis-savamitu bi huxhxhetike ve zahertel-minene hatta'terefe evlija'uke bittaksiri'an hakkike ve azhertel-ajati hatta efsahatis-semavatu vel-erdune bi*

edilletike ve kaherte bi kudretike hatta hada'a kulu shej'in li 'izzetike ve 'anetil-vuxhuhu li 'azametike iza esa'et 'ibaduke halimte ve emhelte ve in ahsenu tefeddalte ve kabilte ve in 'asav seterte ve in eznebu 'afevte ve gaferte ve iza de'avna exhebte ve iza nadejna semi'te ve iza akbelna ilejke karubte ve iza velejna'anke de'avte. Ilahena inneke kulte fi kitabikel-mubbini li Muhammedin hatemin-nebijjine: Kul liledhine keferu in jentehu jugfer lehum ma kad selefe, fe erdake 'anhumul-ikraru bi kelimetit-tevhidi ba'del-xhuhudi ve inna neshhedu leke bittevhidi muhbitine ve li Muhammedin birrisaleti muhlisine fagfir lena bihazihish-shehadeti sevalifel-ixhrami ve la texh'al hazzana fihi enkasa min hazzimen dehale fil-islami. Ilahena inneke ahbebtet-tekarrube ilejke bi'itki ma meleket ejmanuna ve nahnu 'abiduke ve ente evla bittefedduli fe 'a'tikna ve inneke emertena en netesaddeka 'ala fukara'ina ve nahnu fukara'uke ve ente ehakku bit-tetavuli fe tesaddak 'alejna ve vessajtena bil-'afvi 'ammen zalemna ve kad zalemna enfusena ve ente ehakku bil-keremi fa'fu 'anna rabbenagfir lena verhamna ente mevlana rabbena atina fid-dunya haseneten ve fil-ahireti haseneten ve kina bi rahmetike 'azaben-nar." (Allahu im, Ty të shprehi falënderimin me këto fjalë e me fjalë më të mira se këto! Allahu im, Ty të takon namazi im, ritet e mia, jeta ime dhe vdekja ime. Tek Ti është kthimi im dhe vetëm Ti shpërblen. Allahu im, tek Ti mbrojtje kërkoh nga mashtrimet e

shejtanit, hutia dhe tmerri i varrit. Allahu im, në Ty mbrojtje  
kërkoj nga e keqja e asaj që vjen natën dhe nga e keqja e  
asaj që vjen ditën, dhe nga e keqja e asaj që vjen me erën,  
dhe nga vështirësitë që i bjen koha. Allahu im, në Ty  
mbrojtje kërkoj që rahmeti Yt të mos bëhet papritmas  
zemërimi Yt dhe nga zemërimi Yt në përgjithësi. Allahu im!  
Më udhëzo në rrugë të drejtë dhe më fal në këtë botë e në  
botën tjetër, o Më i miri për t'ju drejtuar, dhe më i  
Lartësuari tek i Cili mund të gjendet strehim, dhe më Fisniku  
me atë që e posedon, më dhuro, në këtë pasditë, atë më të  
mirën që ia ke dhuruar krijesave Tua dhe vizitorëve të  
shtëpisë tënde, o Rahman, o Rahim! O Ti që i ngritë gradat,  
që dhuron bereqete, Krijues i botëve dhe qiejve! Zërat u  
dëgjuan në gjuhë të ndryshme duke t'i shprehur nevojat Ty,  
e ajo që unë kërkoj prej Teje është të mos më harrosh në  
botën e sprovave, atëherë kur të gjithë të tjerët të më kenë  
harruar! Allahu im! Ti, vërtetë, e sheh pozitën time, e  
dëgjon të folmen time, e di atë që unë e fshehu dhe atë që  
e shprehi haptazi; Ty asgjë nuk mund të fshehet! Unë jam  
robi Yt i përulur e fukara i cili kërkon ndihmën dhe  
mbrojtjen Tënde, jam i frikësuar e i pavlerë, i pranoj  
gjynahet e mia, të lutem Ty ashtu siç lutet miskini, dhe me  
pendim të drejtohem Ty ashtu siç kërkon me pendim  
gjynahqari i përulur, të bëj dua Ty ashtu siç bëjnë dua të  
frikësuarit, të pafuqishmit, ata që Ty të janë nënshtruar, të  
dëshpëruarit, që me trupat e tyre të nënshtrohen Ty dhe  
para Teje përulen. Allahu im, mos lejo që në duanë time për

*Ty të mbetem i palumtur dhe të kesh butësi e rahmet ndaj meje, o Ti që je më i Miri që i kërkohet dhe më i Miri që dhuron. Allahu im. Ka të atillë që para Teje lavdërohen, e unë para Teje e qortoj veten. Allahu im! Unë vërtetë e di që gjynahet e mia e kanë shkatërruar reputacionin tim tek Ti dhe nuk kanë lënë hapësirë për kërkimfalje, por Ti je më fisniku mes fisnikëve! Allahu im! Unë nuk jam në gjendje të arrij rahmetin Tënd, por rahmeti Yt është në gjendje të më arrijë mua, sepse rahmeti Yt përfshinë gjithçka, e unë jam njëri në atë gjithçka. Allahu im, edhe pse gjynahet e mia janë të mëdha, në krahasim me rahmetin Tënd ato janë të parëndësishme, prandaj falmi gjynahet, o Fisnik! Allahu im! Ti je Ti, e unë jam unë; unë përsëri i kthehem gjynahut, e Ti përsëri më falë. Allahu im! Nëse rahmetin Tënd ia dhuron vetëm atyre që janë të përkushtuar pas Teje, ku të kërkojnë atëherë gjynahqarët strehim?! Allahu im! Unë me vetëdije jam larguar nga rruga e nënshtrimit Ty dhe me dije kam hyrë në rrugën e gjynahut, prandaj i lartësuar qofsh Ti, sa i qartë është argumenti Yt kundër meje, dhe sa e madhe falja Jote për mua; dhe ani pse dëshmia Jote kundër meje është aq e qartë, e unë nuk kam kurrfarë arsytimi, unë aq shumë kam nevojë për Ty, e njëkohësisht, Ti je i pavarur prej meje. Edhe pse krejt kështu është, Ti megjithatë më falë, o më i Miri të Cilit ndonjëherë ndokush i ka drejtuar dua, tek i Cili ndonjëherë ndokush ka shpresuar, të lutem Ty, me shenjtërinë e islamit dhe me nderin e Muhammedit, s.a.v.s., të mi falësh të gjitha gjynahet, të më largosh nga*



ky vend me nevoja të plotësuara, dhe më dhuro atë që e kam kërkuar, dhe plotësoi shpresat e dëshirat e mia! Allahu im! Duanë ta bëra ashtu siç më mësove Ti, prandaj mos ma këput shpresën me të cilën Ti më ke mësuar! Allahu im! Çfarë do të bësh, këtë pasditë, me robin i cili T'i pranon gjynahet, që është i përulur para Teje, i cili të është nënshtruar Ty me gjynahun e vet, i cili nga vepra e vet iku tek Ti, i cili u pendua para Teje për gjynahet e bëra, i cili kërkon faljen Tënde për padrejtësinë e vet, i cili tek Ti iku për falje, i cili kërkon përmbushjen e nevojave, i cili tek Ti ka shpresë në këtë vend, ani pse ai ka shumë gjynahe – o Ti që je strehim për gjithçka të gjallë, që je Mbrojtës për secilin besimtar – ai që ka bërë mirë do ta arrijë rahmetin Tënd, e kush ka bërë gjynah me atë gjynah do të shkatërrohet! Allahu im! Para Teje dolëm, në vendin Tënd po qëndrojmë, vetëm tek Ti i mbajmë shpresat, kërkojmë nga ajo që është me Ty, qëndrojmë para mirëbërjes tënde, shpresojmë për rahmetin Tënd, i frikësohemi dënimit Tënd, me të gjitha gjynahet tona ikim tek Ti, haxh bëjmë në shtëpinë Tënde, o Ti që posedon nevojat e nevojlisë, që e njeh të brendshmen e të heshturit, o Ti që nuk ke ortak të cilit mund t'i bëhet dua, o Ti përtej të Cilit nuk ka krijues tjetër për t'ju frikësuar, o Ti që nuk ke ndihmës tek i cili mund të shkohet, o Ti që nuk ke roje që të mashtrohen, o Ti të Cilit duatë e shumta vetëm ia shtojnë fisnikërinë e mirësinë e Tij, e nevojat e shumta vetëm ia shtojnë dhurimin dhe mirëbërjen e Tij! Allahu im! Secilit mysafir i ofrove

*mikpritje, e ne jemi mysafirët e Tu, prandaj na mirëprit me xhennet! Allahu im! Secili grupim do ta ketë shpërblimin e secili mysafir do ta ketë dhuratën, secili që bën dua do të ketë shpërblim, secili që shpreson do të ketë shpërblim, secili që ka pritje prej Teje do ta marrë atë që e pret, secili që prej Teje kërkon mëshirën Tënde do ta ketë, secili që të dëshiron Ty do ta ketë afërsinë Tënde, secili që të lutet me ngulm do ta marrë faljen! Ne e vizituam shtëpinë Tënde të shenjtë, dhe qëndruam në këto vende të shenjta, dhe ishim dëshmitarë të këtyre pamjeve të jashtëzakonshme, duke shpresuar për atë që është me Ty, prandaj mos i dëshpëro shpresat tona. Allahu jonë! Ti vazhdimisht na dhuron mirësitë e tua, sa që jemi bërë plotësisht të sigurtë në to, i bërë të dukshme porositë e Tua, sa që për dëshmitë e Tua flet edhe natyra e vdekur, i tregove edhe dhuratat Tua, sa që robët e Tu të sinqertë e pranuan pafuqinë për të ta kthyer dhuratën, i bërë të dukshme shenjat Tua, me fuqinë Tënde i ke nënshtruar të gjithë ashtu që gjithçka iu nënshtrua fuqisë Tënde dhe lartësisë Tënde. Kur robët e Tu veprojnë keq, Ti je i butë dhe ju jep hapësirën për pendim, e nëse veprojnë mirë, Ti e pranon këtë dhe i shpërblen, e gjynahet e tyre i fshehë nga sytë dhe ua falë ato. Nëse të bëjmë dua, Ti e pranon duanë, kur të thërrasim Ty, Ti na dëgjon, kur tek Ti drejtohem, Ti na afroresh, nëse prej Teje largohemi, Ti na thërret! Allahu jonë! Ti i the Resulallahut, s.a.v.s., në Librin e qartë: **“Thuaju mohuesve: nëse largohen (nga mohimi), do t’ju falet e kaluara”** [8-Enfal:*

38], e Ty të kënaqë pranimi prej tyre se vetëm Ti je Zot, pasi që ata ishin jobesimtarë. Ne të nënshtruar dëshmojmë se vetëm Ti je Allahu, dhe sinqerisht pohojmë se Muhammedi është i dërguari Yt, dhe na fal gjynahet e mëhershme për këtë dëshmi dhe mos bëj hisen tonë këtu më të vogël se hisen e atyre që dikur ishin mohues. Allahu jonë! Ti vërtet dëshiron që ibadeti të të bëhet me çlirim nga ajo që është në pronësinë tonë, e ne jemi në pronësinë Tënde, dhe më e rëndësishme është që Ti të dhurosh lirinë, prandaj na liro nga zjarri i xhehenemit! Ti vërtetë na ke urdhëruar që sadakanë t'ju ndajmë të varfërve mes nesh, e ne jemi të varur prej Teje, e më e rëndësishme është që Ti të dhurosh, prandaj na dhuro! Na ke udhëzuar t'i falim ata që na bëjnë padrejtësi, e Ti je më fisniku, prandaj na fal. Rabbi jonë, na fal dhe ke mëshirë ndaj nesh, sepse Ti je Rabbi jonë! Rabbi jonë, na dhuro të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe, me rahmetin Tënd, na mbroj nga zjarri i xhehenemit!)

Në Arafat, haxhia le ta lexojë edhe më shumë duanë e Hizrit, a.s.:

***“Ja men la jeshgaluhu she’nun ‘an she’nin ve la sem’un ‘an sem’in ve la teshtebihu ‘alejhil-asvatu ja men la taglituhul-mesa’ilu ve la tahtelifu ‘alejhil-lugatu ja men la lebremuhu ilhahul-mulihhine ve la taxhheruhu mes’eletus-sa’iline ezikna berde ‘afvike ve halavete munaxhatike.”*** (O Ti, të Cilin asnjë angazhim nuk e largon nga angazhimi tjetër, asnjë dëgjim nga dëgjimi tjetër, e as

*zërat nuk i përzihen. O Ti, të Cilin nuk e lodhin shumësia e duave që i drejtohen, për të Cilin të gjitha gjuhët janë njëjtë të kuptueshme! O Ti të Cilit nuk i pengon këmbëngulja e atyre që këmbëngulin në dua, e as nuk e zemërojnë kërkesat e atyre që kërkojnë, bëj që ta shijojmë ëmbëlsinë e mëshirës Tënde e të ndjejmë kënaqësi kur të drejtohemi Ty!)*

Allahut Teala le t'i bëjë dua ashtu siç i vjen në mendje. Le të kërkojë falje për vete, për prindërit e vet dhe për të gjithë besimtarët e besimtaret, dhe le të jetë i vendosur në dua dhe le t'i qaset me seriozitetin më të madh, sepse Allahu Teala është i Gjithëmëshirëshmi dhe Mëshirëploti. Muttarif ibn Abdullah, kur ishte në Arafat, u lut: *"Allahu im! Mos ua refuzo të tjerëve duanë për shkak timin!"*

Bekr el-Muzeni tregon se një njeri ka thënë: *"Kur i shikoja ata që ishin në Arafat, mendoja se, po të mos isha unë në mesin e tyre, ata do t'i kishte falë Allahu Teala."*

## DETYRA E SHTATË

*Veprimet tjera gjatë haxhit, pas qëndrimit në Arafat*

Kur pas akshamit nga Arafati niset për Muzdelife, le ta bëjë këtë i qetë e me dinjitet. Nuk duhet të ngutet, që disa e bëjnë, sepse Resulallahu, s.a.v.s., e ka ndaluar ngutjen duke thënë:

**“Frikësojuni Allahut dhe ecni me ecje të bukur! Mos e shkëlqeni të dobëtin e mos e shqetësoni myslimanin!”<sup>52</sup>**

Kur haxhia mbërrin në Muzdelife, duhet të lahet, sepse Muzdelifa ndodhet brenda kufijve të Haremit. Bile, nëse mund të shkojë atje në këmbë, është më e mirë dhe më shumë i ka hije Haremit, dhe rrugën e vaxhdon duke thënë telbijen me zë, e kur të arrijë në Muzdelife, le ta lexojë këtë dua:

***“Allahumme inne hazihî Muzdelife xhema’te fiha el-sineten muhtelifeten tes’eluke hava’ixhe mu’tenifeten faxh-’alni mimmen de’ake festexhebte lehu ve tevekkele ‘alejke fe kefejtehu.”*** (Allahu im! Kjo është Muzdelife. Në të i ke mbledhur njerëzit që flasin gjuhë të ndryshme që Ty vazhdimisht t’i shprehin nevojat e veta, prandaj bëj që unë të jem prej atyre që të lutem Ty, e Ti ua pranon lutjet; nga ata që në Ty mbështeten, e të cilëve Ti ju mjafton!)

---

<sup>52</sup> Nesai dhe Hakimi nga Usame ibn Zejd.

Pastaj falë namazin e akshamit dhe jacisë të bashkuar dhe shkurtuar, në kohën e jacisë, me një ezan e dy ikamete, e mes tyre nuk falë namaz nafile. Pasi t'i kryen namazet farz, një herë e falë sunnetin e akshamit, e më pas sunnetin e fundit të jacisë dhe pastaj namazin vitri.<sup>53</sup> Nëse nuk i falë sunnetet për shkak se është udhëtar, ashiqare që është humbës dhe braktisja e sunnetit në kohën e tyre paraqet ndërprerje me farzet.<sup>54</sup> Pasi që është e lejuar që sunnetet të falen bashkë me farzin me një tejemum, e me qëllim që ato të mos ndahen, me princip të njëjtë edhe këtu lejohet të bashkohen dhe të falen me radhë, që të mos ndahen. Natyrisht, kjo nuk e ndalon faljen e sunnetit në mjet të udhëtimit sipas nevojës, sepse ndërrimi i mënyrës së faljes nuk është ndarje mes sunnetit e farzit.

Atë natë haxhia e kalon në Muzdelefe, deri në mëngjes. Ai që e lëshon Muzdelifen para mesnatës, obligohet me therrje të kurbanit. Këtë natë të bekuar është mirë ta kalojë në ibadet secili që mundet. Në mesnatë, haxhia fillon përgaditjet për largim. Së pari do të mbledhë guralecët, sepse në Muzdelife ka më shumë gurë. Këtu i mbledhë shtatëdhjetë guralecë, sepse aq i duhen, e mund të marrë edhe më shumë, që të ketë rezervë, nëse i humbet ndonjë.

---

<sup>53</sup> Sipas medh'hebit Shafi, vitri është sunnet.

<sup>54</sup> Sipas medh'hebit Hanefi, udhëtari gjatë udhëtimit nuk i falë sunnetet, por mund t'i falë në atë vend ku pushon.

Duhet të zgjedhë gurë më të vegjël, sa kokrra e bizeles. Kur të agojë, e falë namazin e sabahut, pastaj shkon në *Mesh'ari-Haram*, që gjendet në fund të Muzdelifes dhe aty bën këtë dua, deri sa të zdritet:

***“Allahumme bi hakki mesh’aril-harami vel-bejtiharami vesh-shehril-harami ver-rukni vel-mekami eblig ruha Muhammedin minnet-tehijjete ves-selame ve edhilna dares-selami ja zel-xhelali vel-ikrami.”*** (Allahu im! Pashë Mesh’ari-haram, dhe shtëpinë e Ndershme, dhe muajit të shejtë, dhe Ruknes, dhe Mekamit, përcjelli prej nesh shpirtit të Muhammedit, s.a.v.s., salat e selam, dhe na dërgo në Shtëpinë e paqes, o i Lartësuar e Fisnik!)

Para lindjes së Diellit niset drejt vendit që quhet ‘*Vadi Mahser.*’ Është mirë që ta kalojë luginën në deve, e nëse është këmbësor, të ngutet në ecje. Pas sabahut, bashkë me telbije lexon edhe tekbiere dhe në këtë mënyrë arrin në Mina.

Në Mina gjenden tri vendet ku gjuhen guralecët. Ditën e parë kalon përskaaj vendit të parë e të dytë, sepse në to nuk ka obligime në ditën e parë të Bajramit, dhe shkon te vendi i tretë - *Xhemretul-akabe*, që gjendet në anën e djathtë të rrugës drejt kiblës dhe është pak i ngritur. Pasi që Dielli të kalojë një shigjetë, i gjuan guralecët në *xhemretul-akabe*.

Këtë do ta bëjë ashtu që do të kthehet kah kibla, e nuk pengon edhe nëse kthehet kah xhemreti, e më pas me dorë të ngritur gjuan shtatë gurë, ndërpret telbijen dhe sa herë që gjuan një gur, bën tekbir:

***“Allahu ekber! ‘Ala ta’atir-rahmani ve ragmish-shejtani. Allahumme tasdikan bi kitabike vet-tiba’an li sunneti nebijjike.”*** (Allahu është më i madhi! Me nënshtrim Rahmanit e me kundërshtim shejtanit! Allahu im, me besim në librën Tënde e me pasim sunnetin e Resulallahut, s.a.v.s.)

Pasi i gjuan guralecët i ndërpret telbijen dhe tekbin, përpos *tekbiri-teshrik*, tekbir që lexohet pas namazit farz, nga farzi i drekës së parë të Bajramit e deri te namazi i sabahut të fundit të Bajramit. Në këtë ditë haxhia nuk ka ndonjë detyrim, prandaj mund të bëjë dua sa të dëshirojë. Tekbiri lexohet kështu:

***“Allahu ekber! Allahu ekber! Allahu ekberu kebira vel-hamdu lilahi kesira ve subhanel-lahi bukreten-ve esila. La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh muhlisine lehud-dine ve lev kerihel-kafirun, la ilahe ilallahu vahdeh, sadeka va’deh, ve nesare ‘abdeh, ve hezemel-ahzabe vahded, la ilahe ilallahu vallahu ekber!”*** (Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi! Allahu është, vërtetë, më i madhi! Shumë falënderim Allahut. I lavdëruar qoftë Ai në mëngjes e mbrëmje. Nuk ka zot pos Allahut, i Cili nuk ka ortak. Atij sinqerisht ia shprehim fenë, edhe nëse kjo nuk ju pëlqen



*jobesimtarëve. Nuk ka zot pos Allahut. Ai e mbajti premtimin, e ndihmoi robin e Vet dhe Ai Vet i mposhti të gjithë kundërshtarët. Nuk ka zot pos Allahut, Ai është më i madhi!)*

Pas gjuajtjes së gurëve në *Xhemretul-akabe*, therrë kurban, nëse mundet më e mira është që vet ta therrë. Kur therrë kurban, lexon:

***“Bismilahi vallahu ekber! Allahumme minke ve bike ve ilejke. Tekabbel minni kema tekabbelte min halilike Ibrahimë.”*** (Me emrin e Allahut, e Allahu është më i madhi! Allahu im, ky kurban është dhënë prej Teje, është në emrin Tënd dhe vetëm Ty të dorëzohet! Prandaj, pranoje kurbanin nga unë, siç e ke pranuar nga shoku Yt, Ibrahim, a.s.)

Më e mira do të ishte që për kurban të therrë deve, pastaj lopë, e pastaj dele, por të therrë ai vet një dele është më mirë se sa shtatë persona bashkë ta therrin një deve ose një lopë, e delja është më e mirë se dhia. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

***“Kurbani më i mirë është dashi me brirë.”***<sup>55</sup>

Kurbani i bardhë është më i mirë. Ebu Hurejre ka thënë:  
*“Ngjyra e bardhë e kurbanit është më e mira.”*

---

<sup>55</sup> Ebu Davud nga Ubade ibn Samit.

Haxhia mund të hajë mish të kurbanit nëse nuk është kurban *nezir*. Për kurban nuk therrë kafshë të çalë (*arxha*), as të gjymtuar – me vesh a hundë të prerë (*xhed'a*), as me bri të thyer a me këmbët e para të shkurta (*adba*), as me zgjebe (*xherba*), as me vesh të shpuar në pjesën e poshtme (*harka*), as kafshën që nga para ose mbrapa i rri vjerrë një copë e veshit të prerë (*mukabele, mudabere*), as kafshë të dobët a të pazhvilluar (*axhfa*).

Pas therrjes së kurbanit, e rruan kokën ose i shkurton flokët. Është sunnet të kthehet kah kibla dhe të fillojë rruajtjen nga pjesa e përparme e kokës, ashtu që së pari e rruan gjysmën e saj të djathtë, e më pas të majtën. Gjatë rruajtjes bën dua:

***“Allahumme esbit li bi kuli sha’retin haseneten vemhu ‘anni biha sejj’eten ver-fa’ li biha ‘indeke derexheten.”***  
(Allahu im! Për secilën fije floku më shkruaj një vepër të mirë dhe me secilën fije floku më ngrit një gradë më afër Teje!)

Femra vetëm i shkurton flokët, e tullaci është mirë të kalojë me briskun e rojës nëpër kokë. Pasi të përfundojë me këto veprime, haxhia konsiderohet pjesërisht i liruar nga ihrami (*et-tehallul el-evvel*), me çka i bëhet e lejuar gjithçka që e kishte të ndaluar me ihram, përpos marrëdhënies intime dhe gjahut.

Më pas haxhia niset drejt Mekes, ku do ta bëjë tavafin ashtu siç e shpjeguam. Ky tavaf është farz (dhe shtyllë prej shtyllave të haxhit) dhe quhet *tavafi-zijare*. Koha më e mrë për kryerjen e tij është dita e parë e Bajramit, por kjo kohë nuk kryhet, e haxhia mund ta shtyejë në cilën do kohë, por në atë rast edhe më tutje mbetet nën obligimet e ihramit, kështu që nuk mund të ketë marrëdhënie me gruan deri sa ta kryejë këtë tavaf. Pasi ta kryejë këtë tavaf, lirohet plotësisht nga ihrami dhe i lejohet marrëdhënia intime. Ajo që ende i mbetet është hudhja e gurëve në tri ditët e ardhshme (*ejjam et-teshrik*) dhe qëndrimi në Mine. Qëndrimi në Mine është vaxhib i haxhit pas heqjes së ihramit. Mënyra e kryerjes së këtij tavafi dhe dy reqateve namaz pas tij është e njëjtë sikur ai që e shpjeguam kur folëm për tavafin-kudum. Pasi që t'i kryejë dy reqate namaz, le ta kryejë sa'jin, ashtu siç e treguam, nëse nuk e ka bërë pas tavafit-kudum. Nëse e ka kryer pas tavafit-kudum, me kryerjen e këtij tavafi e ka kryer ruknen dhe nuk i duhet që përsëri ta bëjë sa'jin.

Lirimi nga ihrami ka tri kushte: gjuajtja e gurëve, rruajtja e kokës dhe tavafi *zijaret*. Kur haxhia t'i kryejë dy prej këtyre tri veprimeve, është liruar nga ihrami (*tehallul evvel*). A është liruar prej ihramit me këto veprime para ose pas therrjes së kurbanit nuk ka rëndësi, por më mirë është që së pari t'i gjuajë guralecët e më pas ta therrë kurbanin, pastaj ta rruajë kokën dhe në fund, të bëjë tavafin zijaret.

Në haxh ka katër hudbe:

1. Ditën e shtatë, Dhul-hixhxe, hudbe e parë në Qabe;
2. Ditën aref, hudbe në Arafat; hudbeja lamtumirëse e

Resulallahut, s.a.v.s.;

3. Ditën e parë të Bajramit; dhe
4. Hudbe në largimin e parë.

Të gjitha hudbet mbahen pas gjysmës së ditës dhe të gjitha janë të ndara, përpos hudbes në ditën e Arafatit e cila përbëhet prej dy hudbeve.

Kur e kryen tavafin zjaret, haxhia kthehet në Mine për të gjuajtur guralecët dhe atë natë e kalon aty. Ajo natë quhet *nata e pushimit dhe qëndrimit (Iejletul-karr)*, sepse të nesërmen njerëzit qëndrojnë në Mine e nuk shpërndahen. Kur të qelë dita e dytë e Bajramit dhe Dielli të kalojë gjysmën e qiellit, haxhia lahet dhe shkon për të gjuajtur gurët. Së pari shkon te xhemra e parë që gjendet në anën e djathtë të rrugës dhe aty gjuan shtatë gurë, e kur e kalon xhemren e parë, largohet pak nga ana e djathtë e rrugës, kthehet kah kibla, dhe duke thënë: *“el-hamdu lilah, la ilahe ilallah, Allahu ekber”* e qetëson zemrën dhe me zemër të qetë bën dua. Pastaj shkon në xhemren e dytë dhe në mënyrën e njëjtëi gjuan shtatë gurë dhe largohet pak në anën e djathtë, kthehet kah kibla dhe bën dua. Më pas shkon në xhemren e tretë dhe i gjuan edhe aty në mënyrën e njetë shtatë gurë.

Atë natë e kalon në Mina, e kësaj nate i thuhet *nata e parë e udhëtimit*. Të nesërmen, pasi që e falë namazin e drekës, i gjuan njëzet e një gurë, siç ka vepruar një ditë më herët.

Pas kësaj vendos vet se a do të qëndrojë në Mine apo do të kthehet në Meke. Nëse vendos të kthehet në Meke, këtë duhet ta bëjë para perëndimit të Diellit, sepse nëse perëndimi i Diellit e zë në Mine, atëherë edhe atë natë duhet të qëndrojë në Mine, deri të nesërmen, kur prapë do t'i gjuajë njëzet e një gurë. Nëse haxhia nuk qëndron në Mine ose nuk gjuan gurë, obligohet të therrë kurban e mishin ta ndajë për sadaka. Gjatë qëndrimit në Mine haxhia mund të shkojë në mbrëmje në Qabe për të bërë tavaf, por me kusht që të kthehet e natën ta kalojë në Mine. Sepse Resulallahu s.a.v.s., ka vepruar kështu.<sup>56</sup> Kurrsesi të mos e braktisë faljen e namazit farz me xhemat në xhaminë el-Hajf, sepse në këtë ka mirësi të madhe.

Kur të niset prej Mines, më së miri është të qëndrojë në vendin *el-Muhasseb*, aty e falë ikindinë, akshamin dhe jacinë dhe pushon pak, sepse kështu vepronte Resulallahu, s.a.v.s.,<sup>57</sup> për çka flasin shumë transmetime të as'habëve, r.a., por nuk ka pengesë nëse haxhia nuk e bën.

---

<sup>56</sup> Ebu Davud në *el-Merasil* nga Tavusi, si edhe nga Ajshe, r.a.nha.

<sup>57</sup> Buhari nga Enesi.

## DETYRA E TETË

### *Mënyra e kryerjes së umres dhe tavafit lamtumirës*

Kush dëshiron ta kryejë umren, qoftë kjo para ose pas haxhit, duhet të lahet, ta veshë ihramin siç ka vepruar për haxh dhe ta bëjë nijet umren nga mikati për umre. Mikati më i mirë për umre është el-Xha'rane, më pas et-Ten'im e pastaj Hudejbije. Në mikat e bën nijetin për umren, lexon telbijen, falë dy reqate namaz në xhaminë e Ajshes, r.a., dhe kërkon atë çka dëshiron prej Allahut Teala. Më pas, duke e lexuar telbijen, shkon në Meke dhe hyn në *Mesxhidul-haram*.

Kur hyn në *Mesxhidul-haram* e ndërpre në telbijen, siç tashmë e shpjeguam, bën tavaf, falë dy reqate namaz, e kryen sa'jin, e pas këtyre i rruan (ose qethë) flokët, dhe me kaq përfundon umren.

Ai që për një kohë të gjatë qëndron në Meke, duhet më shpesh ta bëjë umren dhe tavafin e të kalojë shumë kohë duke shikuar Qaben. Kur të hyjë në harem, është mirë t'i falë dy reqate namaz në mes të dy shtyllave. Në harem hyn i zbathur e me nderim. E pyetën njërin:

- *A hyre sot në Qabe?*, e ai u përgjigj:
- *Pasha Allahun, mendoj se këto dy këmbë nuk meritojnë të shkojnë as rreth e rrotull Qabes, e lere më të shkelin dyshemenë e saj. E di mirë kah kanë shkelur ato!*

Duhet të pi ujë zezemi më shumë se zakonisht dhe atë nga dora e vet, e pasi të pijë, duhet të thotë:

***“Allahummexh-’alhu shifa’en min kuli da’in ve sukmin verzuknil-ihlasa vel-jekine vel-mu’afate fid-dunya vel-ahireti.”*** (Allahu im, bëje këtë ujë ilaç për të gjitha sëmundjet dhe më dhuro sinqeritet, bindje të fortë dhe lumturi, në dynja e në ahiret.)

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Uji i zezemit është ilaç për çfarëdo që bëhet nijet.”<sup>58</sup>**

---

<sup>58</sup> Ibn Maxhe nga Xhabiri.

DETYRA E NËNTË  
*Tavafi lamtumirës (tavaful-veda)*

Sado që haxhia ta ketë në mendje kthimin në shtëpi, le të mos ngutet, e, pasi që t'i kryejë të gjitha obligimet e haxhit dhe umres, fillimisht le t'i kryejë punët e veta dhe le të përgaditet për rrugë, e pas kësaj duhet që ta përshëndesë shtëpinë e Allahut Teala (Qaben) me tavaf. Tavafin lamtumirës do ta bëjë ashtu siç e shpjeguem, me atë që nuk ecë me hapa të shpejtë në tri rrotullimet e para, (*remel*). Kur të përfundojë tavafin, falë dy reqate namaz të tavafit pas Mekami-Ibrahimit dhe pi ujë zemzemi. Më pas, shkon në Multezim - pjesa në mes të gurit të zi dhe derës së Qabes, dhe me përulje t'i drejtojë dua Allahut Teala:

***“Allahumme innel-bejte bejtuke vel-‘abde ‘abduke veb-nu ‘abdike veb-nu emetike hamelteni ‘ala ma seharte li min halkike hatta sejjerteni fi biladike ve belagteni bi ni‘metike hatta e‘anteni‘ala kada‘i menasikike fe in kunte radite ‘anni fezded ‘anni ridan ve ila fe munnel-ane kable teba‘udi‘an bejtike, haza evanun-sirafi in ezinte li gajre mustebdilin bike ve la bi bejtike ve la ragibin ‘anke be la ‘an bejtike. Allahumme as‘hibnil-‘afijete fi bedeni vel-‘ismete fi dini ve ahsin munkalebi verzukni ta‘ateke ebeden ma ebkajteni vexhma‘li hajred-dunya vel-ahireti inneke ‘ala kuli shej’in kadir.Allahumme la texh‘al hadha ahire‘ahdi bi bejtikel-harami ve in xhe‘althehu ahire ‘ahdi fe ‘avvidni‘anhul-xhennete.”***



*(Allahu im! Vërtetë kjo shtëpi është shtëpia Jote, e ky rob është robi Yt, fëmijë i robit Tënd dhe robëreshës Tënde! Ma ke mundësuar t'i vizitohet këto vende, me ke dhuruar mirësinë Tënde dhe më ke ndihmuar t'i kryej obligimet e haxhit, prandaj nëse Ti je i kënaqur me mua, shtoj rizanë (kënaqësinë) Tënde, e nëse jo, atëherë bëhu tash i kënaqur me mua, për hir të Madhësisë Tënde, para se të largohem nga shtëpia Jote. Kjo është koha e largimit tim, nëse Ti më jep leje, por ky nuk është largim prej Teje dhe prej shtëpisë Tënde, zemra im është me Ty dhe me shtëpinë Tënde. Allahu im! Më dhuro shëndet në trup, ruaje fenë time dhe ma bëj kthimin e hairit. Më dhuro nënshtrim ndaj Teje për sa të më lësh në këtë jetë dhe m'i dhuro të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, sepse Ti ke fuqi mbi çdo gjë. Allahu im, kjo le të mos jetë vizita ime e fundit shtëpisë Tënde, e nëse është, në vend të vizitës tjetër ma dhuro xhenetin!)*

Më e mira do të ishte të mos i largojë sytë nga Qabeja deri sa të mos e humb nga shikimi.

DETYRA E DHJETË  
*Edebet e vizitës në Medine*

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Kush më viziton pas vdekjes sime, sikur të më vizitojë gjatë jetës time.”<sup>59</sup>**

**“Kush ka mundësi të më vizitojë, e nuk më viziton, më pikëllon.”<sup>60</sup>**

**“Kush më vjen për vizitë mua, por vetëm për vizitë mua, me lejen e Allahut Teala, e ka fituar shefatin tim. Allahu Teala do të kujdeset që unë t’i jem shefatxhi mbrojtës.”<sup>61</sup>**

Ai që niset për vizitë Resulallahut s.a.v.s., le t’i dërgojë shpesh salavate në rrugë. Kur i sheh muret e Medines dhe pemët e saj, do ta lexojë këtë dua:

***“Allahumme haza haremu resulike fexh-‘alhu li vikajeten minen-nari ve emanen minel-‘azabi ve su’il-hisabi.”*** (Allahu im! Ky është haremi i Resulallahut, s.a.v.s. *Ti më mbron nga zjarri (i xhehenemit) në saje të këtij haremi dhe më shpëton nga llogaria ime e rëndë.”*

---

<sup>59</sup> Taberani dhe Dare Kutni nga Ibn Omer.

<sup>60</sup> Ibn Adijj dhe Dare Kutni.

<sup>61</sup> Taberani nga Ibn Omeri.

Para hyrjes në Medine lahet në burimin *Be'ru'l- Harr*, parfumoset dhe veshë rroba të pastra, e në Medine hyn me modesti e dinjitet, duke lexuar duanë:

***“Bismilahi ve ‘ala mileti resulillahi. Rabbi eddhilni mudhale sidkin ve ahrixhni muhrexhe sidkin vexh-‘al li min ledunke sultanen nesira.”*** (Me emrin e Allahut, e në rrugën e pasuesve të Resulallahut, s.a.v.s.! Rabbi im, bëj që unë të vdes, e Ti të jesh i kënaqur me mua dhe bëj që të ngritem nga të vdekurit, e Ti të jesh i kënaqur me mua, dhe më dhuro prej Teje fuqi që do të më ndihmojë!)

Më pas, le të hyjë në xhami dhe pranë minberit le t'i falë dy reqate namaz. Le të marrë pozitë ashtu që shtylla e minberit t'i jetë pranë krahut të djathtë. Le të kthehet kah shtylla pranë të cilës gjendet sënduku, ashtu që rrethi që gjendet në drejtimin e kiblës të jetë para syve të tij, në atë vend i ka falë namazet Resulallahu, s.a.v.s., para se të zgjerohet xhamia. Gjithsesi le të mundohet të falet në atë pjesë e cila qysh prej fillimit ka qenë pjesë e xhamisë, para se ajo të zgjerohet.

Pas kësaj shkon te varri i Resulallahut, s.a.v.s., dhe qëndron karshi tij, me fytyrë i kthyer kah muri i varrit e me shpinë kah kibla, në largësi prej rreth katër hapa nga shtylla që gjendet në qoshen e varrit, e kandili le t'i jetë mbi kokë.

Muri i varrit nuk duhet të preket apo të puthet, përkundrazi, më mirë e më e dinjitetshme është të largohet pak, e të qëndrojë karshi tij dhe të lexojë:

***“Es-selamu ‘alejke ja resulallah! Es-selamu ‘alejke ja nebijallah! Es-selamu ‘alejke ja eminallah! Es-selamu ‘alejke ja habiballah! Es-selamu ‘alejke ja safvetallah! Es-selamu ‘alejke ja hijeretallah! Es-selamu ‘alejke ja Ahmed! Es-selamu ‘alejke ja Muhammed! Es-selamu ‘alejke ja Ebel-Kasim! Es-selamu ‘alejke ja Mahi! Es-selamu ‘alejke ja ‘akib! Es-selamu ‘alejke ja hashir! Es-selamu ‘alejke ja beshir! Es-selamu ‘alejke ja nezir! Es-selamu ‘alejke ja tuhr! Es-selamu ‘alejke ja tahir! Es-selamu ‘alejke ja ekreme veledi Ademe! Es-selamu ‘alejke ja sejjidel-murseline! Es-selamu ‘alejke jahatemen-nebijjine! Es-selamu ‘alejke ja resule rabbil-‘alemine! Es-selamu ‘alejke ja ka’idel-hajri! Es-selamu ‘alejke ja fatihal-birri! Es-selamu ‘alejke ja nebijjer-rahmeti! Es-selamu ‘alejke ja hadijel-ummeti! Es-selamu ‘alejke ja ka’idel-gurril-muhaxhxhelin! Es’selamu alejke ve ‘ala ehli bejtikel-ledhine ezhebellahu ‘anhumur-rixhse ve tahherehum tathira! Es-selamu alejke ve ‘ala as’habiket-tajjibine ve ‘ala ezvaxhiket-tahirati ummehatil-mu’minine xhezakellahu ‘ana efdale ma xheza nebijjen ‘an kavmihi ve resulen ‘an ummetihi ve sala ‘alejke kulema dhekerekedh-dhakirune ve kulema gafele ‘ankel-gafilune ve sala ‘alejke fil-evveline vel-ahirine efdale ve ekmele ve ‘a’la ve exhelle ve atjebe ve athere ma sala’aëa ehadin*”**

***min halkihi kemestenkazena bike mined-dalaleti ve bessarena bike minel-‘imajeti ve hedana bike minel-xhehaleti, eshhedu enneke’abduhu ve resuluhu ve eminuhu ve safijjuhu ve hijeretuhu min halkihi ve eshhedu enneke kad belagter-risaleti ve eddejtjel-emanete ve nesahtel-ummete ve xhahedte ‘aduvveke ve hedejte ummeteke ve ‘abedte rabbeke hatta etakel-jekinu fe salallahu ‘alejke ve ‘ala ehli bejtiket-tajjibine ve seleme ve sherrefe ve kerreme ve ‘azzame.”*** (Es-selamu alejke, o Resulallah, s.a.v.s.! Selam ty, o pejgamber i Allahut! Selam ty, o i dërguar Allahut! Selam ty, o më i dashuri i Allahut! Selam ty, o i zgjedhuri i Allahut! Selam ty, o Ahmed! Selam ty, o Muhammed! Selam ty, o Ebu Kasim! Selam ty, o Mahi (që i fshinë ndodhitë). Selam ty, o Akib (që nuk vjen pejgamber pas teje)! Selam ty, o Hashir (që mbledhë)! Selam ty, o Beshir (që sjell lumturinë)! Selam ty, o Nezir (që tërheq vërejtjen)! Selam ty, o i pastri! Selam ty, o ti që pastron! Selam ty, o pasardhësi më fisnik i Ademit, a.s.! Selam ty, o pejgamber i Rabbit të botëve! Selam ty, o paraprirës i të mirës! Selam ty, o ti që e hapë të mirën! Selam ty, o pejgamber i rahmetit! Selam ty, o udhëzues i ummetit! Selam ty, o udhëheqës i të zgjedhurve! Selam ty dhe anëtarëve të familjes tënde nga të cilët Allahu Teala i largoi gjynahet dhe plotësisht i pastroi! Selam ty dhe as’habëve tu të mirë, grave tua të drejta e të panjollojura, nënave të besimtarëve! Allahu Teala të shpërbleftë me shpërblimin më të mirë se shpërblimi për cilin do

*pejgamber, dhe le të sjell salavat sa herë që të përmendin zakirët dhe sa herë të harrojnë të përmendin të pakujdesshmit, dhe salavat le të sjellë nga të parët dhe të fundit; salavate më të mira, më të plota, më të bukra dhe më të pastra se salavati kujt do tjetër prej krijesave të Tij, ashtu siç na ka ruajtur Ai, bashkë me ty, nga humbja, na shpëtoi nga verbëria e na mbrojti nga padituria! Dëshmoj se nuk ka zot pos Allahut, një dhe të vetmit, i Cili nuk ka ortak! Dëshmoj se ti je rob i Tij, pejgamberi i Tij, i dërguari i Tij, i zgjedhuri i Tij, në mesin e të gjitha krijesave të Tij! Dëshmoj se me besnikëri e përmbushe detyrën tënde si pejgamber dhe besueshëm e transmetove amanetin e besuar ty, sinqerisht e këshillove ummetin, luftove kundër armikut tënd, ummetin tënd e udhëzove në rrugë të drejtë, sinqerisht e adhurove Rabbin tënd deri te bindja, prandaj të qoftë salavat i Allahut, selam, nder, fisnikëri dhe lartësi, ty dhe familjes tënde të drejtë!)*

Nëse dikush e ka porositur t'ia përcjellë selamin Resulallahut, s.a.v.s., atëherë do të thotë:

*- Selam ty, o Resulallah, nga filani! Selam ty, o Resulallah, nga filani...*

Më pas ec dy hapa më tutje dhe vjen para varrit të Ebu Bekrit r.a.; koka e tij gjendet në lartësi të krahëve të Resulallahut, s.a.v.s., ndërsa koka e Omerit, r.a., gjendet në lartësi të krahëve të Ebu Bekrit, r.a..

Edhe Ebu Bekrit r.a., i dërgon selam:

- *Esselamu alejke ja Ebu Bekiri's –Siddik (r.a.);*

e njëjtë edhe Omerit r.a.:

- *Esselamu alejke ja Omeru'l-Faruk (r.a.).*

Pastaj tërhiqet dy-tre hapa mbrapa dhe ju drejtohet të dyve:

- *Selam ju të dyve, ndihmësve të Resulallahut, s.a.v.s., që i keni ndihmuar në punët të fesë deri sa ishte gjallë; e që pas vdekjes së tij e vazhduat punën e tij duke pasuar hapat e tij dhe në pajtim me veprimet e tij. Allahu Teala le të ju shpërblejë me shpërblimin më të mirë, o ndihmësit e Resulallahut (a.s.).*

Përsëri shkon para varrit të Resulallahut s.a.v.s., kthehet kah kibla, falënderon dhe lavdëron Allahun Teala dhe i dërgon shumë salavate Resulallahut, s.a.v.s.. Më pas e lexon këtë dua:

***“Allahumme inneke kad kulte ve kavlukel-hakku: Ve lev ennehum iz zalemu enfusehum xha’uke festagferullahe vestagfere lehumur-resulu levexhedullahe tevvaben rahima. Allahumme inna kad semin’na kavleke ve eta’na emreke ve kasadna nebijjeke mutesheffi’ine bihi ilejke fi zunubina mu’terifine bihatajana ve taksirina fe tubillahumme ‘alejna ve sheffi’ nebijjeke haza fina ver-fa’na bi menziletihî indeke ve hakkihi ‘alejke. Allahummag-fir lil-muhaxhirine vel-ensari veg-fir lena ve***

***li ihvanineledhine sebekuna bil-imani. Allahumme la texh'alhu ahirel-'ahdi min kabri nebijjike ve min haremi ke ja erhamer-rahimine!"***

*(Allahu im! Ti ke thënë, e fjalët Tua janë e vërteta: "E sikur të vinin ata te ti, pasi që ta kenë dëmtuar veten e tyre, e të kërkonin ata vetë ndjesë te Allahu, e edhe i dërguari të kërkojë ndjesë për ta, ata do të kuptonin se Allahu pranon pendimin dhe është mëshirues" [4-Nisa: 64] Allahu im! Vërtetë i dëgjuam fjalët Tua, iu nënshtruam urdhrit Tënd dhe erdhëm te i Dërguari Yt duke kërkuar prej Teje shefatin e tij për gjynahet dhe mangësitë tona, prandaj pranoje pendimin tonë, dhe mundësoja që të ndërmjetësojë për ne i dërguari Yt, dhe ngriti gradat tona për nder të tij. Allahu im, fali Muhaxhirët dhe Ensarët, falna neve dhe të gjithë vëllezërit myslimanë para nesh. Allahu im, le të mos jetë kjo vizita ime e fundit varrit të Resulallahut, a.s., dhe haremit Tënd, O i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëplotë.)*

Më pas falë dy reqate namaz te *Revda*, e cila gjindet mes mimberit dhe varrit të Resulallahut, s.a.v.s., dhe bën dua aq sa dëshiron, sepse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**"Hapësira në mes të varrit tim dhe minberit tim është një nga bahçet e xhennetit, e minberi im është në Havd-in tim."**<sup>62</sup>

---

<sup>62</sup> Muttefekun alejhi nga Ebu Hurejre dhe Abdullah ibn Zejd.



Është mirë që vizitori të vendosë dorën e vet në mbajtësen e poshtme të minberit, në të cilën Resulallahu, s.a.v.s., e vendoste dorën e vet gjatë hudbes.<sup>63</sup> Gjithashtu, është mirë (*mustehab*) që të enjten të vizitohet Uhudin dhe varret e shehidëve. Namazin e sabahut do ta falë në xhaminë e Resulallahut, s.a.v.s., më pas do të vizitohet Uhudin, e në namaz të drekës do të kthehet në xhaminë e Resulallahut, s.a.v.s.. Kështu, të gjithë namazet i falë në xhaminë e Resulallahut, s.a.v.s..

Është mirë që, për çdo ditë, pasi viziton varrin e Resulallahut, s.a.v.s., të shkojë te varrezat *Beki* dhe të vizitohet varrin e Osmanit, r.a., dhe të Hasan ibn Ali, r.a.. Aty gjenden edhe varret e Ali ibn Husejn r.a., Muhammed ibn Ali r.a. dhe Xhafer ibn Muhammed, r.a.. Gjithashtu, viziton varrin e Fatimes, r.a., varrin e Ibrahimit, djalit të Resulallahut, s.a.v.s., dhe varrin e Safijjes, hallës së Resulallahut, s.a.v.s., e varret e të gjithë këtyre gjenden në *Beki*.

Është mirë që të vizitohet edhe xhaminë *Kuba* të shtunën dhe të fal namaz në të, sepse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

---

<sup>63</sup> Hadithi nuk është gjetur në burime, por Muhammed ibn Hasan ibn Zibale në veprën *Tarih el-Medine* e përmend se gjatësia e mbajtësës të cilën e kapte Resulallahu, s.a.v.s., kur ulej, ishte e gjatë një pëllëmbë e dy gishta.

**“Kush del prej shtëpisë së vet, vjen te xhamia Kuba dhe në të falë namaz, kjo i vlenë sa një umre.”<sup>64</sup>**

Është mirë që të vizitohet edhe bunarin Eris, që është një bunar afër Kubasë. Tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., pështyu në të<sup>65</sup>, Në atë bunar të marrë abdes dhe të pijë nga uji i tij, e më pas viziton edhe *Mesxhid’el-Fet’h*, që gjendet afër Hendekut, e viziton edhe xhamitë tjera dhe vendet e njohura. Në Medine janë afër tridhjetë xhamia dhe vende tjera të vizitës. Haxhia viziton aq sa mundet prej tyre. Viziton edhe bunaret e ujit ku Resulallahu, s.a.v.s., ka marrë abdes, është pastruar dhe e ka pirë ujin e tyre, dhe pastrohet, merr abdes e pi ujë nga to për bereqet (*teberruken*). Gjithsejt janë shtatë.<sup>66</sup>

---

<sup>64</sup> Nesai dhe ibn Maxhe nga Sehl ibn Hanife.

<sup>65</sup> Nuk është gjetur në burime, por përmendet se Resulallahu, s.a.v.s., ka pështyer në burimet *Bessa* dhe *Gars*, për çka do të flasim më vonë.

<sup>66</sup> Ne themi se këto bunare janë: Eris, Ha, Revma, Gars, Bidaa, el-Bessa dhe es-Sukja (el-’ihn. Xhemel). Hadithin për bunarin Eris e shënon Muslimi nga Ebu Musaa el-Esh’ari, për bunarin Ha është muttefekun alejhi, nga Enesi, për bunarin Revma shënojnë Tirmidhi dhe Nesai nga Osmani, si edhe Tirmidhi dhe Nesai. Për bunarin Gars hadithin e shënon Ibn Maxhe, me zinxhir të mirë, si edhe Ibn Nexhxhar në *Tarih el-Medine*, por me zinxhir të dobët. Hadithin për bunarin Bidaa e shënojnë autorët e Sunen-it nga Ebu Seid Hudri, e për bunarin Bessa Ibn Adijj nga Ebu Seid Hudri. Për bunarin *es-Sukja* hadithin e shënon Ebu Davud nga Ajshe, r.anha, si edhe Ahmedi nga Alia, r.a.. Për bunarin Xhemel hadithin e shënojnë Buhari dhe Muslim nga Ebu Xhehm. Darimi shënon nga Ajshe, r.a., se Resulallahu, s.a.v.s., kur ishte i sëmurë, ka thënë: **“Më pastroni me shtatë përzierje të ujërave nga bunare të ndryshme.”**

Nëse haxhia mund të qëndrojë një kohë më të gjatë në Medine, duke ia respektuar pozitën e veçantë dhe cilësitë e saj, do të ishte mirë, sepse në këtë veprim ka shumë mirësi. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Kush duron vështirësitë e Medines, unë do të jem shefatxhi i tij në ditën e gjykimit”<sup>67</sup>**

dhe:

**“Kujt i ofrohet vdekja në Medine, aty le të qëndrojë, sepse ai që vdes në Medine, unë do të ndërmjetësoj për të, ose do të dëshmoj në dobi të tij në ditën e gjykimit.”<sup>68</sup>**

Kur të përfundojë punët e të vendosë ta lëshojë Medinen, do të ishte mirë që para kësaj ta vizitojë varrin e Resulallahut, s.a.v.s., përsëri duke lexuar duanë që e ka lexuar kur ka mbërritë aty, të përshëndetet me Resulallahun, s.a.v.s., dhe t’i bëjë dua Allahut Teala që t’ia mundësojë përsëri ardhjen në vizitë Resulallahut, s.a.v.s., dhe që ta ruajë gjatë udhëtimit.

Pastaj le t’i falë dy reqate namaz në Revden e vogël, e ky është vendi ku ka qëndruar Resulallahu, s.a.v.s., para se të zgjerohej xhamia. Duhet të dalë me këmbën e majtë prej xhamisë, dhe duhet thënë:

---

<sup>67</sup> Është përmendur në kapitullin e mëparshëm.

<sup>68</sup> Është përmendur në kapitullin e mëparshëm.

***“Allahumme sali ‘ala Muhammedin ve ‘ala ali Muhammedin ve la texh’alhu ahirel-‘ahdi bi nebijjike ve hutta evzari bi zijaretihi ve as’hibni fi seferis-selamete ve jessir ruxhu’i ila ehli ve vetani salimen ja erhamer-rahimin.”***(Allahu im! Dërgoi salavat Muhammedit dhe familjes së tij! Le të mos jetë kjo vizita ime e fundit Resulallahut, s.a.v.s.. Në saje të kësaj vizite largoi nga unë brengat e mia, më dhuro selamet në rrugë dhe ma lehtëso kthimin te familja e te vendi im!)

Atyre përreth do t’ju ndajë sadaka aq sa mundet. Rrugës në mes të Medines dhe Mekes le të ndalet në secilën xhami e le të falet aty, e gjithsejt janë njëzet xhami.

## ADABI I KTHIMIT NGA UDHËTIMI

Kur Resulallahu, s.a.v.s., kthehej nga lufta, nga haxhi ose umreja, në secilin vend të lartë bënte tekbir tri herë, e më pas lexonte:

***“La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lekul-mulku ve lekul-hamdu ve huve ala kuli shej-in kadir. Ajibune ta’ibune abidune saxhidune li rabbina hamidune, sadekallahu va’dehu, ve nesare ‘abdehu, ve hedhemel-ahzave vahdeh.”*** (Nuk ka zot pos Allahut, Një e të Vetmit. Ai nuk ka ortak. Atij i takon pushteti dhe hamdi dhe Ai mundet gjithçka. Ne po kthehemi, Allahut Teala i shprehim pendimin, Atë e adhurojmë, Atij sexhde i bëjmë dhe Atë e falënderojmë! Ai e përmbushi premtimin, e ndihmoi robin e Tij dhe Ai shkatërron kundërshtarët.)

Në disa transmetime qëndron edhe kjo:

***“Gjithçka, pos Tij, do të shkatërrohet! Ai do të gjykojë, dhe Atij do t’i ktheheni!”***<sup>69</sup>

Kur t’i afrohet vendit të vet, haxhia pak do ta shpejtojë mjetin e transportit, dhe do të lexojë:

***“Allahummedh-al lena biha kararen ve rizkan hasenen.”*** (Allahu im! Na dhuro në këtë vend rehati dhe risk të mirë!)

---

<sup>69</sup> Muteffekun alejhi nga Ibn Omer, ndërsa pjesa e dytë nga el-Muhamili në *ed-Dua*, me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Më pas do ta lajmërojmë familjen e vet se po kthehet, që të mos i befasojmë familjarët, dhe ky është sunnet.<sup>70</sup> Në shtëpi nuk duhet të kthehet vonë natën, e kur të arrijë në vendin e vet, së pari le të shkojë në xhami e le t'i falë dy reqate nafile. Kështu vepronte Resulallahu s.a.v.s..<sup>71</sup>

Kur të hyjë në shtëpinë e vet, le të lexojë:

***“Tevben tevben li rabbina evben la lugadiru ‘alejna havben.”*** (*Teube, teube, Rabbit tonë që ne u kthyem në shtëpi, ajo teube nuk lë te ne gjynah*).

Kur të rehatohet në shtëpi, haxhia nuk do të duhej të harrojë mirësinë me të cilën Allahu Teala e ka nderuar, e që është vizita shtëpisë së Tij, haremit të Tij dhe varrit të Resulallahut, s.a.v.s.. Nuk do të duhej ta mohojë atë bereqet e të kthehet në gaflet, argëtim e bërje të gjynaheve, sepse kjo nuk do të ishte shenjë se haxhi i është pranuar. Shenjë se haxhi i është pranuar te Allahu Teala është që haxhia të kthehet si i devotshëm i cili nuk ngarend pas dynjasë, por që ngarend pas ahiretit, duke u përgaditur për takim me Rabbin e vet, pasi që e ka vizituar shtëpinë e Tij.

---

<sup>70</sup> Në Sahihët e Buhariut dhe Muslimit, nga Xhabiri.

<sup>71</sup> Është përmendur në *Librin për namazin*.

## Kapitulli i tretë

### ADABI I HAXHIT, FSHEHTËSITË E TIJ DHE VEPRIMET E BRENDSHME

#### DHJETË DETAJE PËR EDEBET E HAXHIT

##### *E para*

Mjetet që personi i siguron për udhëtimin në haxh duhet të jenë të fituara hallall, e tregtia nuk guxon t'ia pushtojë zemrën e t'i sjell brenga, në mendjen e tij duhet të jetë vetëm rizaja e Allahut, zemra e tij duhet të gjejë qetësi me dhikr dhe të angazhohet vetëm në zbatimin të detyrës. Në një hadith prej Ehli-bejtit, thuhet:

**“Në *ahir-zaman* (koha e fundit), katër lloje njerëzish do të udhëtojnë për në haxh: sundimtarët do të udhëtojnë për shëtitje, të pasurit për tregti, të varfrit për lypësari, e lexuesit e Kur’anit për të fituar famë.”<sup>72</sup>**

Hadithi tregon qëllime të dynjallëkut që mund të ndërliohen me udhëtimin për në haxh, por që e humbin vlerën e haxhit dhe largojnë nga vet qëllimi, që është rizaja e Allahut. Kjo sidomos vlen për atë që me pagesë e kryen haxhin për dikë tjetër, e atje kërkon dobi të kësaj bote, deri sa kryen veprim që i takon ahiretit.

---

<sup>72</sup> Hatibi nga Enesi.

Një sjellje të tillë nuk e pëlqenin njerëzit e sinqertë e të devotshëm, përpos kur ky dëshiron të shpërngulet në Meke, e nuk ka para të shkojë; me këtë qëllim lejohet të marrë para e të shkojë bedel. Në këtë rast qëllimi i tij nuk është që me kryerje të obligimeve fetare të përfitojë dynjallëkun, por se përfitimi material do t'i jetë në shërbim të fesë së tij. Një bedeli të tillë qëllim duhet t'i jetë vizita shtëpisë së Allahut dhe ndihma vëllait mysliman që ta kryejë obligimin e haxhit.

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Allahu Teala, me një haxh do t'i vendosë tre persona në xhennet: atë që porositi kryerjen e haxhit, atë që këtë porosi e përmbushë dhe atë që e kryen haxhin për vëllaun.”<sup>73</sup>**

Nuk po them se ndalohet marrja e parave për kryerje të haxhit për tjetrin, pasi ta kryejë haxhin e vet, por po them se më mirë e ka të mos marrë para dhe të mos e shndërrojë atë rrugëtim në biznes. Atij që i jep përparësi fesë, Allahu Teala do t'i japë edhe të mira të kësaj bote, por nuk do t'ju japë atyre që nuk kujdesen për fenë.

Në një transmetim thuhet:

---

<sup>73</sup> Bejheki nga Xhabiri.



**“Shembulli i atij që lufton në rrugë të Allahut e për këtë merr pagë është si shembulli i nënës së Musasë, a.s., e cila e ushqente me gji fëmijën e vet, e për këtë paguhej.”<sup>74</sup>**

Prandaj, ai që e kryen haxhin për tjetrin dhe për këtë merr para është si nëna e Musasë, a.s., dhe mund të marrë para, sepse po i merr që të mund ta kryejë haxhin, e jo që të ketë dobi materiale. As nëna e Musasë, a.s., nuk e ka ushqyer atë për të marrë para, por se paratë i merrte që të mund ta ushqejë me gji fëmijën e vet dhe që të tjerët të mos e zbulojnë se është nëna e tij.

### ***E dyta***

Personi nuk guxon t’i ndihmojë armiqtë e Allahut Teala duke dhënë haraç. Ata janë beduinët dhe disa banorë të Mekes, të cilët në rrugë vendosin pritje dhe kërkojnë haraç, e kështu i pengojnë njerëzit të hyjnë në *Mesxhidul-haram*. T’ju jep atyre haraç nënkupton ndihmë zullumit dhe mundëson përhapjen e të keqes së tyre, e kjo është njëjtë sikur t’i ketë ndihmuar armikut të vet (nepsit). Prandaj le të mundohet të gjejë zgjedhjen e duhur që mos t’ju japë haraç atyre, e nëse nuk mundet, nuk është gabim që të veprojë siç kanë thënë disa dijetarë: *“Nëse është në pyetje haxhi nafile, më mirë e ka të kthehet se sa ta ndihmojë zullumqarin”*.

---

<sup>74</sup> Ibn Adijj nga Muadhi.

Pagesat e tilla janë bidat, dhe nëse njerëzit i nënshtrohen, mund të bëhet e zakonshme dhe veprim i vazhdueshëm. Përpos kësaj, kjo e poshtëron myslimanin. Nuk është kurrfarë arsyesimi të thotë se paratë po i merren me dhunë, sepse po të qëndronte në shtëpinë e vet ose po të kthehej nga rruga, askush nuk i merr asgjë. Bile nganjëherë, duke e paraqitë veten të pasur, i nxitë ata për ta kërkuar edhe më shumë; e sikur ta kishte shfaqë vetensi të gjithë të tjerët, ndoshta as nuk do t'i kërkonin. Duke u shfaqur i pasur, e sjell veten në pozitë të vështirë.

### ***E treta***

Udhëtari për në haxh duhet të sigurojë edhe ushqim të bollshëm për udhëtim, që të mund t'ju japë edhe atyre që kan nevojë, pa qenë dorështrënguar, e edhe pa e tepruar, por me maturi. Teprim llogaritet lloj llojshmëria në ushqim e pije, ashtu siç bëjnë të pasurit. Por, teprim nuk është të jepet sadaka e bollshme, sepse është thënë, *as nuk bën hair kur e tepron, e as nuk e tepron kur bën hair*. Bujari në rrugën e haxhit llogaritet ndihma tjetrit në rrugë të Allahut Teala, dhe është thënë se *një dërhëm vlen shtatqind mijë dërhëmë*. Ibn Omeri, r.a., ka thënë: *“Sigurimi i ushqimit të mirë e të bollshëm në udhëtim është shenjë e bujarisë së personit”*, e gjithashtu ka thënë: *“Haxhia më i mirë është ai me nijetin më të sinqertë, me ushqim hallall, dhe me imanin më të fortë.”*

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Haxhi i pranuar (mebrur) nuk ka shpërblim tjetër përveç xhennetit.”*** E pyetën:

- *O Resulallah! Çfarë është e mira e haxhit?*;

e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- ***Fjala e mirë dhe ndarja e ushqimit.***<sup>75</sup>

### ***E katërta***

Duhet të largohet nga *refes*, *fisk* dhe *xhidal*, për çka na flet Kur’ani Kerim. Fjala *refes* përfshinë çdo të folur të panevojshme e të shëmtuar, bile edhe shakatë me gratë e veta, të folurit për marrëdhënien dhe për paralojën e saj, sepse e gjitha kjo e nxitë epshin dhe çon deri te akti i marrëdhënies intime, që i është e ndaluar haxhisë (gjatë kohës së haxhit), e gjithashtu ndalohet edhe gjithçka që çon deri te e ndaluara. Fjala *fisk* nënkupton gjithçka që largon njeriun nga urdhrat e Allahut Teala. Fjala *xhidal* do të thotë grindje e cila prodhon urrejtje, pra, është e kundërta e ahlakut të bukur. Sufjani ka thënë: *“Ai që flet shemëtuar dhe ashpër gjatë haxhillëkut, haxhillëku i prishet.”*

Mes veprave të mira të haxhit Resulallahu, s.a.v.s., e ka llogaritë edhe fjalën e mirë dhe ndarjen e ushqimit, ndërsa grindjet dhe fjalosja janë të kundërta me fjalën e mirë.

---

<sup>75</sup> Ahmedî nga Xhabiri.

Prandaj haxhia nuk duhet ta kundërshtojë bashkëudhëtarin e as udhëtarët tjerë, por duhet të jetë i butë e i mëshirshëm ndaj atyre që janë nisur për vizitë shtëpisë së Allahut, dhe gjatë gjithë kohës duhet të shprehë ahlak të bukur. Ahlaku i bukur nuk do të thotë vetëm të mos bëjë keq, por edhe të durojë shqetësimin. Është quajtur *sefer* (udhëtim) sepse përmes tij shfaqet dhe ndriçohet ahlaku i personit. Prandaj hazreti Omeri r.a., edhe ka pyetur njërin që duhej të ishte dëshmitar:

- *A ke udhëtuar me këtë person.* Ai tha:
- *Jo., e Hazreti Omeri r.a., i tha:*
- *Atëherë ti nuk e njeh ahlakun e tij.*

### ***E pesta***

Nëse është e mundur, më e mira do të ishte që haxhia të udhëtojë në këmbë për në haxh. Abdullah ibn Abbas, r.a., para vdekjes i këshilloi djemtë e vet, e ju tha:

- *Në haxh shkoni në këmbë; secili hap i haxhisë vlen sa njëqind mijë sevape të Haremit.* Djemtë e pyetën:
- *Çka janë sevapet e Haremit?;* e Ibn Abbas, r.a., ju tha:
- *Çdo sevap në Harem vlen njëqindmijë herë më shumë.*

Udhëtimi në këmbë për në haxh është i pëlqyeshëm (mustehab), por më e pëlqyeshme është ecja në këmbë prej Mekes në Arafat dhe Mine gjatë kryerjes së haxhit.

Disa e kanë llogaritë plotësim të haxhit ecjen këmbë prej shtëpisë deri në vendin e veshjes së ihramit. Omeri, Alia dhe Mesud, r.a., kanë thënë se ky është kuptimi i ajetit:

**“Kryeni haxhin dhe umren plotësisht për rizanë e Allahut.”** 2-Bekare: 196

Disa dijetarë kanë thënë se më mirë është të kalërohet ose të përdoret mjet tjetër i udhëtimit për haxh, sepse kjo do të thotë harxhim i pasurisë për mjet, e në këtë mënyrë i ndihmon të tjerët, e largon mërzinë dhe padisponimin si edhe pakëson mundësitë e vështirësive tjera në udhëtim, e gjithashtu edhe është më e sigurt për kryerje më të plotë të haxhit. E nëse mendojmë më mirë, do ta shohim se kjo nuk është në kundërshti me mundësinë e parë; atij që ecja nuk i paraqet problem, më mirë e ka të ecë, e atij që është i dobët ose ecja i shkakton vështirësi morale e materiale, më mirë e ka të përdorë mjet udhëtimi, njëjtë si te obligimi i agjërimit – për udhëtarin ose të sëmurin më mirë është të agjërojnë, nëse kjo nuk e rrezikon shëndetin e tyre. Disa dijetarë u pyetën se a është më mirë të kryhet umreja në këmbë apo me një dërhëm të marrë me qira një gomar. Thanë se, nëse është fukara dhe e ka vështirë ta japë një dërhëm, atëherë më mirë e ka ta marrë me qira gomarin, e nëse është i pasur dhe vështirë i vije të ecë në këmbë, atëherë më mirë e ka të ecë në këmbë.

Këta dijetarë sikur kanë dashur ta theksojnë luftën kundër nefsit dhe kërkesave të tij. Edhe kjo ka kuptim, por ecja në këmbë është e mirë, siç është edhe harxhimi i dërhemit në qëllime të dobishme, sepse harxhimi në qëllime të dobishme është më i hairit se sa të harxhojë për qira. Nëse udhëtari nuk mundet t'i bashkojë ecjen në këmbë dhe shpenzimet, pra lodhjen fizike dhe harxhimin e pasurisë, atëherë ajo çfarë kanë thënë të tjerët nuk ka kuptim.

### ***E gjashta***

Udhëtari duhet të përdorë vetëm mjet udhëtimi të qëndrueshëm. Nëse nuk frikësohet dhe mund të ulet në deve, nuk duhet të vendos në kurriz të deveve *hevdaç*,<sup>76</sup> e kjo i ka dy urtësi (*hikmet*): njëra është të mos e rëndojë shumë deven, dhe e dyta të mos shfaqet si fodull. Resulallahu, s.a.v.s., ka bërë haxhin me deve, e në të kishte një shalë të rrjepur dhe një mbulojë me vlerë prej katër dërhemësh. Resulallahu, s.a.v.s., e ka kryer tavafin në deve që njerëzit të shohin si bëhet kjo e të mësojnë. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Mësojeni nga unë mënyrën se si kryhet haxhi.”<sup>77</sup>**

Thuhet se Haxhaxhi i pari ka përdorë hevdaçin, e dijetarët e asaj kohe e kundërshtonin këtë.

---

<sup>76</sup> Lloj samari që vendoset mbi kurrizin e deveve dhe elefantit.

<sup>77</sup> Nesai nga Xhabiri, si edhe Muslimi.

Sufjan Sevri tregon se babai i tij ka thënë: *“U nisa prej Kufe drejt Kadisijes për në haxh, e takova bashkudhëtarë nga vende të ndryshme. Të gjithë haxhitë kishin shalë të thjeshta në deve, vetëm dy i pashë që ishin me hevdaç.”*

Ibn Omeri r.a., kur i pa rrobat për haxh dhe hevdaçet që i kishte shpikë Haxhaxhi, tha:

- *Karavan i madh, por pak haxhilerë*, e kur e vërejti një haxhi të veshur thjesht, me një mbulojë të vogël e të rrjepur, tha:

- *Ky është haxhi!*

### ***E shtata***

Haxhia, edhe në pamjen e tij të jashtme (në veshje) duhet të jetë i thjeshtë, të largohet nga zbukurimet dhe shenjat e fodullëkut, sepse mund të llogaritet si fodull e të largohet nga grupi i robëve modest e të zgjedhur të Allahut Teala. Resulallahu, s.a.v.s., ka urdhëruar veshjen e thjeshtë, dhe e ka ndaluar ngënien e tepërt, stolisjen dhe kënaqjen në luks, me hadithin:

**“Haxhia i vërtetë është i pluhërosur e i shpupuritur.”<sup>78</sup>**

Në një hadith kudsij Allahu Teala thotë:

**“Shihni vizitorët e shtëpisë Time! Më erdhën të shpupuritur e të pluhërosur nga vendet e largëta.”<sup>79</sup>**

---

<sup>78</sup> Tirmidhi dhe Ibn Maxhe nga Ibn Omeri.

Allahu Teala në Kur'an thotë:

**“Pastaj le ta heqin papastërtinë e tyre.”** 22-Haxh: 29

Omer ibn Hattab ju shkruajti komandantëve të ushtrisë: *“Veshni rroba të vrazhda e të vjetra.”* Është thënë që zbukurimi i haxhilerëve janë Jemenasit, sepse janë modestë, të thjeshtë dhe në ahlakun e të parëve të mirë. Haxhia posaqërisht duhet të largohet nga rrobat e kuqe dhe gjithçka që e dallon prej myslimanëve tjerë. Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., ishte në një udhëtim, dhe as'habët e gjetën një vend ku u vendosën. Devetë u shpërndanë dhe Resulallahu, s.a.v.s., pa se ishin të ngarkuara edhe me torba të kuqe, e tha:

**- Po e shoh që e kuqja paska dominuar në mesin tuaj.**

As'habët u ngritën, iu afruan deveve dhe i hoqën torbat e kuqe, e disa deve tashmë ishin humbur.<sup>80</sup>

### ***E teta***

Haxhia duhet të jetë i butë e i kujdesshëm me kafshën dhe të mos e ngarkojë përtej mundësive të saj. Edhe fjetja mbi kurrizin e kafshës është vështirësi për të. Të devotshmit nuk kanë fjetur gjatë në kurriz të kafshëve, e as nuk qëndronin gjatë mbi to. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Mos i përdorni kurrizët e kafshëve si shtretër!”<sup>81</sup>**

---

<sup>79</sup> Hakimi, nga Ebu Hurejre, pa fjalët *“nga vendet e largëta”*, dhe e vërteton besueshmërinë e tij. Në këtë formë e shënon Ahmedi nga Abdullah ibn Amr.

<sup>80</sup> Ebu Davud nga Rafij ibn Hadixh.



Është mirë të zbritet nga kafsha në mëngjes dhe në aksham, që kafsha të pushojë. Ky ishte adeti i Resulallahut, s.a.v.s., dhe i të parëve tanë të mirë. Bile, disa prej tyre marrin me qira kafshën me kushtin se nuk do të zbrisin fare nga kafsha, dhe për këtë e paguanin shtesë, e pastaj zbrisnin dhe kështu shprehin dhembshuri ndaj kafshës dhe shpërblimin e marrin ata e jo pronari i kafshës. Secili që e ngarkon kafshën përtej mundësive të saj, do të pyetet për këtë në ditën e Gjykimit.

Ebu Derda r.a., në vdekje i tha devesë së vet: *“Oj deve! Mos më akuzo në ditën e gjykimit, unë vërtetë nuk të ngarkova përtej mundësive tua!”*

Njeriu mund të fitojë shpërblim për secilën gjallesë, prandaj le të ketë kujdes për të drejtat e kafshës dhe për kohën e pushimit të kafshës, e kështu ta gëzojë edhe pronarin e saj. Ibn Mubareku po kalëronte, e një person i tha:

- *Merre këtë libër e dërgoja filanit, në çka Ibn Mubarek u përgjigj:*

- *Më duhet ta pyes pronarin e kafshës, sepse nuk kam bërë marrëveshje për bartje të librit.*

---

<sup>81</sup> Ahmedi nga Sehl ibn Muadh, me zinxhir të dobët të transmetuesve, si edhe Hakimi i cili evërteton besueshmërinë e tij nga Muadh ibn Enesi, e ai nga i ati.

Shih vetëm sa ka qenë i kujdeshëm ndaj kafshës e të mos e ngarkojë më shumë, as edhe me një libër, që ka peshë krejt të vogël. Kjo është rruga e devotshmërisë së pastër, sepse nëse pak hapen dyert për gjëra që në dukje të parë janë të parrezikshme, atëherë gradualisht ato dyer hapen edhe më shumë.

### ***E nënta***

Le të therrë kurban dhe ashtu t'i afrohet Allahut Teala, edhe nëse nuk e ka obligim. Le të mundohet që të ketë kurban të mirë e të shëndetshëm. Nëse është kurban nafile, edhe haxhia le të hajë, por mos të hajë nga kurbanin i obliguar (*vaxhib*). Allahu Teala thotë:

**“E kush madhëron dispozitat e Allahut, ajo është shenjë e devotshmërisë së zemrave.”**22-Haxh: 32

Disa mendojnë se ky ajet ka të bëjë me kurbanin, dhe thonë se kjo e ka kuptimin: ai që mundohet që kurbanin t'a ketë të mirë e të shëndetshëm. Më së miri është që kurbanin të sjellet prej vendit të mikatit, nëse nuk ka vështirësi. Kur blen, nuk duhet ta ulë çmimin e kurbanit. Gjeneratat e para, (selef-i salihin) për tri gjëra kanë paguar sa ju është kërkuar dhe i kanë përbuzë pazarllëqet për çmimin e tyre: për kurbanin në Meke, për kurbanin në ndonjë vend tjetër dhe për lirimin e dikujt prej skllëverisë. Kurbanin më të mirë është ai më i shtrenjti dhe që më së shumti vlerësohet prej blegëtorëve.

Transmetohet se Omeri, r.a., kishte blerë një deve të Horasanit për kurban dhe për të kishte paguar 300 dinarë. Shkoi te Resulallahu s.a.v.s., dhe e pyeti që *ta shesë këtë deve e ta blej një tjetër*, por Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- *Jo, këtë prerje kurban.*<sup>82</sup>

Diçka e vogël dhe e vlefshme është më e mirë se diçka e madhe, e më e keqe. Me treqind dinarë mund të blehen tridhjetë deve, e kështu edhe më shumë mish. Mirëpo, qëllim i kurbanit nuk është mishi por pastrimi i nefsit dhe shpëtimi nga koprracia. Sepse tek Allahu nuk shkon mishi i kurbanit, as gjaku, por shkon devotshmëria juaj, e kjo ka epërsi në vlerë, jo në sasi. E pyetën Resulallahun, s.a.v.s., se cila është e mira e haxhit, e tha:

- ***Të lexohet telbije me zë dhe të therret kurban.***<sup>83</sup>

Ajsha, r.anha, tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Për Allahun Teala nuk ka vepër më të dashur që njeriu mund ta bëjë në ditën e Kurban Bajramit, se sa lëshimi i gjakut të kurbanit. Në ditën e Gjykimit kurhani do t’i vjen (në mahsher) me brinjë dhe thundrat e veta, e kjo vepër do të arrijë te Allahu para se gjaku të bjerë në tokë. Prandaj, zbukurojeni veten me kurban.”**<sup>84</sup>

---

<sup>82</sup> Ebu Davud.

<sup>83</sup> Tirmidhi, dhe e konsideron garib. Ibn Maxhe dhe Hakimi, që e vërteton besueshmërinë e tij. Shënon edhe Bezzari, nga Ebu Bekr. Te el-Bakuli thuhet “*Cili është haxhi më i mirë*”.

<sup>84</sup> Tirmidhi dhe Ibn Maxhe.

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu thotë:

**“Ju, në secilën qime të kurbanit tuaj keni shpërblim dhe në secilën pikë të gjakut të tij keni shpërblim. Vërtetë që kurbanit do të vendoset në peshore, prandaj gëzohuni!”<sup>85</sup>,**

si edhe:

**“Forconi kurbanët tuaj, sepse në ditën e gjykimit ata do të jenë mjet udhëtimi për juve.”**

### ***E dhjeta***

Haxhia duhet të jep sadaka me kënaqësi dhe me kënaqësi të harxhojë për kurban. Nëse has në ndonjë dëm, duhet të durojë, me kënaqësi. Sepse kjo është një prej shenjave që haxhi i është pranuar. Një dërhëm dëmtimi në rrugën e haxhit vlen sa shtatqind dërhëmë harxhim për rizanë e Allahut në kohë tjetër. Vështirësitë në rrugën për në haxh janë sikur vështirësitë në xhihad.

Prandaj, për çfarëdo dëmi dhe vështirësie me të cilën përballlet, haxhia ka shpërblim tek Allahu Teala, e asgjë nuk humb. Thuhet se prej shenjave që haxhi i është pranuar është se haxhia i braktisë gjynahet që i ka bërë më herët, për shokë zgjedh shokë të sinqertë, në vend të tubimeve për lojë e argëtim i viziton tubimet e dhikrit.

---

<sup>85</sup> Ibn Maxhe

***Veprat e brendshme, nga fillimi i haxhit deri te  
përfundimi i tij***

Dije se e para për të cilën haxhia duhet të ketë kujdes është dituria për atë se çfarë kuptimi ka haxhi në fe, më pas vjen dëshira e fortë që të kryhet haxhi, më pas vendosmëria, më pas braktisja e gjithçkaje që personin e largon nga haxhi, pastaj blerja e ihramit, blerja dhe përgaditja e asaj që i nevojitet për rrugë, sigurimi i mjetit të transportit, nisja për rrugë, udhëtimi nëpër shkretëtirë, veshja e ihramit në mikat dhe leximi i telbijes, hyrja në Meke dhe kryerja e veprimeve të haxhit ashtu siç i shpjeguam. Në secilën prej këtyre veprimeve ka hikmet për atë që mendon, paralajmërim për muridin e sinqertë dhe shenjë për të mençurin.

Ne të tregojmë çelësat e këtyre veprimeve, e kur të hapen dyert e të kuptohen shkaqet e tyre, secilit haxhi do t'i shfaqen fshehtësitë e kësaj në atë masë në të cilën është e pastruar zemra e tij dhe përshtatshëm me njohjen dhe të kuptuarit e tij.

## DITURIA PËR HAXHIN

Dije se është e mundur të arrihet Allahut Teala vetëm nëse largohemi nga fama dhe nga kënaqësitë e përkohshme, nëse na mjafton aq sa na është e domosdoshme dhe kur në të gjitha veprimet kërkojmë rizanë e Allahut Teala. Për këtë arsye, te popujt e mëhershëm u shpik murgëria (asketizmi). Disa u tërhoqën në male dhe u larguan prej njerëzve. Ata më shumë preferonin të jetonin në vetmi, me qëllim që të jenë më afër Allahut Teala. Për Allahun braktisën të gjitha kënaqësitë e përkohshme dhe morrën përsipër obligime të vështira (luftë me nefsin), e krejt kjo me dëshirën që të fitojnë ahiretin. Allahu Teala i lavdëron të këtillët në librin e Tij, kur thotë:

**“Kjo për shkak se ndër ta ka priftërinj (të dhënë mbas dijes) e murgj (të përkushtuar ndaj adhurimit) dhe se ata nuk janë kryelartë (ndaj së vërtetës).”** 5-Maide: 82

Kur kjo u zhduk, kur njerëzit iu lëshuan kënaqësive dhe kërkesave të veta, kur e braktisën ibadetin dhe kur e braktisën vetmimin për rizanë e Allahut Teala, atëherë Allahu Teala e dërgoi Muhammedin, s.a.v.s., që të tregojë rrugën e ahiretit dhe të ringjallë sunnetin e pejgamberëve të mëparshëm.

E pyetën Resulallahun, s.a.v.s., se si e shikon islami murgërinë, e ai, a.s., tha:

**“Allahu Teala na e zëvendësoi këtë me xhihad dhe me leximin e tekbitit në secilën lartësi (pra me haxh).”<sup>86</sup>**

E pyetën Resulallahun, s.a.v.s., për ata që jetojnë të tërhequr, e ai, a.s., u përgjigj:

**“Të tillë janë agjëruesit.”<sup>87</sup>**

Allahu Teala e nderoi këtë ummet me atë që ua bëri haxhin largim nga dynjallëku; e nderoi Qaben duke e emërtuar *Shtëpia e Allahut*, ua bëri atë myslimanëve vend për ta vizituar dhe hapësirën rreth saj e bëri harem (të mbrojtur). Arafatin e bëri sikur të jetë çezme e ahlakut të bukur dhe duke ndaluar gjuetinë brenda saj dhe prerjen e drunjve të saj, e ngriti edhe një shkallë më shumë nderin e këtij mjedisi.

Arafatin e bëri sikur të jetë një vend i pranisë së sundimtarit, ku vijnë vizitorë nga vendet e largëta e nga të gjitha anët. Njerëzit vijnë në vizitë këtu të lodhur e të pluhurosur, modestë e të përulur para Rabbit të Shtëpisë, para madhështisë së Tij, duke e pranuar se Ai është krijuesi vetëm dhe i pashoq, i Gjithëfuqishmi, Mbizotëruesi ndaj çdo gjëje, se nuk mund ta përfshijë kurrfarë shtëpie.

---

<sup>86</sup> Ebu Davud nga Ebu Umame.

<sup>87</sup> Bejheki nga Ebu Hurejre.

Kjo gjendje edhe më shumë e zbutë zemrën, e përforcon përluljen dhe ibadetin.

Prandaj Allahu Teala i obligoi haxhitë me veprime të caktuara që për njeriun janë të pazakonta dhe thelbin e tyre mendja nuk mund ta kuptojë, siç është gjuajtja e guralecëve dhe ecja në mes të Safas dhe Merves. Duke kryer veprime të tilla e të ngjashme me këto, haxhia shprehë dorëzimin dhe përluljen e tij të plotë. Mendja e kupton lehtësisht që zekati është ndihmë, si përfundim i mëshirës, agjërimi është thyerje e epshit, që është vegël e shejtanit, e që llogaritet si armiku i Allahut. Agjërimi gjithashtu e largon njeriun nga preokupimet tjera dhe e kthen në ibadet, në ruku e në sexhde, ku ai përulet para Allahut Teala. Por hikmetin e vrapimit në mes të Safas dhe Merves, gjuajtjen e e guralecëve dhe veprime të ngjashme mendja nuk i kupton. Këto i bënë vetëm pse janë urdhër Hyjnor. Në situata të tilla mendja nuk ka kurrfarë ndikimi, e as nefsi dhe natyra e njeriut nuk kanë ndikim, sepse natyra njerëzore anon kah ajo që mendja e kupton dhe ky anim ia lehtëson njeriut nënshtrimin dhe e nxitë në kryerje të atij veprimi. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., posaçërisht për haxhin ka thënë:

**“Allahu im, me kryerje të obligimeve të haxhit, shpreha përlulje e robërim.”<sup>88</sup>**

---

<sup>88</sup> E kemi përmendur në *Librin për zeqatin*.



Resulallahu, s.a.v.s., nuk ka thënë diçka të ngjashme për namaz ose ndonjë ibadet tjetër.

Nëse urtësia (hikmet) e Allahut Teala kërkon që shpëtimi i njerëzve të varet nga ajo që veprat e tyre të jenë në kundërshtim me kërkesat e tyre dhe brenda kufijve të sheriatit, që t'i kryejnë ato veprime për shkak të përuljes së tyre dhe duke shprehur robërim e nënshtrim – atëherë kryerja e atyre veprave, që janë racionalisht të pashpjegueshme, dhe kuptimi i të cilave është i paarritshëm, janë mënyrë edhe më efikase e pastrimit të nefsit, dhe përshtatje me robërim e nënshtrim.

Nëse e kupton këtë të vërtetë, do ta kuptosh se këto veprime janë të pazakonta me qëllim që shpirti të kënaqet me fshehtësitë e ibadetit.

Inshallah këto të mjaftojnë që të kuptosh thelbin e haxhit.

## DËSHIRA PËR HAXHIN

Dëshira e zjarrtë për kryerjen e haxhit vjen pas njohjes dhe bindjes se Qabeja është shtëpia e Allahut Teala dhe ai që shkon aty llogaritet si kur të dalë para një sundimtari. E ai që merr vendim të vizitojë Qaben gjatë jetës në këtë botë meriton që vizita e tij të mos jetë e kotë, dhe për këtë gjithsesi do të shpërblehet në botën tjetër, e shpërblim do t'i jetë shikimi në bukurinë e fytyrës së Allahut Teala. Sepse, në këtë botë, syri i njeriut, për shkak të mangësive që i ka, nuk është në gjendje ta durojë nurin e bukurisë së fytyrës së Tij. Megjithatë, me vizitë Qabes dhe me shikimin në të, njeriu e meriton takimin me Rabbin e Qabes, sepse ky është premtim i Tij. Prandaj, malli për takim me Allahun Teala sigurisht e tërheqë njeriun tek ajo që e mundëson këtë takim. Ai që dashuron, do gjithçka që është e të dashurit dhe i dorëzohet atij, e Qabeja i takon Allahut Teala, prandaj është emërtuar *Shtëpia e Allahut*, e që do të duhej të jetë arsye e mjaftueshme për mall dhe dëshirë për ta vizituar, e të mos flasim për shpërblimin të cilin Allahu Teala e ka premtuar.

## VENDOSMËRIA

Kushdo që vendos ta vizitojë Shtëpinë e Allahut Teala, duhet ta dijë se do ta braktisë familjen dhe atdheun e vet, që ka qëllim të largohet nga dëshirat dhe kërkesat e veta edhe le ta dijë mirë se ka vendosur ta bëjë një vepër të madhe e të rëndësishme. Prandaj haxhia le ta kujtojë vlerën e Qabes dhe le të mendojë për madhështinë e Rabbit të Qabes. Ky vendim i tij duhet të jetë vetëm për rizanë e Allahut Teala dhe nga zemra le t'i largojë rijallëkune fshehtë dhe dëshirën për reputacion. Nijeti i tij duhet të jetë vetëm rizaja e Allahut Teala. Le të jetë i sigurtë se nga vepra e tij nuk do t'i pranohet asgjë nëse ajo vepër nuk është e sinqertë dhe për rizanë e Allahut Teala dhe se gjynahu më i madh është që të shkojë me çfarëdo qëllimi tjetër ta vizitojë shtëpinë e Allahut. Prandaj, në vete le ta pastrojë mirë qëllimin dhe vendosmërinë, le të hedhë poshtë gjithçka që do të mund të kuptohet si rijallëk dhe dëshirë për reputacion dhe le të ketë mirë kujdes që të mos e ndërrojë atë që është më e mirë me atë që është më e keqe.

## PËRGATITJA PËR HAXH DHE LARGIMI I PENGESAVE

Largimi i pengesave para nisjes për haxh është: pagimi i të gjitha borxheve, kërkimi i hallallëkut nga të gjithë dhe pendimi i sinqertë për të gjitha gjynahet e bëra. Secila padrejtësi është pengesë, e secila pengesë është si një borxh që të rri në qafë e të thotë:

*- Çfarë mendon ti, për ku je nisur? Dëshiron ta vizitosh shtëpinë e Rabbit të gjithçkaje, e në shtëpinë tënde nuk ke kujdes për urdhrat e Tij? A nuk ke turp të vizitosh shtëpinë e Tij si rob gjynahqar, e kështu Ai të të kthejë e të refuzojë? Nëse vërtet dëshiron që vizita jote te Ai të pranohet, atëherë zbato urdhrat e Tij, plotëso obligimet tua ndaj të tjerëve, pendohu për gjynahet e bëra, ndërpreje zemrën nga gjithçka tjetër që edhe zemra jote të jetë e kthyer kah Allahu Teala, ashtu si trupi i është kthyer shtëpisë së Tij. Nëse nuk e bën këtë, atëherë nga udhëtimi yt nuk do të kesh asgjë përpos vështirësisë dhe lodhjes dhe, përfundimisht, do të jesh i refuzuar.*

Ndërpreje lidhjen tënde me atdheun ashtu siç e ka ndërprerë ai që nuk e ka ndërmend të kthehet më atje. Fëmijëve dhe familjes t'ju lësh amanet të shkruar (testament) sepse udhëtari dhe prona e tij janë në rrezik, përpos atij të cilin Allahu Teala e ruan.

Me rastin e largimit të pengesave për udhëtimin në haxh, kujto edhe largimin e pengesave për udhëtim në ahiret, sepse ai udhëtim është gjithmonë para teje dhe është shumë afër, ndërsa udhëtimi për në haxh është vetëm mjet i lehtësimit të udhëtimit për në ahiret, që është stacioni i fundit. Prandaj, gjatë përgaditjes për rrugën e haxhit, nuk guxon të shpërfilllet rruga e ahiretit.

### PËRGATITJA E FURNIZIMIT

Mbi të gjitha, ajo që i duhet haxhisë në udhëtim duhet të jetë hallall. Kur në vete të vërejë si kërkon të sigurohet se asgjë nuk do t'i mungojë gjatë gjithë udhëtimit, deri sa të arrijë në cak, le ta kujtojë faktin se udhëtimi për në ahiret është më i gjatë se ky udhëtim, ndërsa furnizim i tij është devotshmëria (*takva*), derisa gjithçka tjetër që ai mendon se e ka furnizim është e përkohshme dhe do ta braktisin kur ky të vdes, do ta tradhtojnë dhe sigurisht nuk do të shkojnë me të. Ushqimi i shijshëm e i freskët do të prishet qysh në stacionin e parë të atij udhëtimit, e ky mbetet i hamendur duke mos ditur se çfarë të bëjë kur të ketë nevojë për atë ushqim. Prandaj le të ketë mirë kujdes dhe le të mundohet që veprat e tij, të cilat i janë furnizim për udhëtimin e tij për në ahiret, të mbesin me të pas vdekjes së tij e të mos i prishë me dyfytirësi dhe me mangësi tjera.

## MJETI I UDHËTIMIT

Kur haxhia e siguron mjetin e udhëtimit, me gjithë zemrën le ta falënderojë Allahun Teala që ia mundësoi të ketë mjet për të udhëtuar, që do t'ia lehtësojë rrugën. Në atë rast le të mendojë kur të vdes, dhe tabutin në të cilin do t'ia bartin xhenazen në rrugën e tij për në ahiret, sepse në një farë mënyre udhëtimi për në haxh edhe i ngjason udhëtimit për në ahiret. Prandaj le të mendojë se ai mjet i udhëtimit për në haxh, a i përshtatet për furnizimin të mjaftueshëm për udhëtimin e ahiretit, dhe të mendojë se si ai udhëtim është shumë afër. Nuk e di kur do të vijë vdekja. Ndoshta para se të hipë në atë mjet, do të vendoset në tabut. Bartja në tabut sigurisht do të ndodhë, dhe kjo nuk do ta anashkalojë asnjërin, por përgaditja për në haxh mund të ndërpritet e të pengohet. Prandaj, si të përgaditet ky aq shumë për një udhëtim që mund edhe të anulohet dhe kujdeset shumë që të mos harrojë diçka nga furnizimi, ndërsa i shpërfillë përgaditjet për udhëtimin që domosdo do të ndodhë.

## BLERJA E IHRAMIT

Kur ta blejë ihramin, haxhia le ta kujtojë qefinin në të cilin do të mbështillet, sepse kur vdes do të mbështillet në të ngjashme. E ndoshta vdes para se të përfundojë haxhin, dhe ihrami i bëhet qefin dhe arrin Allahut Teala.

Kështu, siç do ta vizitojë Qaben me veshje të posaçme dhe të ndryshme nga veshja e zakonshme, ashtu pas vdekjes do ta takojë Allahun Teala me veshje të veçantë dhe të ndryshme nga veshja e zakonshme, e i këtillë është qefini i paqepur e i bardhë si ihrami. Pra, duhet ta mbajë në mend këtë kur blen ihram dhe sipas kësaj të përgatitet.

## FILLIMI I UDHËTIMIT

Me rastin e nisjes për në udhëtim, haxhia duhet të jetë i vetëdijshëm se po e braktisë familjen dhe atdheun dhe se po nisët në rrugë ta vizitojë shtëpinë e Allahut, udhëtim ky me të cilin nuk është i ngjashëm asnjë udhëtim i dynjallëkut. Prandaj në zemër duhet ta dijë saktë se çfarë dëshiron, ku po udhëton dhe kë po e viziton. Duhet të jetë i vetëdijshëm se po merr rrugë drejt shtëpisë së Allahut, si njëri prej atyre që janë ftuar dhe i janë përgjigjur ftesës, tek të cilët është mbjellë dëshirë e fortë, që u ftuan të ngriten në këmbë - dhe u ngritën, braktisën gjithçka që i pengon nga vizita, i braktisën të gjitha krijesat tjera, që u nisën për në Qabe të cilën Allahu Teala e ka lartësuar, e ka zbukuruar dhe i ka caktuar pozitë të veçantë, duke u mjaftuar me takimin me të Qaben në vend të takimit me Rabbin e saj, deri sa t'ju plotësohet dëshira më e madhe, deri sa të mos arrijnë lumturinë përmes shikimit në Rabbin e tyre.

Gjithashtu duhet të kërkojë prej Allahut të arrijë shëndosh në Qabe dhe t'i pranohet haxhi. Le të mos mbështetet në veprat e veta por të mbështetet në mirësinë e Allahut dhe në realizimin e premtimit të Tij. Nëse nuk arrin deri në Qabe dhe vdes rrugës, do ta takojë Allahun Teala si mysafir i Tij, sepse Allahu Teala ka thënë:

**“Kush lë shtëpinë e vet, duke emigruar për Allahun dhe Pejgamberin e Tij, pastaj t'i vijë vdekja, (në rrugë), Allahu me siguri do ta shpërblejë atë.”** 4-Nisa: 100

#### UDHËTIMI DERI TE VENDI I VESHJES SË IHRAMIT

Kur arrijë te vendi i mikatit për ta veshë ihramin dhe i mendon vështirësitë që i ka kaluar deri aty, haxhia le ta kujtojë kohën që do të vijë pas vdekjes e deri te tubimi para Allahut Teala për llogaritje dhe atë tmerr dhe situatë atje. Shembull, kur të mendojë për hajdutët e rrugëve, le të kujtojë tmerret e marrjes në pyetje nga Munkiri dhe Nekiri; kur t'i mendojë vështirësitë prej bishave të shkretëtirës, le ta kujtojë vuajtjen prej krimbit, gjarprit dhe kafshëve tjera në varr; kur të mendojë se si e ka braktisur familjen dhe të afërmit, le ta kujtojë si do të mbetet i vetëm në varr.



## IHRAMI DHE TELBIJE

Deri sa është duke e bërë nijet dhe duke e veshë ihramin në vendin e mikatit, haxhia le të jetë i vetëdijshëm se me telbije po i përgjigjet thirrjes së Allahut Teala. Prandaj, le të shpresojë e le të dëshirojë që përgjigja e tij të pranohet e të mos i thuhet: *“Përgjigja jote nuk u pranua!”* Le të jetë vazhdimisht në mes të shpresës dhe frikës, aspak të mos mbështetet në fuqinë dhe guximin e vet, por le të mbështetet në mirësinë dhe fisnikërinë e Allahut. Koha kur haxhia në mikat lexon telbijen është fillimi i frikës.

Sufjan ibn Ujejne ka treguar: *“Ali ibn Husejn, r.a. u nis për në haxh. Kur e veshi ihramin dhe i hipi kalit, fytyra iu zbeh e trupi i dridhej, thuaj se e goditi rrufeja! Nuk ishte në gjendje të lexojë telbije. Kur e pyetën për sebebën pse nuk po e lexon telbijen, u përgjigj:*

*- Kam frikëse se mund të më thuhet: ‘Përgjigja jote nuk u pranua!’ Kur e lexoi telbijen, e humbi vetëdijen e ra nga kali. Kjo gjendje vazhdoi deri sa i përfundoi detyrat e haxhit.”*

Ahmed ibn Ebu’l- Havari tregon: *“Isha me Ebu Sulejman Daranin, kur ai e veshi ihramin. E kaluam një copë rrugë, e ai ende nuk po e lexonte telbijen. E humbi vetëdijen, e kur u këndell, më tha:*

- O Ahmed! Allahu Teala i shpalli Musasë, a.s.:

**'Urdhëroi zullumqarët e Beni Israilëve të Më kujtojnë më pak, sepse kur të tillët më përkujtojnë, Unë mbi ta hedhi mallkim!** 'Vaj halli për ty Ahmed! Kam dëgjuar se ai që e kryen haxhin por jo vetëm për rizanë e Allahut Teala (e kryen haxhin me mjete haram), kur të fillojë të lexojë telbije, Allahu Teala i përgjigjet:

**'Përgjigja jote nuk pranohet deri sa nuk i kthen ato (mjetet haram) me duart tua!' Nuk mund të jemi të sigurt se edhe neve nuk na thuhet kështu."**

Kur haxhia në mikat të lexojë telbijen me zë, le ta kujtojë përgjigjen në thirrjen e Allahut Teala:

**"dhe ftoi njerëzit në haxhillëk..."** 22-Haxh: 27

Le ta kujtojë thirrjen që do t'ju drejtohet të gjitha krijesave kur të fryhet në sur dhe kur gjithçka do të mblidhet në një vend duke iu përgjigjur thirrjes së Allahut Teala e do të ndahen në grupin e atyre që janë të afërt Allahut dhe të atyre me të cilët Ai është i zemëruar, si edhe në grupin e atyre që do të jenë në mes të frikës dhe shpresës, sikur haxhia në mikat që është në hamendje dhe padituri se a do të mund ta kryejë haxhin dhe se a do t'i pranohet ai haxh apo jo.

## HYRJA NË MEKE

Kur të hyjë në Meke, haxhia le të jetë i vetëdijshëm se ka arritë i sigurt pas kapërcimit të vështirësive, dhe le të shpresojë që kjo hyrje do ta ruajë nga dënimi i Allahut. Le të frikësohet të mos jetë nga ata që kanë merituar afërsinë e Mekes, e më pas e kanë tradhëtuar atë nder e me këtë e kanë merituar zemërimin e Allahut. Në të gjitha situatat le të mbizotërojë shpresa që do të arrijë mëshirën e Allahut. Qabeja ka aq nder të madh, prandaj aty respektohen të drejtat e vizitorit dhe i mbrohet e drejta atij që aty kërkon strehim.

## SHIKIMI NË QABE

Kur e shikon Qabenë, haxhia duhet që edhe në zemrën e vet të ndjejë madhështinë e saj, sikur të shikojë Rabbin e saj. Le të shpresojë që do t'i shfaqet bukuria e fytyrës së Tij, siç i është bërë nasip ta shikojë Qaben. Le ta falënderojë Allahun Teala që ia ka mundësuar të arrijë në këtë gradë. Duhet t'a kujtojë qëndrimin e njerëzve në ditën e Gjykimit karshi xhennetit, me shpresë se do të jenë nga ata që do të hyjnë në të, dhe le ta kujtojë se atëherë do të ndahen në grupin e atyre të cilëve hyrja do t'ju lejohet dhe në grupin e atyre të cilëve hyrja do t'ju ndalohet; ashtu edhe haxhilerët do të ndahen sipas haxhillëkut të tyre; një grupi do t'i pranohet haxhi, e të tjerëve do t'ju refuzohet.

Haxhia nuk guxon ta largojë nga mendja ahiretin, sa herë që të shikojë diçka, sepse gjithçka që haxhia përjeton në haxh është shenjë e gjendjeve të njëjta edhe në ahiret.

### TAVAFI RRETH QABES

Tavafi rreth Qabes është një lloj namazi, prandaj haxhia le ta kryejë atë duke i kujtuar gjendjet si frikë-respekti, përulësia, shpresa dhe dashuria, siç i kemi shpjeguar ato në *Librin për namazin*. Duke bërë tavaf rreth Qabes, haxhia i përngjanë melekëve që bëjnë tavaf rreth Arshit. Qëllim i vërtetë i tavafit rreth Qabes është që zemra ta përkujtojë Rabbin e saj. Pasi që shumica e njerëzve nuk janë në gjendje të bëjnë tavaf të tillë, ju është urdhëruar t’ju përngjasojnë melekëve, brenda kufijve të mundësive të veta, dhe ju është premtuar:

**“Kush i përngjason një populli, atij populli i takon”<sup>89</sup>**

### PREKJA E GURIT TË ZI

Me rastin e prekjes së gurit të zi (*haxherul esvedi*), haxhia le të jetë i bindur se Allahut Teala po i jep betimin për nënshtrim dhe ibadet, e në këtë le të jetë i vendosur

---

<sup>89</sup> Ebu Davud nga Ibn Omer, me zinxhir të besueshëm.

dhe le t'i mbesë besnik premtimit të vet, sepse ai që tradhton e ka merituar zemërimin e Allahut Teala.

Ibn Abbas, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:  
**“Guri i zi (*Haxherul esvedi*) është betimi i Allahut në Tokë - dora e Tij e djathtë, me të cilën Ai i shtrëngon duart e krijesave të Tij, ashtu si njeriu shtrëngon dorën me vëllanë e vet.”<sup>90</sup>**

#### KAPJA E MBULESËS SË QABES DHE QËNDRIMI PARA DYERVE TË SAJ

Me atë rast, haxhia le të dëshirojë sinqerisht afërsinë e Allahut Teala, duke shprehur dashuri dhe mall për Qabenë dhe Rabbin e saj, duke kërkuar bekimin e Allahut dhe duke shpresuar në mbrojtjen e Tij prej zjarrit.

Kur ta kapë mbulesën e Qabes, qëllim le ta ketë të mos heq dorë në kërkim të faljes prej Allahut, njëjtë si gjynahqari kur kapet për rroba të atij që i ka bërë keq, duke e lutur për falje dhe duke ia bërë me dije se vetëm ai mund ta falë dhe që shpresa e vetme e këtij gjynahqarit është fisnikëria dhe gatishmëria e këtij për ta falur, dhe se nuk do ta lëshojë deri sa nuk e falë dhe nuk i premtton siguri në të ardhmen.

---

<sup>90</sup> E kemi përmendur në *Librin për Diturinë*, transmetuar nga Abdullah ibn Amr.

## SA'J NË MES SAFAS DHE MERVES

Ecja në mes Safas dhe Merves është e ngjashme me gjendjen e personit që hyn në pallatin e sulltanit dhe del prej aty duke mos e ditur se a do t'ia pranojë sulltani kërkesën apo do t'ia refuzojë, e ky ecë nëpër oborrin e pallatit me shpresën se sulltani do të ketë mëshirë për të.

Gjithashtu, duke ecur në mes të Safas dhe Merves, haxhia duhet të kujtojë ecjen në mes të dy taseve të Mizanit në ditën e Gjykimit; Safa le t'i jetë tasi me vepra të mira, e Merva tasi me vepra të këqija, prandaj le ta ketë ndjenjën se po ecë mes këtyre dy taseve, duke pritur se cili prej taseve do të vije më rëndë, dhe çfarë do të ndodhë pas kësaj – dënimi apo falja.

## QËNDRIMI NË ARAFAT

Qëndrimi në Arafat, tollovia, zhurma, gjuhët e ndryshme, njerëzit që pasojnë imamët e tyre; të gjitha këto haxhisë duhet t'ia kujtojnë qëndrimin në ditën e Gjykimit, kur do të mblidhen të gjithë njerëzit, secili me pejgamberin e vet, duke dëshiruar shefatin e tij, dhe ta kujtojë hutimin dhe tmerrin atje. Kur ta kujtojë këtë, zemra le t'i jetë e mbushur me frikë-respekt dhe le të kërkojë falje nga Allahu

Teala, e të shpresojë që atë ditë do të ngjallet me të mirët, të cilët i ka përfshirë rahmeti i Allahut. Shpresat e veta haxhia le t'i forcojë me bindjen se Allahu Teala do t'ia pranojë duatë, sepse Arafati është vend i ndershëm dhe rahmeti i Allahut e arrinë secilën krijesë përmes zemrave të robëve të ndershëm të Allahut në Tokë.

Në Arafat gjithmonë gjenden robë të ndershëm, të sinqertë, të mirë dhe të zgjedhur të Allahut Teala, e kur të bëhen bashkë dëshirat e tyre, kur zemrat e tyre të mbushura me frikë-respekt të kthehen kah Allahu Teala, kur duart dhe shikimet e tyre të drejtohen kah qielli dhe kur të gjithë, si një shpirt i vetëm, me bindje kërkojnë rahmetin e Allahut – kurrsesi mos mendo se Allahu Teala nuk i pranon duatë e tyre dhe t'i privojë nga rahmeti i Tij. Prandaj është thënë se gjynahi më i madh i njeriut është që të vijë në Arafat e të mendojë se Allahu Teala nuk do ta falë.

Sikur sekreti i haxhit të jetë mblidhja e njerëzve të ndershëm e të zgjedhur të Allahut nga vendet e ndryshme të botës - në një vend, , që t'i luten Allahut së bashku, për një qëllim. Bashkimi i dëshirave dhe angazhimit si edhe lidhja e zemrave në kohën e njëjtë dhe në vendin e njëjtë është mënyra më e mirë për të tërhequr rahmetin e Allahut.

## GJUAJTJA E GURALECËVE

Haxhia, duke gjuajtur guralecët duhet të tregojë nënshtrim urdhrit të Allahut, të shprehë robërimin ndaj Tij dhe gatishmëri për kryerje të këtij urdhri, pa analiza logjike. Le të jetë i vetëdijshëm se me këtë veprim po i ngjason Ibrahimit, a.s., kur atij në po atë vend i erdh Iblisi, Allahu e mallkoftë, dhe tentoi ta mashtrojë në lidhje me haxhin e tij dhe ta fusë në gjynah, prandaj Allahu Teala i urdhëroi Ibrahimit a.s., që ta gjuajë me gurë, ta largojë dhe të ndërpresë dëshirat dhe shpresat e të mallkuarit. Prandaj nëse haxhia mendon: *“Iblisi i erdhi Ibrahimit a.s., ky e pa prandaj e gjuajti me gurë, por mua shejtani nuk po më shfaqet; çfarë të gjuaj me guralecë?”*- le ta dijë me siguri se një mendim i tillë është pikërisht mendim nga shejtani, të cilin ai e ka mbjellur në zemrën e haxhisë, që të dobësojë vendosmërinë e tij për të hedhur gurë dhe të mendojë se ky veprim nuk ka dobi dhe është thjesht një lojë të cilës nuk duhet kushtuar shumë rëndësi. Mendime të tilla haxhia duhet menjëherë t’i refuzojë e t’i largojë nga vetja duke filluar me vendosmëri të gjuajë guralecët, përkundër tentimeve të shejtanit që ta largojë nga kjo. Haxhia le ta dijë se, ani pse po gjuan guralecë në xhemret, ai në esencë po e gjuan shejtanin dhe po ia thyen shpinën. Sepse, njeriu mund ta mposhtë shejtanin vetëm nëse vet i nënshtrohet urdhrit të Allahut, duke e madhëruar Allahun dhe duke e zbatuar urdhrin vetëm pse është urdhër i Allahut.



## THERRJA E KURBANIT

Haxhia duhet ta dijë se me therrjen e kurbanit ai i afrohet Allahut Teala, duke kryer urdhrin e Tij. Prandaj, le ta kryej këtë urdhër plotësisht dhe në vete le të kultivojë ndjenjën e shpresës se Allahu Teala me secilën pjesë të kurbanit që ky e therrë do ta shpëtojë nga zjarri një pjesë të trupit të tij. Kështu është premtuar. Sa më i madh kurbanit e sa më i mirë, shpëtimi yt nga zjarri është më gjithëpërfshirës.

## VIZITA MEDINES

Kur haxhia t'i sheh muret e Medines, le të kujtohet se ky është qyteti të cilin Allahu Teala e zgjodhi të jetë qyteti të Dërguarit të Tij, s.a.v.s., vend i shpërnguljes së tij, ku Resulallahu, s.a.v.s., do t'i shpjegojë urdhrat e Allahut Teala dhe sunnetin e vet, ku do të luftojë me armiqtë dhe prej nga do ta përhapë Islamin, deri sa Allahu Teala ta marrë afër Vetes. Pas kësaj, Allahu Teala vendosi që Medine të jetë edhe vendi i tyrbes së Resulallahut, s.a.v.s., dhe i tyrbeve të dy ndihmësve të tij, (Hz. Ebu Bekir dhe Omeri r.a.). Haxhia le t'i mendojë vendet e gjurmëve të Resulallahut, s.a.v.s., kah ka lëvizur ai dhe le të jetë i vetëdijshëm se nuk ka kurrfarë vendi, e të mos jetë vend ku ka shkelur këmba e ndershme e Resulallahut, s.a.v.s..

Prandaj, në ato vende le ta qesë hapin i qetë dhe me dinjitet, duke kujtuar ecjen e Resulallahut, s.a.v.s., nëpër sokaqet e Medines, duke e menduar dinjitetin e tij dhe qetësinë e hapavetë tij. Le të mendojë se si Allahu Teala ia mbushi zemrën me dituri, ia lartësoi emrin duke ia shkruar bashkë me emrin e Vet, dhe si ia shkatërron veprën atij që e ngritë zërin mbi zërin e Resulallahut, s.a.v.s.. Më pas le t'i kujtojë mirësitë e Allahut, të cilat Ai ua dhuroi atyre që ishin pranë Resulallahut, s.a.v.s., që e shikuan dhe i dëgjuan fjalët e tij dhe le të pikëllohet pse edhe ky nuk ishte pranë Resulallahut, s.a.v.s., dhe me as'habët e tij, r.a.. Më pas le të mendojë se ky nuk e ka parë Resulallahun, s.a.v.s., në këtë botë dhe se mundësia që ta shohë në botën tjetër është në pikëpyetje, dhe le të ndjejë këtë frikë kur ta shohë se pengesë i janë bërë veprat e veta. Sepse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Allahu Teala do të m’i paraqesë njerëzit që do të më thërrasin: ‘O Muhammed! O Muhammed!’, e unë do të them:**

**- O Rabb! Këta janë nga ummeti im; e Ai do të përgjigjet:**

**- Ti nuk e di se sa bidate këta i sollën pas teje.**

**Pas kësaj unë do të them:**

**- Largohuni, qofshi larg e të shurdhër!”<sup>91</sup>**

---

<sup>91</sup> Muttefekun alejhi nga Ibn Mesud, Enesi dhe të tjerë, por pa thirrjen: “O Muhammed! O Muhammed!”

Madje, nëse haxhia nënqmon sheriatin Islam, qoftë edhe për një moment, le të jetë i sigurt se kjo do t'i bëhet pengesë mes tij dhe Resulallahut, s.a.v.s.. Prandaj haxhia duhet të mbajë shpresë të madhe dhe ta lusë Allahun Teala të mos vendos pengesë mes tij dhe Resulallahut, s.a.v.s., pasi që ia ka dhuruar imanin dhe e ka zgjedhur që ta vizitojë Resulallahun, s.a.v.s., dhe ka bërë që ky të mos dëshirojë në këtë rrugëtim as tregti as përfitim tjetër të dynjasë, por vetëm që sinqerisht, nga dashuria dhe malli, t'i shohë gjurmët e Resulallahut, s.a.v.s., dhe tyrben e tij, pasi nuk ka mundur që ta shohë sa ai ishte gjallë. Ky veprim është arsyeja më e fortë që Allahu Teala të shikojë me mëshirë.

Kur të mbërrijë te xhamia e Resulallahut, s.a.v.s., le të kujtohet se ajo ishte një truall të cilin Allahu Teala e ka zgjedhur për mesxhid të Resulallahut, s.a.v.s., dhe për as'habët të tij se kjo është hapësirë ku ka filluar zbatimi i obligimeve të Allahut dhe hapësirë që i ka mbledhur krijesat më të mira të Allahut Teala, të gjalla dhe të vdekura.

Le të mbajë shpresë haxhia dhe le ta mendojë rahmetin e Allahut me hyrje në këtë xhami. Më pas, gjatë hyrjes, le të jetë i përlur dhe me dinjitet, sepse ku tjetër nëse jo këtu, zemra e besimtarit mund të mbushet me modesti dhe frikë-respekt.

Ebu Sylejmani ka treguar: *“Uvejs Karani, e bëri haxhin dhe vizitoi Medinen, e kur arriti te dyert e xhamisë së Resulallahut, s.a.v.s., ia treguan varrin e Resulallahut, s.a.v.s., e ky e humbi vetëdijen. Kur u zgjua, tha:*

*- Më largoni nga këtu! Aty ku është i varrosur Muhammedi, s.a.v.s., jeta nuk ka shije.”*

### VIZITA RESULALLAHUT, S.A.V.S.

Me rastin e vizitës Resulallahut, s.a.v.s., duhet qëndruar para varrit të tij, ashtu siç e kemi shpjeguar më lartë. Vizita Resulallahut, s.a.v.s., të vdekur duhet të jetë e njejtë sikur të jetë ai gjallë. Haxhia do t'i afrohet me edeb varrit të tij vetëm aq sa do t'i afrohej Resulallahut, s.a.v.s., po të ishte ai, gjallë; nuk duhet t'i prekë a t'i puthë parmakët e hekurit dhe murin, sepse ato janë zakone të jahuvide dhe të krishterëve. Haxhia duhet të jetë i vetëdijshëm që Resulallahu, s.a.v.s., e di që ky është aty, që po e viziton dhe është duke qëndruar para tij, dhe që salavatet dhe selamet e haxhisë i arrijnë Resulallahut, s.a.v.s..

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Allahu Teala ka caktuar një melek te varri im që të më njoftojë për salavatet dhe selamet e atyre që m'i dërgojnë.”<sup>92</sup>**

---

<sup>92</sup> Nesai, Ibn Hibban dhe Hakimi nga Ibn Mesud.

Kjo ka të bëjë me ata që dërgojnë salavate dhe selam nga çdo anë e botës, e nuk shkojnë te varri i Resulallahut, s.a.v.s., e si është tek puna me ata që i lëshojnë shtëpitë e veta e kalojnë gjithë atë rrugë nga dashuria dhe malli për takim me të, dhe mjaftohen të shohin vetëm varrin e tij. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**“Kush më dërgon mua një salavat, Allahu Teala do t’ia kthejë atij dhjetë salavate.”<sup>93</sup>**

Pra, salavati i Allahut Teala do t’i jetë shpërblim për salavatit e tij drejtuar Resulallahut, s.a.v.s., e çfarë mund të jetë shpërblimi për ardhje dhe vizitë?! Më pas, haxhia le t’i afrohet minberit të Resulallahut, s.a.v.s., dhe le ta mendojë ngritjen dhe paraqitjen e tij plot dinjitet, i rrethuar me muhaxhirë dhe ensarë, r.a., e ai me hudben e vet i nxitë në nënshtrim Allahut Teala; le t’i bëj dua Allahut Teala që në ditën e Gjykimit mos ta ndajë nga Resulallahu, s.a.v.s..

Këto janë obligimet e zemrës gjatë kryerjes së haxhit, dhe kur haxhia t’i përfundojë këto, zemra e tij duhet të mbetet e mërzitur, dhe me vetëdije se nuk e di a i është pranuar haxhi apo jo, a është përfshirë në grupin e të dashurve, apo është refuzuar.

---

<sup>93</sup> Muslimi nga Ebu Hurejre dhe Abdullah ibn Amr.

Le të mundohet ta kuptojë këtë me ndihmën e zemrës dhe veprave të tij, dhe nëse e sheh që zemra i është ftohur nga kjo dynja mashtruese dhe i është kthyer ahiretit, dhe nëse e sheh se veprat e tij janë përshtatshëm me sheriat, duhet të besojë se haxhi i është pranuar. Allahu Teala pranon vetëm nga ata që Ai i do; e kë e do Allahu, ia shfaqë shenjat e dashurisë së Tij duke e mbrojtur nga shejtani. Prandaj, nëse pas haxhit nuk bën gjynah, kjo do të thotë se haxhi i është pranuar, por nëse prapë kthehet në gjendjen e vjetër dhe bën gjynahe, nga haxhillëku ka përfituar vetëm lodhje e raskapitje, Allahu na ruajtë nga kjo.

Me këtë e përfunduar *Librin për Fshehtësitë e Haxhit*, dhe inshallah pason *Libri për edebet e leximit të Kur'anit*.

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
FAZILETI I HAXHIT, QABES, MEKËS DHE MEDINES.....	5
FAZILETI I HAXHIT .....	5
FAZILETI I QABES DHE I MEKES SË NDERUAR .....	13
QËNDRIMI I PËLQYESHËM DHE I PAPËLQYESHËM NË MEKE .....	16
VLERAT E MEDINES KARSHI QYTETEVE TJERA.....	20
KUR BËHET HAXHI I OBLIGUESHËM, KUSHTET PËR VLEFSHMËRINË E RUKNEVE TË TIJ, VAXHIBET E TIJ DHE NDALESAT GJATË HAXHIT .....	25
<i>Llojet e haxhit</i> .....	30
Gjashtë veprimet e ndaluara në haxh dhe umre .....	32
RENDITJA E DETYRAVE QË DUHET TË BËHEN NGA FILLIMI I UDHËTIMIT NË HAXH, DERI NË KTHIM.....	34
<i>Udhëtimi nga shtëpia deri te vendi i veshjes së ihramit</i> .....	34
<i>Edebet e veshjes së ihramit në mikat deri te hyrja në Meke</i> .....	44
<i>Edebet para hyrjes në Meke e deri te kryerja e tavafit</i> .....	47
<i>Edebet e tavafit (rrotullimit rreth Qabes)</i> .....	51
<i>Saj-i</i> .....	60
<i>Qëndrimi në Arafat dhe veprimet që i paraprijnë</i> .....	63
<i>Veprimet tjera gjatë haxhit, pas qëndrimit në Arafat</i> .....	77
<i>Mënyra e kryerjes së umres dhe tavafit lamtumirës</i> .....	86
<i>Tavafi lamtumirës (tavaful-veda)</i> .....	88
<i>Edebet e vizitës në Medine</i> .....	90
ADABI I KTHIMIT NGA UDHËTIMI .....	101
ADABI I HAXHIT, FSHEHTËSITË E TIJ DHE VEPRIMET E BRENSHME.....	103
DHJETË DETAJE PËR EDEBET E HAXHIT .....	103
<i>Veprat e brendshme, nga fillimi i haxhit deri te përfundimi i tij</i> .....	117
DITURIA PËR HAXHIN.....	118
DËSHIRA PËR HAXHIN .....	122

VENDOSMËRIA.....	123
PËRGATITJA PËR HAXH DHE LARGIMI I PENGESAVE.....	124
PËRGATITJA E FURNIZIMIT.....	125
MJETI I UDHËTIMIT .....	126
BLERJA E IHRAMIT .....	126
FILLIMI I UDHËTIMIT .....	127
UDHËTIMI DERI TE VENDI I VESHJES SË IHRAMIT .....	128
IHRAMI DHE TELBIJE .....	129
HYRJA NË MEKE .....	131
SHIKIMI NË QABE.....	131
TAVAFI RRETH QABES .....	132
PREKJA E GURIT TË ZI .....	132
KAPJA E MBULESËS SË QABES DHE QËNDRIMI PARA DYERVE TË SAJ .....	133
SA'J NË MES SAFAS DHE MERVES .....	134
QËNDRIMI NË ARAFAT .....	134
THERJA E KURBANIT .....	137
VIZITA MEDINES .....	137
VIZITA RESULALLAHUT, S.A.V.S .....	140



